

RAPORT VLERËSIMI

I PLANIT STRATEGJIK TË ARSIMIT TË KOSOVËS 2011-2016

Vlerësimi i realizimit të Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2011-2016 dhe programeve të edukimit parashkollor, arsimit parauniversitar, arsimit profesional, arsimit të lartë, arsimit të të rriturve, zhvillimit profesional të mësimeve të mesmeve, teknologjisë së informimit dhe komunikimit dhe ndërtimit të kapaciteteve

Dhjetor, 2015

**MINISTRIA E ARSIMIT,
SHKENCËS DHE
TEKNOLOGJISË**

RAPORT VLERËSIMI

I PLANIT STRATEGJIK TË ARSIMIT TË KOSOVËS 2011-2016

Vlerësimi i realizimit të Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2011-2016 dhe programeve të edukimit parashkollor, arsimit parauniversitar, arsimit profesional, arsimit të lartë, arsimit të të rriturve, zhvillimit profesional të mësimeve, teknologjisë së informimit dhe komunikimit dhe ndërtimit të kapaciteteve

Dhjetor, 2015

**MINISTRIA E ARSIMIT,
SHKENCËS DHE
TEKNOLOGJISË**

Kordinator i Vleresimit: Alush Istogu

Anëtarët e grupit punues: Ferit Idrizi, Hanëmsha Aliu-Latifi, Azem Azemi, Aferdita Kryeziu, Enver Mekolli, Esat Mazreku, Nita Dermaku, Avni Rexha, Lulavere Behluli, Mimoza Hasani, Arber Salihu, Afrim Rrahmani, Laberi Luzha, Ryve Prekorogja, Enesa Kadiq, Bekim Samadraxha, Kumrije Gagic, Burim Gashi, Igballe Cakaj, Minire Gashi, Afërdita Jaha, Arta Bruqaj, Ardiana Shabaj, Uke Osmanaj, Elhame Shabani, Shpresa Kokollari, Naxhiye Shala-Ajvazi, Naime Reqica, Isuf Gashi, Habib Aliu, Valon Alimusaj.

Këshilli redaktues: Ferit Idrizi, Agim Berdyna, Fadile Dyla, Isni Kryeziu, Defrim Gashi, Drita Kadriu, Murteza Osdaudaj, Fehmi Zylfiu.

Mbështetja profesionale: Mbështetje teknike për MASHT implementohet nga CPM Consulting, Ecorys, VIAA dhe SD Consulting

Ekspert udhëheqës: Armend Muja

Sigurimi i cilësisë:

Ansi Shundi

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MASHT 2015

TABELA E PËRMBAJTJES

INDEKSI I FIGURAVE.....	8
INDEKSI I TABELAVE	10
SHKURTESAT	11
PARATHËNIE.....	13
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	15
2. ARSIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS (2011-2015).....	18
2.1. Konteksti ekonomik dhe social.....	18
2.2. Fizionomia e sistemit arsimor	22
2.3. Trendet kryesore	23
3. FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT	28
3.1. Fushëveprimi i procesit të vlerësimit.....	28
3.2 Metodologjia	28
4. EDUKIMI PARASHKOLLOR	31
4.1.Përfshirja në edukimin parafillor	32
4.2.Përfshirja në edukimin parashkollor	33
4.3. Aftësimi i edukatorëve	35
4.4. Kurrikula e edukimit parashkollor	36
4.5. Kapaciteti i menaxhimit të institucioneve parashkollore	37
4.6. Vetëdijësimi mbi rëndësinë e edukimit parashkollor	37
5. ARSIMI PARAUNIVERSITAR.....	38
5.1. Menaxhimi i arsimit parauniversitar	39
5.2. Legjislacioni arsimit parauniversitar	41
5.3. Decentralizimi financiar	41
5.4. Sigurimi i cilësisë	42
5.5. Shërbimet këshilluese.....	45
5.6. Kurrikula	46
5.7. Licencimi i mësimdhënësve	47
5.8. Gjithëpërfshirja	49
5.9. Rrjeti i shkollave.....	50
5.10. Mjedisi miqësor	50
5.11. Infrastruktura.....	51
5.12. Tekstet dhe resurset mësimore.....	51
6. ARSIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL	53
6.1. Praktika në arsimin profesional.....	54
6.2. Autonomia financiare dhe operacionale.....	55
6.3. Integrimi i Qendrave të Kompetencës.....	56
6.4. Relevanca e profileve për tregun e punës.....	57
6.5. Menaxhimi i cilësisë në arsim profesional.....	61

6.6. Kurrikula dhe standardet profesionale.....	62
6.7. Mobiliteti dhe punësimi i nxënësve	63
6.8. Sistemi kombëtar i kualifikimeve	63
7. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE.....	64
7.1. Legjislacioni i zhvillimit profesional të mësimeve.....	69
7.2. Kapaciteti për menaxhim	70
7.3. Vlerësimi i nevojave për trajnime.....	71
7.4. Databaza e trajnimeve	71
7.5. Akreditimi i programeve për ZHPM.....	72
7.6. Certifikimi i trajnerëve	72
7.7. Licencimi dhe promovimi i mësimeve	73
7.8. Zhvillimi profesional i bazuar në shkollë	74
7.9. Monitorimi/vlerësimi i trajnimeve	75
7.10. Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare.....	75
7.11. Njohja e mësimit paraprak.....	75
7.12. Harmonizimi i programeve të fakulteteve	76
7.13. Kërkimi shkencor në zhvillim profesional të mësimeve	77
8. ARSIMI I LARTË DHE SHKENCA	78
8.1. Legjislacioni i arsimit të lartë.....	79
8.2. Përfshirja në arsimin e lartë.....	80
8.3. Mundësitë e barabarta	82
8.4. Ndërlidhja e arsimit të lartë me tregun e punës	83
8.5. Buxheti dhe menaxhimi financiar	88
8.6. Kapaciteti për vetë-financim	89
8.7. Menaxhimi i cilësisë në mësime dhe kërkim shkencor	90
8.8. Kërkimi shkencor, inovacioni dhe transferi i teknologjisë.....	94
8.9. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor	96
9. ARSIMI DHE AFTËSIMI I TË RRITURVE	98
9.1. Legjislacioni	99
9.2. Kapaciteti administrativ	99
9.3. Shërbimet e arsimit për të rritur	99
9.4. Sigurimi i cilësisë	100
9.5. Kordinimi ndër-institucional.....	101
9.6. Financimi.....	101
10. TEKNOLOGJIA E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT	102
10.1. Strategjia për informim dhe komunikim	102
10.2. Infrastruktura e TIK.....	103
10.3. Zhvillimi i burimeve njerëzore.....	103
10.4. Integrimi i TIK në mësime	104
11. FINANCIMI	105
11.1. Pasqyrë e përgjithshme.....	105
11.2. Edukimi parashkollor (EPSH)	105

.....	
11.3.Arsimi Parauniversitar	106
11.4 Arsimi profesional	108
11.5.Arsimi dhe Aftësimi i Të Rriturve	109
11.6.Arsimi i Lartë dhe Shkenca	109
12. REKOMANDIME	111
12.1. Menaxhimi dhe llogaridhënia.....	111
12.2. Përfshirja në sistemin arsimor	113
12.3. Relevanca dhe ndërlidhja e arsimit me tregun e punës	113
12.4. Rekomandimet nënsektorale	114
REFERENCAT	124

Indeksi i Figurave

Figura 1	Papunësia sipas nivelit të shkollimit
Figura 2	Shkalla e popullësisë 30-34 vjec me kualifikim post-sekondar jo terciar dhe universitar 2011-2014
Figura 3	NEET Shkalla e popullësisë 15-24 jashtë punësimit dhe shkollimit 2014
Figura 4	Projeksionet e grupmoshave sipas nivelit të shkollimit (2011-2021
Figura 5	Numri i nxënësve dhe shpenzimet në nivelin parauniversitar
Figura 6	Financimi i sektorit të arsimit 2011-2014
Figura 7	SHBR Përfshirja në arsim në të gjitha nivelet 2011-2015
Figura 8	Kualifikimet e mësimdhënësve 2011-2015
Figura 9	Orientimi i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë profesional 2014/2015
Figura 10	Numri i studentëve në arsimin e lartë 2010-2015
Figura 11	Indeksi i zbatimit të PSAK Edukim Parashkollor 2011-2016
Figura 12	Përfshirja në edukim parafillor 2011-2015: planifikuar dhe zbatuar
Figura 13	Përfshirja në edukim parashkollor (0-5): planifikuar dhe arritur 2011-2016
Figura 14	Kualifikimet e edukatoreve në edukim parashkollor 2010-2014
Figura 15	Indeksi i realizimit të PSAK Arsimit Parauniversitar 2011-2016
Figura 16	Arritshmëria e nxënësve në testin e maturës dhe semi-maturës 2011-2014
Figura 17	Financimi dhe parametrat sasior të cilësisë 2011-2015
Figura 18	Shkalla e zbatimit të kurrikulës së re KKK në shkolla: planifikuar dhe arritur 2011-2015
Figura 19	Indeksi i zbatimit të PSAK Arsimit Profesional 2011-2015: planifikuar dhe arritur
Figura 20	Orientimi i nxënësve të arsimit profesional në raport me tendencën e krijimit të vendeve të punës në Kosovë 2004-2014
Figura 21	Orientimi i nxënësve të arsimit profesional në Kosovë sipas profileve 2014/2015 në komuna
Figura 22	Kualifikimet e mësimdhënësve në arsimin profesional 2010-2015
Figura 23	Indeksi i zbatimit të PSAK Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve
Figura 24	Numri i mësimdhënësve sipas gjinisë
Figura 25	Kualifikimet e mësimdhënësve 2010-2015
Figura 26	Shkalla e mësimdhënësve të (pa) kualifikuar në komuna
Figura 27	Rrogat e mësimdhënësve në raport me rrogen mesatare në vende të ndryshme 2013-2015
Figura 28	Indeksi i zbatimit të PSAK Arsimit të Lartë
Figura 29	Përfshirja në arsim të lartë
Figura 30	Numri i studentëve në 100,000 banorë në Kosovë krahasuar me vende rajonale dhe Evropiane 2015
Figura 31	Studentët sipas etnisë/gjinisë
Figura 32	Përqindja e studentëve sipas fushave të studimit në Kosovë dhe BE në raport me tendencën e krijimit të vendeve të punës në Kosovë 2004-2014
Figura 33	Orientimi i studentëve në fusha të studimit

Figura34	Përqindja e programeve sipas fushave të studimit publik/privat në raport me numrin e përgjithëshëm të programeve të akredituara 2015
Figura 35	Koncentrimi i studentëve publik/privat sipas fushave të studimit
Figura 36	Rankimii Universiteve rajonale në Ëebometrics 2015
Figura 37	Luhatjet e parametrave sasior të cilësisë në institucionet publike të arsimit të lartë 2010-2015
Figura 38	Raporti mësimdhënës-student në shtete të ndryshme
Figura 39	Numri i publikimeve të indeksuara në WOS dhe Scopus 2003-2013
Figura 40	Shpenzimet për kërkim dhe zhvillim si përqindje e BPV
Figura 41	Indeksi i Realizimit të PSAK ARRR 2011-2016
Figura 42	Indeksi i Realizimit të PSAK TIK 2011-2016
Figura 43	Tendenca e shpenzimeve komunale për edukim parashkollor 2011-2014
Figura 44	Tendenca e shpenzimeve për Arsim Parauniversitar 2011-2014
Figura 45	Tendenca e shpenzimeve kapitale për Arsim Parauniversitar 2011-2014
Figura 46	Tendenca e shpenzimeve për Arsim për të Rritur
Figura 47	Tendenca e shpenzimeve në Arsimin e Lartë

Indeksi i Tabelave

Tabela 1	Krahasim rajonal i papunësisë dhe pjesëmarrjes së fuqisë punëore në treg të punës
Tabela 2	Shpenzimet në arsim sipas treguesve standard 2011-2014
Tabela 3	Fizionomia e sistemit arsimor në Kosovë 2014/2015
Tabela 4	Shkalla bruto e përfshirjes në nivelet arsimore 2014/2015
Tabela 5	Kosova në raport me treguesit e EU 2020
Tabela 6	Luhatja e parametraave të cilësisë në Edukim Parashkollor
Tabela 7	Trajnimet për ngritje të kapacitetit menaxhues 2011-2015
Tabela 8	Numri i planeve zhvillimore në komuna dhe shkolla 2011-2015
Tabela 9	Te dhënat bazë mbi progresin e zbatimit të kurrkulës së re
Tabela 10	Përfshirja e mësimdhënësve në trajnime e shprehur në orë dhe përqindje 2011-2015
Tabela 11	Kuadri mësimdhënës sipas gjinisë në nivele të ndryshme arsimore
Tabela 12	Trajnimet në zhvillim të kapacitetit menaxhues 2011-2015
Tabela 13	Numri i programeve të trajnimit të akredituara 2011-2015
Tabela 14	Përfshirja e mësimdhënësve në trajnime shprehur në orë 2011-2015
Tabela 15	Numri i planeve zhvillimore në shkolla 2011-2015
Tabela 16	Numri i programeve dhe studentëve në Fakultetin e Edukimit/Universiteti i Prishtinës
Tabela 17	Numri i studentëve në Arsimin e Lartë 2011-2015
Tabela 18	Programeet e akredituara në arsimin e lartë
Tabela 19	Shpenzimet në arsim të lartë 2011-2014
Tabela 20	Shpenzimet për kokë studenti 2011-2014
Tabela 21	Numri i institucioneve të arsimit të lartë 2011-2015
Tabela 22	Numri i të diplomuarve publik/privat 2011-2015
Tabela 23	Personeli akademik me kontratë të rregullt në institucione publike të arsimit të lartë
Tabela 24	Personeli akademik me honorar në institucionet publike të arsimit të lartë
Tabela 25	Diplomat e njohura nga ENIC/NARC 2011-2015
Tabela 26	Shkalla e përdorimit të TIK në shkolla
Tabela 27	Trajnimet e mësimdhënësve për TIK 2011-2015
Tabela 28	Totali i shpenzimeve në Edukim Parashkollor 2011-2015
Tabela 29	Totali i shpenzimeve në Arsim Parauniversitar 2011-2014
Tabela 30	Numri i studentëve në Arsim Profesional
Tabela 31	Shpenzimet për kokë nxënësi në Arsim Profesional
Tabela 32	Shpenzimet për Arsimin e Të Rrëturve 2011-2014
Tabela 33	Shpenzimet në arsimin e lartë
Tabela 34	Shpenzimet për kokë studenti në arsimin e lartë

Shkurtesat

AAK	Agjencia e Akreditimit e Kosovës
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AKM	Avancimi i Kualifimit të Mesimdhënësve
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
AKPP	Agjencia e Kosovës për Promovim dhe Punësim
AKVS	Autoriteti për Kurrikula, Vlerësim dhe Standarde
ANV	Arsimi për Nevoja të Veçanta
AGJGJJ	Arsimi Gjatë Gjithë Jetës
APU	Arsimi Parauniversitar
APP	Arsimi Profesional
AARR	Arsimi dhe Aftësimi i të Rriturve
AARRAP	Agjencia për Arsim dhe Aftësim të Rriturve dhe Arsim Profesional
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BEP	Basic Education Programme
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
DIEKP	Departamenti për Integrim Evropian dhe Kordinim të Politikave
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
ECDL	Leja Evropiane për Ngasjen (përdorimin) e Kompjuterëve
EGJ	Edukimi për të gjithë
EMIS	Education Management Information System
ETF	Fondacioni Evropian për Aftësim
EJL 2020	Strategjia Evropa Jug-Lindore 2020
EKPB	Ekipi i Kosovës për Promovimin e Bolonjës
ENQA	Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
EPSH	Edukimi Parashkollor
GKAPU	Grupi Këshillëdhënës për Arsimin Parauniversitar
IAAP	Institucionet e Arsimit dhe Aftësimi Profesional
IPA	Instrumenti për Ndihmë për Përafrim
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
KAAP	Këshilli i Arsimit dhe Aftësimi Parauniversitar
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KEC	Qendra Arsimore e Kosovës
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
KKK	Korniza Kurrikulare e Kosovës
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
KKSH	Këshilli Kombëtar i Shkencës
KLPK	Komisari i Lartë për Pakicë Kombëtare
KSHLM	Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve
LAPU	Ligji për Arsimin Parauniversitar

MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MKK	Ministria e Komuniteteve dhe e Kthimit
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
NVM	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme
NEET	Jashtë Edukimit dhe Shkollimit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OECD	Organizata për Bashkepunim dhe Zhvillim Ekonomik
PISA	Programme for International Student Assessment
PSAK	Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2011 -2016
QK	Qendrat e Kompetencës
QP	Qendra e Përsosmërisë
QTSA	Qasja Tërësektorale në Arsim
SNKA/ISCED	Standardet Nderkombetare të Klasifikimit të Arsimit
SMIA	Sistemi i Informatave në Arsim
SHBR	Shkalla Bruto e Regjistrimit
SZHNf	Standardet e Zhvillimit në Femijeri të Hershme
TIK	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit
UA	Udhëzimi Administrativ
WOS	Web of Science
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral
ZHPM	Zhvillimi Profesional i Mesimdhënësve

Parathënie

Vlerësimi i Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës (2011-2016) është pjesë integrale e mekanizmeve të paraparë në kuadër të vendosjes së caqeve fillestare. Ky vlerësim periodik mbështetet në mekanizmin vjetor të vlerësimit Rishikimi i Përbashkët Vjetor. Qëllimi i këtij vlerësimi është të shqyrtohet progresi i arritur në përmbushjen e objektivave arsimore dhe të shërbejë si platformë për avancim të gjithëpërfshirjes, cilësisë dhe efektshmërisë së sistemit arsimor. Gjetjet e ofruara në kuadër të vlerësimeve të përgjithshme dhe atyre tematike duhet të kontribuojnë edhe në procesin e përpilimit të PSAK 2017-2021. Konkluzionet statistikore dhe cilësore mund të shërbejnë për të shqyrtuar relevancën e caqeve të sistemit arsimor, ndryshuar shtegun e veprimit për arritje të caqeve të mbetura dhe për të nënvizuar rëndësinë e ndërtimit të kapacitetit për vlerësim në të ardhmen.

Qeveria dhe politikë-bërësit e sektorit të arsimit kanë rritur vëmendjen drejt vlerësimit të sistemit arsimor, vlerësim të jashtëm të studentëve, vlerësim të performancës së mësimeve dhe vlerësim të shkollave. Këto mekanizma përdoren për të kuptuar performancën e nxënësve dhe studentëve dhe për të informuar prindërit dhe shoqërinë në përgjithësi, në lidhje me performancën arsimore. Rezultatet e proceseve të vlerësimit janë duke u përdorur për të përcaktuar shkallën e avancimit të sistemit arsimor dhe për t'i mundësuar politikë-bërësve të ndryshojnë shtigjet e veprimit dhe investimit të të mirave publike.

Ekzistojnë disa faktorë që kanë ndikuar në përdorimin e vlerësimit si proces esencial në ciklin e politikë-bërjes në arsim. Fillimisht ka një kërkesë në rritje për efektshmëri, qasje të barabartë dhe cilësi në arsim, si parakushte për të tejkaluar sfida shoqërore dhe ekonomike. Së dyti, trendi i decentralizimit të sistemit arsimor ka kushtëzuar zhvillimin e mekanizmeve të vlerësimit – MASHT nuk është zbatues i drejtpërdrejtë dhe përgjegjës primar në arsimin parauniversitar dhe atë universitar, mirëpo është mandatuar të ofroj politika, standarde dhe llogaridhënie në sistemin arsimor. Rezultatet e sistemit arsimor po përdoren si mekanizëm për të ngritur llogaridhënien e komunave, shkollave dhe mësimeve për (mos) progresin e nxënësve. Së treti, sistemi arsimor në Kosovë është komponentë e rëndësishme e strategjive kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe raportimi i arritjeve dhe sfidave drejt shtegut të zbatimit të këtyre strategjive, po prioritetizojnë ndërtimin e kapaciteteve për vlerësim. Sistemet arsimore maten mbi bazën e performancës së tyre në raport me indikatorë të rëndësishëm ndërkombëtar të monitoruar nga BE (Eurostat), OKB (UNESCO) dhe OECD. Ndërlidhja e treguesve arsimor kombëtar me ata ndërkombëtar është praktikë e zakonshme e sistemeve bashkëkohore arsimore dhe krahasimi i tyre bëhet si shtytës për reformim të praktikave të sistemit.

Realizimi i një vlerësimi gjithëpërfshirës është proces mjaft sfidues dhe kushtëzohet nga disa zhvillime. PSAK 2011-2016 është plani i parë gjithëpërfshirës i sistemit arsimor në Kosovë dhe komponenta e vlerësimit nuk është integruar në mënyrë adekuate në kuadër të kornizës së objektivave. Plani fillestar nuk përfshin një kornizë koherente të matjes së performancës dhe kjo mund të shpjegohet nga mungesa e të dhënave të sakta statistikore mbi numrin e popullsisë, numrin e nxënësve në sistem etj. Së dyti, realizimi i një vlerësimi gjithëpërfshirës të sistemit arsimor kërkon kapacitete dhe resurse të përshtatshme për të mbuluar këtë proces. Gjatë rrjedhës së planit strategjik kemi zhvillime paralele legjislative dhe institucionale, që mund të kenë ndikuar në aftësinë e aktorëve për t'u akomoduar me procesin. Së treti, praktika e vlerësimit të jashtëm duhet të mbështetet në një metodologji gjithëpërfshirëse, që mbulon jo vetëm vlerësimin e jashtëm të sistemit arsimor, por edhe vlerësimin e jashtëm të nxënësve, mësimeve dhe shkollave. Së fundmi, procesi i vlerësimit është relevant në një kontekst arsimor ku nxënësi është në qendër të vëmendjes dhe ku sistemi arsimor është i ndërlidhur ngushtë me qëllimet ekonomike dhe shoqërore.

Procesi i vlerësimit është realizuar në kuadër të mandatit të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP) dhe me mbështetje të Projektit për Mbështetje Teknike për MASHT. Raporti paraqet një analizë të pavarur të zhvillimeve më të rëndësishme në sektorin e arsimit. Një pjesë e rëndësishme e këtij vlerësimi janë Raportet e Përbashkëta të Vlerësimit të realizuara ndërmjet viteve 2011-2014 dhe analizat tematike të realizuara në kuadër të programeve nën-setoriale të PSAK. Të dhënat statistikore të përdorura në kuadër të këtij vlerësimi mbështeten kryesisht në të dhënat e Sistemit për Menaxhim të Informatave në Arsim (EMIS). Të dhënat tjera për qëllime krahasuese janë marrë nga raportet periodike të Agjencisë Kosovare të Statistikave (ASK), Eurostat, OECD dhe UNESCO.

Gjatë procesit të vlerësimit Ekipi për Vlerësim të PSAK ka diskutuar me një numër të madh të palëve të interesuara: zyrtar të MASHT, zyrtar komunal të arsimit, agjencitë të ndërlidhura me MASHT, përfaqësues të institucioneve universitare, përfaqësues të shkollave, mësimdhënës, organizata të shoqërisë civile, hulumtues shkencor dhe partnerë zhvillimor. Për të ofruar një përfshirje më të gjerë të palëve të interesit, Ekipi ka organizuar një seri të tryezave tematike rreth edukimit parashkollor, arsimit parauniversitar, arsimit profesional, arsimit të të rriturve, arsimit të lartë dhe shkencës, zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe çështjeve të ndërlidhura. Përpos tryezave Ekipi ka diskutuar dhe intervistuar një numër të konsiderueshmë të zyrtarëve me përgjegjësi të drejtpërdrejtë në zbatimin e objektivave. Së fundmi, procesi i vlerësimit mbështetet edhe në vlerësimet e përgjithëshme dhe tematike të realizuara nga institucione të tjera të jashtme. Ekipi ka konsultuar një seri të dokumenteve strategjike, dokumenteve analitike, vlerësimeve të jashtme dhe raporteve periodike të ndërlidhura me sistemin arsimor në Kosovë.

Ky Raport Vlerësimi është i organizuara në disa pjesë. Në pjesën e parë ofrohet një përshkrim në lidhje me kontekstin kombëtar dhe zhvillimet dhe trendet në sistemin arsimor 2011-2015 dhe sfidat në vazhdim. Pjesa e dytë analizon kornizën e përgjithëshme të menaxhimit dhe vlerësimit të PSAK 2011-2016 dhe shqyrton aspektet kryesore të sistemit të vlerësimit dhe indikatorëve. Pjesët 3-8 ofrojnë analiza tematike rreth edukimit parashkollor, arsimit parauniversitar, arsimit profesional, arsimit të të rriturve, arsimit të lartë dhe shkencës, teknologjisë së informimit dhe komunikimit dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Në pjesën e nëntë paraqitet analiza dhe rrjedha financiare e PSAK. Kurse në pjesën e fundit listohen konkluzionet dhe rekomandimet

1. Përmbledhje ekzekutive

Megjithë përmirësimet e kryera, **nuk është regjistruar ndonjë rritje e ndjeshme e numrit të fëmijëve parashkollor në shkollat/çerdhet publike** - përfshirja në arsimin parashkollor (3-5) ende mbetet e vogël krahasur me cakun. Aktualisht vetëm 18 % e fëmijëve të moshës 3 dhe 4 vjeç janë të përfshirë në edukim parashkollor. Shkalla e përfshirjes viteve të fundit është rritur në përqindje, në saje të uljes së shtimit natyror, por jo në numër (rreth 5800). Shkalla e përfshirjes në edukimin parafillor (arsim i detyrueshëm) është rreth 76%. Marrë në tërësi, vetëm rreth 29% e fëmijëve të moshave 3-5 janë të përfshirë në edukimin parashkollor dhe parafillor. Evidenca e studimeve ndërkombëtare tregon që një vit i kaluar në edukim parashkollor/parafillor ndikon dukshëm në arritshmërinë e nxënësve në edukimin fillor dhe të mesëm. Orientimi i politikave të MASHT në vitin pasues duhet të ndërlihet me shtimin e kapaciteteve për të shtuar numrin e fëmijëve në arsimin e detyrueshëm parafillor (fëmijët 5 vjeç) për 5000 vende shtesë – nga rreth 21,000 sa janë aktualisht në 26,000 fëmije në arsimin parafillor. MASHT poashtu duhet të bashkëpunojë më ngushtë me komunat dhe sektorin jo-qeveritar për të shtuar kapacitetet duke synuar përfshirjen 5000 fëmijëve (3-4 vjeç) në arsimin parashkollor – nga rreth 5,500 në 10,800.

Kosova ka arritur shkallë të lartë të përfshirjes në arsimin parauniversitar, të krahasueshme me praktikat evropiane - përfshirja ende nuk është universale dhe ende mbeten grupe të vogla shoqërore që nuk janë përfshirë në sistem. **Sfida kryesore mbetet arritshmëria jo e kënaqshme** e nxënësve në testet e jashtme. Mekanizmat dhe praktika e sigurimit të cilësisë dhe llogaridhënies ende mbeten të pazhvilluar. Procesi i zbatimit të kurrikulës së re arsimore është mbrapa orarit të përcaktuar në planifikim. Për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve si pasojë e rënies së shtimit natyror të popullsisë, nën-sektori mund të përballë me implikime infrastrukturore dhe të numrit dhe strukturës së mësimdhënësve. Megjithë progresin e arritur në procesin e bartjes së përgjegjësi nga niveli qendror në nivel lokal, bartja e përgjegjësi financiare në shkollë ka hasur në disa pengesa – mungesa e kapaciteteve të shkollës, mungesa e bordeve të shkollave dhe në disa raste dëshira e komunave për të mbajtur këto përgjegjësi.

Rreth gjysma e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë zgjedhin një nga profilet e arsimit profesional, por ndërlihet mes shkollimit profesional me tregun e punës mbetet sfida që kërkon trajtim të mënjëhershëm - procesi i Torinos duhet të aplikohet me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit profesional, i cili konstatohet se tani nuk është në nivelin e duhur. Megjithë numrin e madh të ndërmarrjeve të angazhuara për ofrimin e praktikës profesionale, numri i praktikantëve të angazhuar ende mbetet shumë i vogël. Vendosja e bashkëpunimit mes shkollave dhe ndërmarrjeve ka qenë ndër sfidat kryesore për nënsektorin e arsimit profesional. Ndërtimi i kapaciteteve të stafit të shkollave për të siguruar cilësinë që kërkohet nga tregu i punës dështimin e bashkëpunimit mes shkollave dhe ndërmarrjeve si: sigurimi i instruktoreve të cilët merren me praktikantët e angazhuar në ndërmarrje, rishikimin e standarteve ekzistuese të profesionit dhe vendosja e standarteve që mungojnë, janë çështje të cilave i duhet kushtuar vëmendje. Në anën tjetër fillimi i procesit të akreditimit të shkollave profesionale nga ana e Ministrisë, nuk duket të jetë opsion i mundshëm për një diapazon afatshkurtër.

Cilësia e mësimdhënësve është faktori kryesor në arritshmërinë e nxënësve dhe cilësinë e arsimit para-universitar dhe mbetet një nga sfidat kryesore të sistemit arsimor – në vitet fundit është rritur paga për mësimdhënësit dhe kjo ka krijuar parakushte për tërheqje të mësimdhënësve të kualifikuar dhe rritjen e kërkesës së llogarisë. Paga e mësimdhënësve është mbi nivelin e të ardhurave vjetore për kokë banori (145%), praktikë e

krahasueshme me vendet e avancuara dhe mbi mesataren rajonale. Deri më tani skemat e kompensimit kanë qenë kryesisht të bazuara në kualifikimet para shërbimit, sesa në performancë. Niveli i kualifikimit të mësimdhënësve është faktor esencial në arritshmëri të nxënësve. Aktualisht rreth 40% e mësimdhënësve nuk kanë kualifikimet adekuate të përcaktuara në udhëzimin administrativ për normativën e mësimdhënies. Në anën tjetër, kuadri mësimdhënës në nivelin para-universitar është relativisht i vjetër (rreth 40% janë mbi moshën 50 vjeç) dhe kjo e rendit Kosovën në krah me 7 vende evropiane me moshën më të vjetër të mësimdhënësve. Programet e kualifikimit para shërbimit ende janë të përqëndruara në përmbajtje akademike e më pak në aspekte pedagogjike. Mësimdhënësit duhet të plotësojnë kualifikimin akademik me programe të trajnimit gjatë punës. Poashtu, nuk ka një sistem të organizuar të ofrimit të mbështetjes për mësimdhënësit e rinj.

Është rritur përfshirja në arsimin e lartë në vitet e fundit dhe shifrat aktuale e rendisin Kosovën në mesin e vendeve rajonale me më shumë studentë për 100.000 banorë - megjithëse numri i studentëve është rritur rreth 3 herë më shumë krahasur me katër vite më parë, numri i të diplomuarve ka mbetur pothuajse i njëjtë. Si rezultat i zgjerimit të shpejtë të nën-sektorit, është ulur shkalla e shpenzimeve për student ndërmjet 2011-2014. Rritja e shpejtë e numrit të studentëve poashtu ka krijuar sfida në menaxhim të cilësisë. Kosova është bërë anëtare e ENQA në vitin 2014, duke konfirmuar zbatimin e praktikave standarte evropiane në sigurim të jashtëm të cilësisë, megjithatë ka ngecje në dimensionin e mekanizmave të cilësisë së brendshme. Institucionet publike arsimore në arsimin e lartë zbatojnë praktika të ndryshme të menaxhimit financiar dhe kjo duhet të rregullohet brenda kornizës së Ligjit të ri për Arsimin e Lartë. Ende mbetet sfida zbatimi i praktikave të njehsuara në menaxhim të institucioneve publike. Kosova ka bërë progres të ndjeshëm në zbatimin e praktikave të Bolonjës, megjithatë ende mbetet vetëm vëzhguese e Grupit Punues. Oferta arsimore aktualisht është e ndryshme nga nevojat e tregut të punës dhe nevojat për shkathtësi në sektorët strategjik qeveritar. Përpos mospërputhjes së shkathtësive të ofruara, sfida mbetet promovimi i kërkimit shkencor dhe ndërlidhja e institucioneve arsimore, kërkimit shkencor dhe industrisë. Shpenzimet qeveritare në kërkim shkencor janë të vogla krahasur me kërkesën ligjore për alokim të 0.7% të buxhetit vjetor qeveritar në kërkim shkencor dhe zhvillim.

Ndër sfidat primare në sistemin arsimor mbetet pjesëmarrja e ulët në arsimin gjatë gjithë jetës, ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për promovim të arsimit të të rriturve dhe sigurimi i financimit për këtë prioritet - deri më tani nuk ka skemë të financimit dhe formulë të financimit për arsimin e të rriturve. Funksionalizimi dhe ngritja e kapaciteteve të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit të të Rriturve si dhe Këshillit të Agjencisë është sfida dhe kusht paraprak për krijimin e një qasje më koherente në arsimin e të rriturve, me qëllim bashkimin e të gjithë aktorëve relevant, si ofertuesit, ashtu edhe kërkuesit e arsimit dhe aftësimit të të rriturve. Gjithashtu konsiderohet se nuk ka pasur kapacitete të kuadrove për të trajtuar nevojat e arsimit të të rriturve. Zbatimi i prioritetëve të këtij nën-sektori është bërë kryesisht në suaza të arsimit profesional dhe zbatuar nga organizata jo-qeveritare dhe biznesore. Koordinimi i palëve të interesit, sektorit publik dhe atij privat është në nivelin e duhur. Kapacitetet për të monitoruar zhvillimet dhe ato të politikëbërjes janë të kufizuara si rezultat i mungesës së burimeve financiare.


Sistemi arsimor ka qasje të ulët në teknologji të informimit dhe komunikimit dhe teknologjia bashkëkohore ende nuk është integruar në mënyrë të përshtatshme në kurrikulë, mësimdhënie dhe menaxhim të sistemit arsimor - zbatimi i strategjisë për inkorporim të TIK në mësimdhënie nuk ka shkuar me hapat e projektuar. Ngritja e cilësisë në të gjitha nivelet është e kushtëzuar nga aftësia e mësimdhënësve dhe nxënësve për të përvetësuar mjetet bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknologjisë. Pajisja e shkollave me kompjuter dhe

.....

lidhje me internet ka përparuar, mirëpo ende mbetet mbrapa shkallës së shtrirjes së tyre në nivel vendi. Përpjestimi kompjuter-nxënës në shkollat e Kosovës është 1:46, që paraqet një ngecje në raport me vendet e Bashkimit Evropian ku një kompjuter u shërben 3 deri në 7 nxënësve (EC, 2013). Pajisja e shkollave me pajisje adekuate për teknologji informative dhe kompjuter është ende larg cakut.

Sfidë kryesore në menaxhimin e sistemit arsimor mbetet koordinimi i planeve dhe prioriteteve brenda një kornize të bashkërenduar të planifikimit dhe monitorimit - planet strategjike në arsimin e Kosovës zbatohen në kontekst të përgjegjësisë të ndara dhe pjesëmarrjes së institucioneve dhe organeve autonome në punën e tyre. Përfshirja e komunave, institucioneve të arsimit të lartë dhe sektorit privat është esenciale për avancim të zbatimit të planeve arsimore. Kapaciteti për mbledhje dhe përpunim të dhënave në arsim është rritur dukshëm, mirëpo kërkohet vëmendje më e lartë ndaj nevojës së sigurimit të të dhënave me fokus tek nxënësi dhe studenti, mbledhja dhe raportimi i të dhënave mbi ndikimin e arsimit në punësim dhe rritja e kapaciteteve të nivelit lokal për raportim dhe përpunim të të dhënave. Ende mbetet sfida bashkërendimi i të dhënave në arsim dhe përditësimi i treguesve të arsimit sipas rekomandimeve të Eurostat/Unesco/OECD dhe ndërtimi i sistemeve për të dhëna në arsim të lartë, arsim të rritur dhe kërkim shkencor.

Në bazë të përpunimit të të dhënave sasiore dhe cilësore vlerësohet se shkalla e realizimit të përgjithshëm të PSAK 2011-2016 është 2.5 nga 5. Përlllogaritja është bërë përmes indeksit të zbatimit (1-5). Shkalla 1 nënkupton shkallën më të ulët të realizimit ndërsa shkalla 5 shkallën më të lartë të zbatimit. Kriteret për llogaritjen e indeksit janë paraqitur në Kapitullin 2 (Metodologjia). Më së shumti progres në zbatim është arritur në programin arsimi parauniversitar, arsimi i lartë dhe arsim profesional. Programet Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve dhe Edukimi Parashkollor kanë shkallë më të ulët të zbatimit (2). Ndërsa, arsimi i të rriturve dhe teknologjia e informimit dhe komunikimit kanë shkallë shumë të ulët të realizimit (1). Indeksi nuk pasqyron domosdoshmërisht gjendjen në sektorin përkatës por reflekton vetëm në shkallën e realizimit të objektivave të PSAK.



2. Arsimi në Republikën e Kosovës (2011-2015)


2.1. Konteksti ekonomik dhe social

Anketa e fuqisë punëtore e vitit 2013 tregon se tregu i punës në Kosovë është në gjendje më të vështirë krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Shkalla e pjesëmarrjes së popullsisë në moshë pune (15-64 vjeç) në fuqinë punëtore në Kosovë është vetëm 40.5%, prej të cilëve 30% janë të papunë, ndërsa 59.5% e popullsisë konsiderohet ekonomikisht joaktive, që do të thotë se ata nuk janë të punësuar dhe nuk janë aktivë në kërkim të punësimit. Ndërkohë, në vendet e Ballkanit Perëndimor shkalla e pjesëmarrjes së popullsisë në moshë pune në fuqinë punëtore sillet nga 43% në 68% dhe 71.8% në vendet e Bashkimit Evropian (BE 28). Një pjesë e këtyre dallimeve është për faktin se Kosova ka një popullsi të re dhe shumë prej këtyre të rinjve janë ende në shkollim (dhe për rrjedhojë klasifikohen si joaktivë). Shqetësim tjetër është se me kalimin e kohës mundësia që popullata joaktive të rritet mbetet e lartë pasi çdo vit afërsisht 33,000-34,000 të rinj i shtohen popullsisë në moshë pune, ndërkohë që vetëm rreth 10,000 do të hiqen nga popullsia në moshë pune (d.m.th. 64 vjeçarët bëhen 65 vjeçarë).


Tabela 1: Krahasim rajonal i shkallës së papunësisë dhe pjesëmarrjes së fuqisë punëtore

	Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore	Shkalla e papunësisë	Raporti punësuar ndaj popullësisë
Kosova	40.5%	30%	28.4%
Shqipëria	61.8%	17.7%	50.5%
Maqedonia	63.9%	31.2%	44%
BH	43.6%	27.5%	31.6%
Mali i Zi	59%	19.7%	47.4%
Serbia	60.4%	23.1%	46.4%
EU 28	83.6%	10.5%	64.1%
Burimi:ASK/EUROSTAT 2014			

Arsimi është parakusht themelor për rritje ekonomike dhe përmirësim të standardit të jetesës në ekonominë bashkëkohore. Përpjekja e Kosovës në arritjen e këtyre qëllimeve domosdoshmërisht varet nga shkalla e produktivitetit të fuqisë punëtore. Cilësia, shkalla e përfshirjes dhe numri i viteve të shkollimit jo vetëm që kanë ndikim të pashmangshëm në përmirësimin e kapitalit njerëzor dhe krijimit të parakushteve për zhvillim social dhe ekonomik, mirëpo paraqet edhe input esencial për të përmirësuar shanset e punësimit. Anipse shkalla e papunësisë ende mbetet e lartë, të dhënat tregojnë se niveli i ulët i edukimit dhe arritshmërisë zbeh shanset e punësimit. Shkalla e papunësisë tek të diplomuarit me arsim të lartë është posaçërisht e ulët (15.5%) dhe tek ata me arsim profesional (27.6%). Shifrat e papunësisë tek të arsimuarit me arsim të lartë të përgjithshëm, të mesëm të ulët dhe fillor janë mbi mesataren e papunësisë në nivel vendi (ASK, 2014). Poashtu, në bazë të Anketës së Ndërmarrjeve (ASK, 2013), rreth 25% e ndërmarrjeve të angazhuara në prodhim theksuan mungesën e shkathtësive adekuata si pengesën kryesore në aktivitetin e tyre biznesor. Të dhënat ritheksojnë nevojën e rritjes së përfshirjes në arsim cilësor dhe ndërlidhjen e arsimit me tregun e punës.




Produktiviteti i fuqisë punëtore në Kosovë është i ulët krahasuar me ekonomitë e avancuara rajonale dhe të BE (OECD, 2015). Avancimi i shkathtësive dhe kompetencave të fuqisë punëtore është i lidhur ngushtë me kapacitetin e tyre për pjesëmarrje aktive në ekonomi dhe shoqëri. Shkollimi është masë esenciale në formimin e kapitalit njerëzor dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve. Struktura e fuqisë punëtore në Kosovë për nga nivelet e kualifikimit nuk dallon në mënyrë të theksuar nga ato të vendeve të BE-së. Kjo sjell në sipërfaqe çështjen e relevancës së kualifikimeve për tregun e punës dhe cilësinë e programeve të ofruara. Kjo nënvizon rëndësinë që përfshirja në sistem arsimor dhe avancimi në kualifikim nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe që programet e ofruara janë cilësore. Në Kosovë kemi një anomali strukturore në tregun e punës – ndërmarrjet janë në kërkim të shkathtësive të cilat mungojnë në tregun e punës në ndërkohë që numri i të diplomuarve të papunështë në rritje.



Numri i të diplomuarve në Kosovë nga arsimitë terciar mbetet ende i vogël (shiko grafën). Përqindja e të diplomuarve të grupmoshës 30-34 sipas treguesit të Eurostat tregon kapacitetin e fuqisë punëtore të kualifikuar për të hyrë në tregun e punës. Rritja e numrit të popullsisë me kualifikime të avancuara është një nga objektivat e Traktatit të Lisbonës dhe pjesë esenciale e Strategjisë 2020 të Evropës Jug-Lindore (EJL 2020). Përqindja e të diplomuarve nga arsimi i lartë në rajon është përgjithësisht i ulët në krahasim me mesatarën e ekonomive të avancuara të BE-së dhe vendeve të OECD. Numri i të diplomuarve në Kosovë është rritur nga 8% në vitin 2011 në 12% në vitin 2014. Megjithatë Kosova ka arritur përfshirje të lartë të studentëve në arsimin e lartë, kjo nuk është përkthyer në rritje të numrit të të diplomuarve.


Pjesëmarrja në punësim, edukim apo trajnim i popullsisë së re është parakusht i rëndësishëm për hyrje në tregun e punës. Shkalla e popullsisë së re që është jashtë shkollimit, edukimit apo trajnimit në Kosovë është tepër e lartë kahasuar me vendet tjera rajonale dhe të BE-së. Shqetësim në rritje mbetet fakti që sipas anketës së fuqisë punëtore (ASK, 2014) rreth 124,500 të rinj (15-24 vjeç) nuk ndjekin shkollimin dhe nuk ishin të punësuar. Ata përfaqësojnë rreth 35% të popullsisë së re në Kosovë

Figura 3: NEET Shkalla e popullsisë 15-24 jashtë punësimit dhe shkollimit 2014




Kosova është duke kaluar në një fazë të ndryshimeve të konsiderueshme demografike. Në bazë të projeksioneve të popullsisë (ASK, 2011), do të regjistrohet një rënie e ndjeshme e numrit të nxënësve në nivelin fillor dhe të mesëm. Ulja e numrit të nxënësve do të ndikojë në uljen e numrit të paraleleve në shkolla, zvogëlim të nevojës për mësimdhënës dhe potencialisht edhe uljen e numrit të shkollave. Në anën tjetër, lëvizja e popullsisë nga fshati në qytet do të shkaktojë ngarkesë më të madhe në shkollat urbane dhe numër të ulët të nxënësve sidomos në zona të largëta rurale.

Figura 4: Projektionet e grupmoshave sipas nivelit të studimit (2011-2021)



Ndryshimet demografike dhe rritja e financimit ka rezultuar me rritjen e shpenzimeve për nxënës. **Financimi në sektorin e arsimitëshhtë rritur në mënyrë të vazhdueshme** që nga viti 2011. Shpenzimet në arsim, si në raport me bruto prodhimin vendor, ashtu edhe në raport me shpenzimet e përgjithshme publike, janë në shkallë të krahasueshme me vendet e rajonit dhe BE-së dhe në vlerë absolute janë rritur çdo vit. Por, baza e vogël e GDP dhe numri i madh i nxënësve, kanë kushtëzuar shpenzime më të ulëta për nxënës/student, krahasuar me vendet e rajonit dhe ato të BE. Në anën tjetër, sipas shpenzimeve të vitit 2014, pjesa më e madhe e buxhetit ka shkuar për paga dhe mëditje (71.4%). Financimi në të ardhmen duhet përqendruar në përmirësimin e parametrevë të cilësisë, infrastrukturën e brendshme, tekste dhe mjete të konkretizimit.



Në kuadër të programeve të PSAK, financimi i programit të Arsimit Parauniversitar është rreth 68% e shpenzimeve të tërësishme. Shpenzimet në këtë nivel arsimor janë rritur dukshëm nominalisht mirëpo zvogëluar në raport me shpenzimet e përgjithëshme në arsim të shprehura në përqindje. Shpenzimet në nën-sektorin e arsimit të lartë janë rritur ndjeshëm si në vlerë monetare ashtu edhe në përqindje të shpenzimeve të programeve nga rreth 16% në vitin 2011 në rreth 19.5% në vitin 2014. Shpenzimet në arsimin profesional nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të dukshëm në tendencën e shpenzimeve. Sidoqoftë, financimi në këtë nën-program është i vogël krahasuar me shkallën e prioritetin nacional. Shpenzimet në nën-sektorin e edukimit parashkollor kanë pësuar ndryshime të vogla dhe mbeten tejet të ulëta në raport me shpenzimet e përgjithshme në arsim (3%). Shpenzimet në nën-programe tjera si arsimit i të rriturve janë pothuajse të parëndësishme në raport me rëndësinë e saj për sektorin arsimor.




Tabela 2: Shpenzimet (milion euro) në arsim sipas treguesve standard dhe nënsektorëve 2011-2014

	2011	2012	2013	2014
GDP (BPV)	4,773	4,916	5,327	5,581
Shpenzimet nësektorin e arsimit	218.9	230.4	230.5	262.3
% GDP në arsim	4.60%	4.70%	4.30%	4.70%
Buxheti i Qeverisë në total	1,415	1,441	1,469	1,589
Buxheti (%) arsim	15.50%	16.00%	15.70%	16.50%
Financimi qendror	65.4	71.4	69.9	81
Financimi lokal (komuna)	153.5	159	160.5	181.3
Financimi i arsimit parauniversitar	183.95	192.57	188.80	210.99
Financimi në arsimin e lartë	34.63	37.62	41.02	50.76

Burimi: Ministria e Financave/MASHT

Shenim (1) : Financimi lokal përfshin jo vetëm grantin specifik për arsim por edhe të hyrat vetanake (vetëfinancimin), grantin e përgjithshëm. Shpenzimet në nivelin parauniversitar përfshijnë financimin lokal dhe shpenzimet e MASHT të dedikuara për nivelin e arsimit parauniversitar. Shpenzimet në arsimin e lartë përfshijnë shpenzimet e institucioneve publike arsimore, shpenzimet e MASHT për arsimin e lartë, UP, ASHAK, AKSP, BK.

2.2. Fizionomia e sistemit arsimor

Sistemi i arsimit në Kosovë përfshin një numër të hisedarëve institucional të nivelit qendror dhe lokal. MASHT është institucioni kyç qeveritar për politikë-bërje, koordinim dhe vlerësim të sistemit arsimor. Sipas Ligjit për Arsim Parauniversitar, komunat, përmes Drejtorive Komunale për Arsim (DKA) zbatojnë politikat dhe menaxhojnë arsimin parauniversitar.

MASHT zhvillon politikat dhe standardet e arsimit parauniversitar përfshirë kornizën e kurrikulës, standardet e mësimdhënies, kualifikimet profesionale dhe sistemet e vlerësimit. Krahas aspektit legjislativ dhe rregullativ, Ministria e Arsimit organizon edhe procesin e vlerësimit të jashtëm të progresit, vlerësimit të jashtëm të studenteve, zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe mbështetjen përmes mjeteve dhe hapësirave shkollore. Komunat menaxhojnë financat e arsimit parauniversitar përmes granteve specifike për arsim të alokuara nga niveli qendror. MASHT organizon dhe përcakton formulën e arsimit për komuna në bashkëpunim me MF, duke u bazuar në parimin e financimit sipas numrit të nxënësve. Formula e financimit përfshin edhe provizione për financim shtesë për shkollimin në zona të larta rurale, arsim të komuniteteve dhe arsimit me nevoja të vecanta.

Sistemi arsimor në Kosovë organizohet sipas strukturës së bazuar në katër nivele: edukimi parashkollor (ISCED 0), shkollimi fillor (ISCED 1), arsimi i mesëm i ulët (ISCED 2), arsimi i mesëm i lartë (ISCED 3) dhe arsimi i lartë (ISCED 4).

Tabela 3: Fizionomia e sistemit arsimor në Kosovë 2014/2015

	Detyrueshmë	Grupmosha	Nr i nxënësve (2014/2015)	Nr institucioneve (publike/private)	Mësimdhënës
Edukimi Parashkollor (ISCED 0)	Jo	0-5	25,337	42	1,364
Shkollimi Fillor (ISCED 1)	Po	6-10	145,511	985	16,517
Arsimi i mesëm i ulët (ISCED 2)	Po	11-14	135,085		
Arsimi i mesëm i lartë (ISCED 3)	Jo	15-17/18	86,219	119	5,441
Arsimi i lartë (ISCED 4)	Jo		122,029	38	

2.3. Trendet kryesore

Progres i ndjeshëm në përfshirje në të gjitha nivelet arsimore - Përfshirja në arsimin parauniversitar (fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë) në vitin 2014 është në shkallë të kënaqshme edhe pse nuk është arritur përfshirje universale në arsimin e detyrueshëm. Vitet e fundit është rritur ndjeshëm përfshirja në arsimin e mesëm të lartë (shih tabelën). Megjithatë, ende mbetet për të trajtuar pjesëmarrjen në arsim të gjitha rastet e kategorive të grupeve shoqërore, si dhe atyre me nevoja të veçanta. Përfshirja në arsimin parafillor ka mbetur e qëndrueshme rreth shkallës 79%. Nuk parashihet ndonjë përkeqësim i shkallës së përfshirjes me kapacitetet ekzistuese, në sajë të rënies së shtimit natyror. Mirëpo, ende mbetet sfiduese arritja e cakut (50%) të përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor. Nuk është regjistruar ndonjë rritje e ndjeshme e numrit të fëmijëve parashkollor në shkollat/çerdhet publike. Progresi i shënuar në këtë kategori arimore është arritur më tepër në sajë të aktivitetit të sektorit privat. Në vitet në vazhdim kërkohet investim shtesë, si në infrastrukturë ashtu edhe në rritje të numrit të edukatorëve. Po ashtu, duhen shtuar përpjekjet për regjistrim të të dhënave të fëmijëve të inkuadruar në edukimin parashkollor tek qendrat e bazuara në komunitet dhe institucionet private.




Tabela 4: Përfshirja në nivelet arsimore 2010/2011-2013/2014, SMIA 2015

	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014	2014/2015
Parashkollor (3,4,5) vjeç	26.10%	27%	27.20%	26.70%	29.60%
Parafillor (5 vjeç)	71.30%	74.00%	77.43%	75.62%	79.6%
Fillor (6-)	98.10%	95.20%	98.56%	96.39%	96.4%
Mesem ulët	96.40%	99.90%	98.61%	98.03%	99.5%
Mesëm lartë	91.80%	92.10%	88.67%	87%	84.5%
Arsimi i lartë (18-24)	40.20%	41.60%	45.50%	49.40%	49.6%


Rritja e financimit dhe investimet nuk kanë prodhuar rezultate të pritshme në arritshmëri të nxënësve - Përderisa kemi patur përmirësim të vazhdueshëm në inpute

financiare, infrastrukturore dhe atë të stafit, shkalla e arritshmërisë nuk ka ecur me hapat e pritur. Rritja e financimit dhe shpenzimet infrastrukturore në shkolla nuk duket se kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e arritshmërisë. Rezulton që janë bërë përmirësime të ndjeshme në financim të arsimit, rrogave dhe parametrave të cilësisë. Rritja e financimit në arsim dhe pagave të mësimitdhënësve ka krijuar parakushtet për përmirësim të llogaridhënies në arritshmëri të nxënësve.


Prioritizimi i cilësisë, zbatimit të kurrikulës së re dhe arritshmërisë - Në vitet e mëparshme është reformuar kurrikula përmes ofrimit të një kornize të bazuar në kompetenca dhe zhvillimit të kurrikulës bërthamë, e cila konkretizon kornizën dhe ofron bazën për programet mësimore me bazë në shkollë. Po ashtu, janë zbatuar teste të standardizuara për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Sidoqoftë, arritshmëria e nxënësve në testet e jashtme dhe administrimi i tyre mbeten sfida për t'u adresuar në vitet pasuese. Meqë Kosova ka arritur përfshirje të lartë në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, aktivitetet për vitin pasues duhet të përqendrohen në përmirësim të cilësisë. Ka nevojë të investohet më tepër në forcimin e mekanizmave për sigurim të cilësisë të jashtme dhe të mbrendshme. Inspektorati i Arsimit duhet të rrisë kapacitetet për të zbatuar procesin e rishikimit dhe vlerësimit të standardizuar të shkollave. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar mekanizmave të administrimit të testit dhe formave të implementimit të tij. Gjatë vitit 2015 do të zbatohet testimi ndërkombëtar PISA. Rezultatet e këtij testimi do të krijojnë mundësi për të analizuar dhe reflektuar për progresin dhe arritshmërinë në baza komunale. Në aspektin e infrastrukturës shkollore, investimet duhet që gradualisht të orientohen nga ndërtimi i objekteve shkollore në financim të mjeteve të konkretizimit, pajisjeve dhe teksteve shkollore.

Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në avancim të kualifikimeve të mësimitdhënësve, përmirësim të ndjeshëm të pagave dhe është krijuar baza ligjore për licencim, vlerësim të përformancës. Cilësia e mësimitdhënësve ende mbetet sfidë krahas mos zbatimit të promovimit të bazuar në përformancë dhe mungesës së një sistemi funksional për zhvillim gjatë shërbimit - cilësia e mësimitdhënësve është faktori primar që përcakton arritshmërinë e nxënësve. Përmirësimi i kuadrit mësimor ndëridhet me hapa të unisuar në përmirësim të programeve të zhvillimit para shërbimit, zhvillimit profesional gjatë shërbimit, përmirësimit të kushteve të punës dhe promovimit të bazuar në përformancë. Janë zhvilluar disa programe për kualifikim të mësimitdhënësve në disa institucione publike dhe është zbatuar skema e avancimit të kualifikimeve (AKM). Është zhvilluar baza ligjore për normativin e mësimitdhënësve, zhvillimit profesional në shërbim dhe licencimit. Poashtu, është vërejtur një përmirësim substancial i kushteve të punës për mësimdhënës të pagave mbi 100% krahasuar me vitin 2010. Mësimitdhënësit në Kosovë janë ndër profesionistët më të paguar dhe me të hyra ndër më të lartat në rajon, si në terma nominal ashtu edhe real (OECD, 2015).

Megjithë progresin e ndjeshëm në avancim të kualifikimeve të mësimitdhënësve, shkalla e mësimitdhënësve të pakualifikuar dhe të kualifikuar por në lëndë jopërkatëse është rreth 42%. Rritja e pagave në mënyrë lineare dhe duke anashkaluar sistemin e vlerësimit të përformancës dhe promovimit në karrierë, mund të ndikojë negativisht në motivim të kuadrit – në bazë të të dhënave vërehet një ulje e ndjeshme e përqindjes së mësimitdhënësve me shkollim të mesëm dhe shkollë të lartë profesionale nga rreth 56 % në vitin 2010/2011 në rreth 32 %. Në të njëjtën kohë është shtuar numri i mësimitdhënësve me kualifikim universitar. Megjithatë, rreth 42% e mësimitdhënësve kanë ose kualifikime universitare jo-përkatëse ose kualifikime të niveleve më të ulëta se sa përcaktimi në normativin e mësimitdhënësve.




Arsimi profesional paraqet një nga prioritetet esenciale për të ndihmuar tranzicionin e nxënësve nga shkolla në tregun e punës. Anipse janë shënuar hapa pozitiv në arsimin profesional, ende ka shqetësime sa i përket mospërputhjes së shkathtësive të ofruara për tregun e punës. Në vitet e fundit, më shumë nxënës janë orientuar në arsimin profesional, sesa në atë të përgjithshëm dhe kjo e rendit Kosovën afër mesatares së vendeve të zhvilluara të BE-së. Sidoqoftë, vitin e fundit është zvogëluar përqindja e arsimit profesional nga 56% në vitin 2013 në 54% në vitin 2014. Sfidë kryesore në arsimin profesional mbetet ndërlidhja me tregun e punës - shkollat profesionale ende nuk kanë bashkëpunim të kënaqshëm me industrinë. Nga të dhënat e paraqitura në kapitullin respektiv, rezulton rreth 30% e shkollave profesionale specializojnë në profile për të cilat nuk ka kërkesë në treg. Është bërë progres në ofrimin e kornizës ligjore për arsimin profesional, mirëpo kemi ende ngecje në zbatimin e praktikës profesionale.



Rritje e ndjeshme e përfshirjes në arsimin e lartë por ngecje në cilësi dhe kërkim shkencor - Kosova ka tejkaluar cakun e përfshirjes në arsimin e lartë (35%) të grup- moshave 18-25. Në 10-vjeçarin e fundit, interesimi për regjistrim në arsimin e lartë është shtuar shumë. Ndërsa në vitin 2004 Kosova kishte rreth 40,000 studentë në institucionet e arsimit të lartë, në 2015 ky numër është trefishuar (122,000 studentë). Aktualisht Kosova ka 6,669 studentë / 100.000 banorë, që është shumë më tepër sesa mesatarja e BE prej 3,987 studentë në 100.000 banorë. Rritja e pjesëmarrjes është pasojë e investimeve për hapjen e institucioneve të reja publike në arsimin e lartë dhe rritjes së numrit të studentëve në arsimin e lartë privat. Por, rritja e numrit të studentëve ka ndikuar negativisht në trendin e rritjes së cilësisë. Treguesit student-

mësimdhënës dhe financimi për kokë studenti janë ulur në dy vitet e fundit. Për momentin, në Kosovë operojnë 37 institucione të licencuara të arsimit të lartë, prej të cilave shtatë janë publike dhe 30 private.



Në anën tjetër, duhet siguruar një **ndërlidhje më të ngushtë ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës**. Rezulton se rritja e numrit të studentëve në vitete fundit është orientuar më tepër në shkencat jo-ekzakte, krahasuar me shkencat ekzakte. Orientimi programor dhe i studentëve nuk përputhet me Planin e Zhvillimit Kombëtar të orientuar në sektorin e minierave, energjisë, telekomunikacionit, teknologjisë informative dhe transportit, bujqësisë dhe zhvillimit rural. Megjithatë është rritur shkalla e përfshirjes në arsimin e lartë në vitet e fundit, numri i të diplomuarve ende mbetet shumë i vogël. **Shpenzimet kombëtare dhe universitare në kërkim shkencor mbeten të vogla** - 0.1% e BPV. Të dhënat në dispozicion në fushën e kërkimit shkencor flasin për ngecje të Kosovës në këtë aspekt në raport me vendet e tjera evropiane. Kështu, me 0.1% të BPV shpenzime për punë kërkimore-shkencore dhe me 826 publikime të indeksuara në dy databazat prestigjioze (WoS dhe Scopus) në periudhën 2003-2013, Kosova mbetet larg nga standardet evropiane të zhvillimit të sektorit të kërkimeve.

Ngecje në përhapje të teknologjisë informative - Zbatimi i strategjisë për përfshirjen e teknologjisë informative dhe të komunikimit në mësimdhënie nuk ka shkuar me hapat e projektuar. Ngritja e cilësisë në të gjitha nivelet është e kushtëzuar nga aftësia e mësimdhënësve dhe nxënësve për të përvetësuar mjetet bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknologjisë. Pajisja e shkollave me kompjuter dhe lidhje me internet ka përparuar, mirëpo ende mbetet mbrapa shkallës së shtrirjes së tyre në nivel vendi. Përpjestimi kompjuter-nxënës në shkollat e Kosovës është 1:46 që paraqet një ngecje në raport me vendet e BE, ku një kompjuter u shërben 3 deri në 7 nxënësve (EC, 2013). Pajisja e shkollave me pajisje adekuate për teknologji informative dhe kompjuter është ende larg cakut.

Ka një përmirësim të kapaciteteve menaxhuese, por mbetet nevoja për përmirësim të burimeve njerëzore dhe të dhënave statistikore - Përparimet në të gjitha nivelet arsimore duhet të shkojnë paralelisht me forcimin e politikë-bërjes dhe kapacitetit të implementimit. Matja e arritshmërisë dhe monitorimi përmes SMIA është esencial për të ndihmuar orientimin strategjik të politikëbërjes dhe investimeve. Kapaciteti i monitorimit dhe vlerësimit është përmirësuar dukshëm vitete fundit, por kërkohet që të investohet në përditësimin e treguesve dhe të dhënave sipas udhëzimeve të grupit UNESCO-EUROSTAT-OECD. Procesi i rishikimit të PSAK duhet të rezultojë me riorientim të objektivave dhe caceve të

arsimit për të përfshirë konkluzionet e UOE dhe ndërlidhur me caqet e Strategjisë EKL/Europa 2020. Caqet aktuale, kryesisht të bazuara në standardet dhe caqet statistikore të UNESCO's, duhet të plotësohen me caqe të BE-së. Ndërtimi i kapaciteteve për mbledhje dhe përpunim të dhënave duhet të jetë prioritet në vazhdim.

Tabela 5: Kosova në raport me treguesit e Evropa 2020

Burimi:ASK/EUROSTAT 2013	Kosova	BE	Europe 2020
Shkalla grup-moshës 15-24 jashtë arsimit dhepunësimit	35.30%	12%	10%
Shkalla e të diplomuarve (30-34 vjeç)	12%	37%	40%
Përfshirja e fëmijëve (4-6) në arsim parashkollor	45%	93.90%	95%
Shkalla e punësimit të grup-moshës (20-34)	22.30%	75.50%	82%
Shpenzimet publike në arsim	4.7%	5.30%	-
Pjesëmarrja në VET arsim profesional	54%	50.00%	-

Komunat luajnë rol kyç në zbatimin e objektivave të PSAK. Vëmendja në vazhdim duhet përqëndruar në udhëzimin e komunave për të përgatitur plane strategjike veprimi të ndërlidhura me caqet e PSAK dhe në mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave statistikore. Komunat duhet të integrohen në procesin e planifikimit strategjik dhe të jenë në gjendje të prodhojnë plane veprimi për arritjen e caqeve për nivelet që janë kompetencë e tyre. Po ashtu, duhet të vazhdojë përpjekja për sigurimin, vetëdijësimin dhe inkorporimin e institucioneve publike dhe private në lidhje me arritjen e caqeve të PSAK.

Vëmendje e veçantë duhet kushtuar **sigurimit të të dhënave për arsimin e lartë dhe shkencën**. Kërkohet më shumë përkushtim në ndërtimin e mekanizmave për vlerësimin e arritshmërisë së studentëve në arsimin e lartë (OECD PIAAC) dhe matjen e aktivitetit shkencor.

Ndryshimet demografike—sektori i arsimit ndikohet dukshëm nga ndryshimet e ndjeshme demografike. Numri i nxënësve në nivelin parauniversitar në vitin 2014 u zvogëlua me 39,000 nxënës (9%) krahasuar me në vitin 2011. Kjo rënie ka qenë posaçërisht e ndjeshme në nivelin e arsimit fillor. Ky trend i rënies së numrit të nxënësve parashihet të vazhdojë me rënie edhe më të mëdha në vitet në vazhdim.

3. Fushëveprimi dhe metodologjia e vlerësimit

3.1. Fushëveprimi i procesit të vlerësimit

Qëllimi i vlerësimit ishte që të shërbej si (i) instrument i llogaridhënies përmes ofrimit të dhënave për arrijen e rezultateve -struktura menaxhuese ka të dhënat objektive për korrektim të kursit dhe (ii) që të shërbejë si material bazë për hartimin e planit vijues strategjik. Fushëveprimi i procesit të vlerësimit të PSAK do të përqëndrohet në ofrimin e përgjigjeve për disa pyetje: (a) cila ka qenë performanca e MASHT dhe akterëve tjerë në krahasim me qëllimet dhe caqet e vendosura në Planin fillestar; (b) sa janë relevante caqet dhe qëllimet e vendosura për kontekstin aktual dhe (c) sa është përdorur PSAK si platformë për avancim të objektivave kombëtare në sferën e arsimit.

Fillimisht ka një kërkesë në rritje për efektshmëri, qasje të barabartë dhe cilësisë në arsim si parashkushte për të tejkaluar sfida shoqërore dhe ekonomike. Së dyti, trendi i decentralizimit të sistemit arsimor ka kushtëzuar zhvillimin e mekanizmave të vlerësimit – MASHT nuk është zbatues i drejtpërdrejtë dhe përgjegjës primar në arsimin parauniversitar dhe atë universitar, mirëpo është mandatuar të ofroj politika, standarde dhe llogaridhënie në sistemin arsimor. Rezultatet e sistemit arsimor po përdoren si mekanizëm për të ngritur llogaridhënien e komunave, shkollave dhe mësimdhënësve për (mos) progresin e nxënësve. Së treti, sistemi arsimor në Kosovë është komponenti rëndësishëm i strategjive kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe raportimi i arritjeve dhe sfidave drejt shtegut të zbatimit të këtyre strategjive po priorizon ndërtimin e kapaciteteve për vlerësim. Sistemet arsimore maten mbi bazën e performancës së tyre, në raport me indikatorë të rëndësishëm ndërkombëtar të monitoruar nga BE (Eurostat), OKB (UNESCO) dhe OECD. Ndërlidhja e treguesve arsimor kombëtar me ata ndërkombëtar është praktikë e zakonshme e sistemeve bashkëkohore arsimore dhe krahasimi i tyre bëhet si shtytës për reformim të praktikave të sistemit.

Realizimi i një vlerësimi gjithëpërfshirës është proces mjaft sfidues dhe kushtëzohet nga disa zhvillime. PSAK 2011-2016 është plani i parë gjithëpërfshirës i sistemit arsimor në Kosovë dhe komponenta e vlerësimit nuk është integruar në mënyrë adekuate në kuadër të kornizës së objektivave. Planin fillestar nuk përfshin një kornizë koherente të matjes së performancës dhe kjo mund të shpjegohet nga mungesa e të dhënave të sakta statistikore mbi numrin e popullsisë, numrin e nxënësve në sistem etj. Së dyti, realizimi i një vlerësimi gjithëpërfshirës të sistemit arsimor kërkon kapacitete dhe resurse të përshtatshme për të mbuluar këtë proces. Gjatë rrjedhës së planit strategjik kemi zhvillime paralele legjislative dhe institucionale, që mund të kenë ndikuar në aftësinë e akterëve për t'u akomoduar me procesin. Së treti, praktika e vlerësimit të jashtëm duhet të mbështetet në një metodologji gjithëpërfshirëse që mbulon jo vetëm vlerësimin e jashtëm të sistemit arsimor por edhe vlerësimin e jashtëm të nxënësve, mësimdhënësve dhe shkollave. Së fundmi, procesi i vlerësimit është relevant në një kontekst arsimor, ku nxënësi është në qendër të vëmëndjes dhe ku sistemi arsimor është i ndërlidhur ngushtë me qëllimet ekonomike dhe shoqërore.

Procesi i vlerësimit është realizuar në kuadër të mandatit të Departamentit për Integrim Evropian dhe Kordinim të Politikave (DIEKP) dhe me mbështetje të Projektit për Mbështetje Teknike për MASHT. Raporti paraqet një analizë të pavarur të zhvillimeve më të rëndësishme në sektorin e arsimit.

3.2 Metodologjia

Gjatë procesit të vlerësimit Ekipi për Vlerësim të PSAK ka diskutuar me një numër të madh të palëve të interesuara: zyrtar të MASHT, zyrtar komunal të arsimit, agjencitë të ndërlidhura me MASHT, përfaqësues të institucioneve universitare, përfaqësues të shkollave, mësimdhënës,

organizata të shoqërisë civile, hulumtues shkencor dhe partnerë zhvillimor. Për të ofruar një përfshirje më të gjerë të palëve të interesit, Ekipi ka organizuar një seri të tryezave tematike rreth edukimit parashkollor, arsimit parauniversitar, arsimit profesional, arsimit të të rriturve, arsimit të lartë dhe shkencës, zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe çështjeve të ndërlidhura. Përpos tryezave Ekipi ka diskutuar dhe intervistuar një numër të konsiderueshëm të zyrtarëve me përgjegjësi të drejtpërdrejtë në zbatimin e objektivave. Së fundmi, procesi i vlerësimit mbështetet edhe në vlerësimet e përgjithëshme dhe tematike të realizuara nga institucione të tjera të jashtme. Ekipi ka konsultuar një seri të dokumenteve strategjike, dokumenteve analitike, vlerësimeve të jashtme dhe raporteve periodike të ndërlidhura me sistemin arsimor në Kosovë.

Rezultatet dhe konkluzionet e ofruara mbështeten në metoda sasiore dhe metoda cilësore. Treguesit sasior janë të harmonizuar me Kornizën e Treguesve të MASHT dhe në përputhje me treguesit ndërkombëtar të sferës së arsimit. Trendet dhe lëvizjet në analizat tematike janë nxjerrur duke u mbështetur në të dhënat e SMIA. Për të mbuluar mungesën e të dhënave në nën-sektor të caktuar janë përdorur edhe të dhënat e ASK. MASHT nuk ka një sistem për mbledhje të të dhënave në arsimin e lartë dhe Ekipi i vlerësimit ishte i detyruar të përdor pyetsorin e të dhënave dhe i njëjti i'u është dërguar të gjitha institucioneve të arsimit të lartë. Procesi i vlerësimit ka hasur disa vështirësi metodologjike. Fillimisht, objektivat dhe caqet ishin vendosur me të dhëna jo të plota – andaj disa nga caqet e vendosura ishin arritur që në kohën e miratimit të planit. Së dyti, korniza e vlerësimit të performancës dhe indikatorët nuk ishin elaboruar në mënyrë adekuate. Së treti, parametrat e matjes së progresit në fushat tematike ndryshojnë varësisht se çfarë kornize e referencës përdoret dhe së katërti, është evidente që në lexim të parë që ka shumë zhvillime tematike të cilat nuk përfshihen në caqet aktuale.

Vlerësimi është proces kompleks andaj qasja në proces duhet të mbështetet në disa perspektiva dhe modalitete të matjes së rezultateve. Treguesit sasior janë formuluar përmes **indeksit të zbatimit** i cili mbështetet në rankimin e performancës së nën-sektorëve të PSAK nga 0-5. Kriteret për përcaktim të rankut të zbatimit janë si më poshtë:

Shkalla	Kriteret	Treguesit
Shkalla 1	Korniza e politikave, rregullave dhe ligjeve	Nuk ekzistojnë ligjet primare, udhëzimet, rregullat, strategjitë dhe politikat.
	Zbatimi dhe kapaciteti institucional	- Kemi mungesë të hapave për zbatim të ligjeve dhe politikave. - Nuk janë alokuar burime për menaxhim, burime njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatim të ligjeve, rregullave, udhëzimeve, strategjive dhe politikave.
Shkalla 2	Korniza e politikave, rregullave dhe ligjeve	Ekzistojnë ligjet primare, rregullat, udhëzimet, strategjitë dhe politikat
	Zbatimi dhe kapaciteti insitucional	Ka vetëm përpjekje të kufizuara për zbatim të praktikave të mira. Zbatimi i politikave të duhura ende nuk është fenomen i zakonshëm.

	Nuk janë alokuar burime financiare apo janë të pamjaftueshme dhe nuk janë alokuar burime financiare dhe materiale.
Shkalla 3	Korniza e politikave, rregullave dhe ligjeve - Janë miratuar të ligjet dhe politika në kuadër të sektorit apo objektivit. Zbatimi dhe kapaciteti insitucional - Ekzistojnë praktika të mira dhe legjislacioni ka filluar të zbatohet në dy vitet e fundit. Mirëpo ende ka ngecje në zbatim të praktikave të caktuara, në legjislacion dhe praktika. - Janë alokuar mjete modeste financiare për zbatim të pjesëve të caktuara të legjislacionit dhe politikave.
Shkalla 4	Korniza e politikave, rregullave dhe ligjeve - Të gjitha ligjet, udhëzimet dhe politikat janë miratuar Zbatimi dhe kapaciteti insitucional - Kemi një praktikë të zhvilluar në zbatim të legjislacionit dhe udhëzimeve. Ligjet janë zbatuar në mënyrë konsistente në katër vitet e fundit. - Kapacitetet institucionale janë në funksion mirëpo me shkurtesa financiare.
Shkalla 5	Korniza e politikave, rregullave dhe ligjeve - Janë miratuar të gjitha ligjet dhe udhëzimet Zbatimi dhe kapaciteti insitucional - Janë bërë përpjekje proaktive për të eliminuar çdo praktikë të keqe. Kemi zbatim konsistent të legjislacionit në pesë vitet e fundit. Zbatimi i është normë dhe pengesat mund të jenë shumë të rralla apo të izoluara. - Kapacitetet institucionale janë plotësisht funksionale dhe financimi është adekuat për rrjedhën e zbatimit të legjislacionit dhe praktikave.


4. Edukimi Parashkollor

Gjatë procesit të hartimit të PSAK 2011-2016 kishte listuar një numër të sfidave me të cilat nën-sektori ballafaqohej: shkalla e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor ishte shumë e ulët, sigurimi i financimit për edukim parashkollor, hartimi i kurrikulave për fëmijët e moshës 0-3 vjeçare, rregullimi dhe licencimi i institucioneve private parashkollore, zhvillimi profesional i edukatorëve dhe zhvillimi i instrumenteve kombëtare për përcaktimin e cilësisë së arsimit parashkollor. Për të trajtuar këto sfida në kuadër të nën-programit të edukimit parashkollor ishin vendosur shtatë 7 objektiva kryesore me një seri të aktiviteteve:

OBJEKTIVAT EDUKIMI PARASHKOLLOR 2011-2016

- 1 Deri në vitin 2016 të gjithë fëmijët të jenë përfshirë në edukimin parafillor (5 vjec)
- 2 Deri në vitin 2016 rreth 50 % përqind e fëmijëve të grupmoshave 0-5 të jenë përfshirë në edukimin parashkollor
- 3 Deri në vitin 2016 të krijohet një sistem funksional për aftësim të edukatorëve
- 4 Janë hartuar kurrikulat për moshat 0-3 dhe 3-6 vjec
- 5 Deri në vitin 2016 të jenë përmirësuar kapacitetet për menaxhim tek të gjithë drejtuesit e institucioneve parashkollore
- 6 Deri në fund të vitit 2016, të gjithë ekspertët e edukimit parashkollor janë aftësuar duke pasur parasysh edhe baaraspeshën gjinore dhe aftësimin për edukim inkluziv
- 7 Deri në vitin 2016 është ndërtuar vetëdija tek prindërit dhe komuniteti për rëndësinë e edukimit parashkollor

Në përgjithësi, nën-programi i edukimit parashkollor ka shënuar arritje të lartë në rritjen e përfshirjes në edukim parafillor (EPSH 1). Shkalla e përfshirjes në klasën parafillore ka tejkaluar planifikimet dhe caqet. Janë shënuar hapa pozitiv edhe në kurrikulën e edukimit parashkollor (EPSH 4), aftësim të edukatoreve (EPSH) dhe vetëdijësim të prindërve mbi rëndësinë e edukimit parashkollor/parafillor (EPSH 7). Sidoqoftë, nën-programi nuk ka shënuar ndonjë progres në ngritjen e përfshirjes në edukim parashkollor (0-4) dhe përmirësim të menaxhimit të institucioneve. Shkalla e përfshirjes në edukim parashkollor ka mbetur e njëjtë që nga koha e planifikimit fillestar. Sidoqoftë, në bazë të diskutimeve me palët e interesit supozohet se është rritur shkalla e përfshirjes së fëmijëve në sektorin privat parashkollor dhe qendrat me bazë në komunitet mirëpo që të dhënat ende nuk janë regjistruar. Shkalla e realizimit në bazë të indeksit (shiko metodologjinë) është si më poshtë:




4.1.Përfshirja në edukimin parafillor

Objektivi i parë i nën-programit të PSAK Edukimi Parashkollor ishte qëderi në vitin 2016, të gjithë fëmijët pa dallim moshe, gjinie apo përkatësie etnike janë të përfshirë në arsimin parafillor. Në kuadër të planit fillestar parashihej që për ti kontribuar arritjes së këtij synimi, do të inicoheshin disa aktivitete duke përfshirë ofrimin e përkrahjes për themelimin e paraleleve të reja parafillore, për të përmirësuar përfshirjen, organizimi i fushatave për informim të prindërve mbi mundësinë e përfshirjes së fëmijëve në arsim parafillor dhe të zhvilloheshin materialet e duhura të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Nga analiza e treguesve statistikor mbi përfshirjes në arsimin parafillor (mosha 5 vjeç) rezultojnë qëkë objektivi është arritur. Caqet e vendosura mbi shkallën e përfshirjes në edukim parafillor nuk kanë qenë të bazuara në të dhëna statistikore, meqë caku i vendosur prej 70% përfshirje deri në vitin 2016 ka qenë arritur që në fillim të zbatimit të PSAK. Mangësitë e specifikuar mund të kenë rezultuar si pasojë e mungesës së një pasqyre të qartë në lidhje me numrin e popullsisë së kësaj grupmoshe dhe mangësi në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga terreni. Sidoqoftë një sfidë e tillë është tejkaluar pas publikimit të rezultateve të regjistrimit të popullsisë (ASK 2011).

Figura 12: Përfshirja në edukim parafillor (fëmijet 5 vjeç) 2011-2015 - planifikuar sipas PSAK dhe realizuar



Progresi i arritur në rritjen e përfshirjes në edukimin parafillor rezulton nga një numër i iniciativave të realizuara nga hisedarët institucional dhe mbështetja e ofruar nga partnerët zhvillimor. Sipas Ligjit mbi Arsimin Paruniversitar (2012) edukimi parafillor (mosha 5 vjeçare) është i detyrueshëm që nga viti shkollor 2015/2016. Rreth 80% e shkollave ka siguruar hapësirë për zhvillimin e edukimit parafillor ndërsa kuadri mësimdhënës është siguruar përmes dyfishimit të orarit të punës së edukatorëve. MASHT ka hartuar kurrikulën bërthamë për edukimin parafillor dhe zhvilluar dokumentin për Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6, së bashku me materialet përcjellëse si ditarët dhe udhëzuesit për mësimdhënësit. Aktivitetet e vetëdijësimit të organizuara me prindër dhe përfaqësues të komuniteteve kanë ndikuar pozitivisht drejt arritjes së synimeve.

Megjithë progresin e arritur, ende vlerësohet se rreth 25% e fëmijëve mbesin jashtë edukimit parafillor. Ana më sfiduese është përfshirja e fëmijëve të komuniteteve jo-shumicë dhe përfshirja në zonat e lagëta rurale. Për të tejkaluar këtë sfidë partnerët zhvillimor (Unicef, Save the Children, Caritas) kanë mbështetur krijimin e qendrave me bazë në komunitet dhe punësimin e edukatorëve shtesë. Prioriteti në vazhdim mbetet sigurimi i qëndrueshmërisë së qendrave me bazë në komunitet, përfshirja e komuniteteve jo-shumicë dhe përfshirja universale e fëmijë në edukim parashkollor. Natyrisht, adresimi i këtyre sfidave kërkon burime shtesë financiare, numër më të madh të edukatorëve dhe mbështetje për avancim të kualifikimeve të kuadrit mësimdhënës


4.2.Përfshirja në edukimin parashkollor

Objekti i dytë në kuadër synonte qëndëri në vitin 2016, 35 % përqind të fëmijëve pa dallim moshe, gjinie ose përkatësie etnike janë përfshirë në edukimin parashkollor. Për të mundur arritjen e këtij synimi PSAK kishte specifikuar disa aktivitete kryesore që duhej të zbatoheshin deri në fund të ciklit të planifikimit: organizohen fushata për ngritjen e vetëdijes për zhvillimin dhe edukimin në fëmijëri të hershme, të sigurohen të dhëna statistikore në lidhje me përfshirjen në edukim parashkollor në kuadër të SMIA, të stimulohen forma alternative të edukimit parashkollor dhe krijohen mjedise mike për fëmijët, tësigurohet hapësirë plotësuese për edukim parashkollor përmes ndërtimit të dhomave shtesë dhe të ndërtohen objekte të reja në pajtim me standardet.

Matja e progresit të arritur në kuadër të edukimit parashkollor (0-5 vjeç) kërkon sqarim të treguesve të matjes. Ekzistojnë praktika të ndryshme kombëtare për klasifikim të edukimit parashkollor, mirëpo në shumicën e vendeve mandati i organeve institucionale arsimore parasheh organizimin e aktiviteteve edukative ndërmjet moshave 3-5. Ligji për Arsimin Parauniversitar (2012) e klasifikon edukimin parashkollor si çdo formë e organizimit të strukturuar të edukimit parashkollor për grupmoshat 0-5 vjeç. Andaj, matja e progresit dhe krahasimi i të dhënave statistikore me vendet tjera duhet të diferencojë treguesit. Korniza e edukimit parashkollor në kuadër të PSAK, përfshin edhe edukimin parafillor (mosha 5 vjeç). Për këtë arsye në grafiket e mëposhtme do të paraqiten trendet e tre treguesve (1) PSAK(0-5 vjeç),Eurostat (3-5 vjeç) dhe OECD 4-6 vjeç. Sidoqoftë, të dhënat mbi progresin e arritur kanë kufizimet e tyre. Fillimisht kapaciteti për mbledhje të dhënave të institucioneve parashkollore është më i kufizuar sesa i niveleve tjera të arsimit parauniversitar. Së dyti, të dhënat e ofruara nuk janë të plota mbi përfshirjen në edukim parashkollor (duhet tëkihet parasysh pamundësia e institucioneve për të mbledhur të dhëna të sakta në komunat veriore të Kosovës si Leposavic, Zubin Potok, Zvecan dhe Mitrovicë veriore). Së treti, ende ka mangësi në regjistrimin e të gjithë fëmijëve që ndjekin edukimin parashkollor në institucione jo-publike.

Të dhënat mbi përfshirjen numerike të fëmijëve në edukimin parashkollor mbetet befasisht të njëjta që nga viti 2004 (rreth 5,500 fëmijë). Vështirësitë në regjistrimin e të dhënave mund të

vijnë edhe nga mos raportimi i të dhënave nga institucionet private. Palët e intervistuar në kuadër të vlerësimit tematik, theksuan që një numër i institucioneve private operojnë pa u licencuar dhe në disa raste MASHT nuk ka qasje proaktive në regjistrim të këtyre të dhënave.



Siç shihet nga Figura (13), shkalla e përfshirjes në edukimin parashkollor (0-5 vjeç) është tejte e ulët dhe nuk ka pësuar ndonjë ndryshim gjatë zbatimit të planit. I vetmi progres që mund të përshkruhet në këtë fazë është suksesi në përfshirjen e moshës 5 vjeçare në kuadër të edukimit parashkollor. Nuk ka ndonjë qasje të organizuar institucionale për të rritur numrin e fëmijëve të komuniteteve jo-shumicë në edukim parashkollor. Sidoqoftë, hapja e qendrave me bazë në komunitet e të mbështetura nga partnerët zhvillimor janë inkurajuese. Ka pak progres në ndërtimin e objekteve të reja dhe shtimin e dhomave në qendrat ekzistuese. Katër objekte ekzistuese janë rinovuar me qëllim të shtimit modest të hapësirës në Prishtinë. Gjatë gjithë fazës raportuese është ndërtuar vetëm një institucion publik parashkollor në Shtime dhe dy institucione tjera parashkollore të tipit publiko-privat në Prishtinë. Kemi një varg të gjatë të komunave të vogla dhe të mesme ku nuk organizohet edukimi parashkollor fare si Prizreni, Malisheva, Dragashi, Novoherda, Deçan, Hani Elezit, Mamusha, Juniku, Leposaviç, Zubin Potok, dhe Shtërpca.

Përfshirja numerike e fëmijëve të moshave nën 5 vjeç ka mbetur pothuajse e njëjtë në 10 vitet e fundit. Ndryshimet në shkallë të përfshirjes më tepër i atribuohen ndryshimeve demografike dhe hapjes së institucioneve private. Të dhënat e raportuara përfshijnë vetëm të dhënat zyrtare në kuadër të SMIA (2015), megjithatë pretendimet se të dhënat nuk përfshijnë një numër të caktuar të fëmijëve në institucione private dhe komunat veriore duken të jenë pjesërisht valide. Mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave dhe investimet infrastrukturore dhe në burimet njerëzore mbeten sfidat kryesore që duhet adresuar në ciklin e ardhshëm të planifikimit.

4.3. Aftësimi i edukatorëve

Plani synonte qëderi në vitin 2016 të krijohet një sistem funksional dhe veprues për aftësimin e akredituar të mësimeve, që ndikon në përmirësim të cilësisë së edukimit, nëpërmjet realizimit të një sërë aktiviteteve: minitorim të vazhdueshëm të punës së edukatorëve dhe ecurisë së fëmijëve, punësim të një pedagogu për çdo 1000 fëmijë në edukimin parashkollor, ofrim të programeve për aftësim të vazhdueshëm për të përmirësuar punën e edukatoreve, aftësim të individëve me rol asistues në edukim parashkollor, zbatim të indeksit të gjithëpërfshirjes në edukim parashkollor, angazhim të mësimeve për fëmijë me nevojë të veçanta dhe rishikim të standardeve për punësim të edukatorëve që punojnë me grup-moshën 0-3 vjeç, me qëllim të kualifikimit të tyre në programe përkatëse parashkollore.


Në bazë të të dhënave të treguesve të aktiviteteve në kuadër të objektivës për aftësim të edukatorëve, numri i kuadrit mësimeve femra në edukimin parashkollor është pothuajse 100 %. Numri i edukatorëve në gjithë sistemin e edukimit parashkollor është rritur me vetëm 30 pjestar të rinj që nga viti 2011. Raporti i numrit të kuadrit mësimeve femra në Kosovë është tejtejt i lartë krahasuar me mesataren e BE-së ku kjo nuk tejkalon 65 % përqind (Eurostat, 2014). Kemi përmirësim të raportit nxënës-mësimeve që nga viti 2011. Ky përmirësim buron pjesërisht për shkak të shtimit modest të numrit të kuadrit mësimeve. Partnerët zhvillimor (Unicef, Save the Children, Caritas) ka ndihmuar në rekrutimin e mësimeve për fëmijë të komuniteteve jo-shumicë dhe për fëmijë me nevojë të veçanta. Në dy vitet e fundit është ofruar trajtim i vecantë për rreth 100 fëmijë me nevojë të veçanta në edukim parashkollor. Sidoqoftë, caku për rritje të numrit të pedagogëve në edukim parashkollor nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të theksuar dhe është ende larg raportit të synuar 1:1000.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë për përmirësim të kualifikimeve, MASHT ka mbështetur hapjen e katër programeve të specializuara të arsimit të lartë: Edukim Parashkollor (BA), Edukim Fëmijëri e Hershme (BA) në Universitetin e Prishtinës, Edukim Parashkollor (BA) në Universitetin e Pejës, Edukim Parashkollor (BA) në Universitetin e Mitrovicës dhe Edukim Parashkollor (BA) në Universitetin e Gjakovës. Nuk ekzistojnë të dhëna të sakta mbi rrjedhën e përmirësimit të kualifikimeve të edukatoreve në edukimin parashkollor në SMIA. Sidoqoftë, në bazë të të dhënave të ASK (2010-2015), struktura e kualifikimeve në edukimin parashkollor është përmirësuar dukshëm gjatë ciklit të zbatimit të planit.

Tabela 6: Lohatja e parametrevave të cilësisë në edukim parashkollor

	2011	2012	2013	2014	2015
Numri i edukatorëve (0-5)	1300	1320	1,357	1364	1364
Numri edukatoreve femra	1300	1319	1,356	1363	1363
Raporti nxënës-mësues	19.6	19.3	19.1	18.6	18.6
Raporti pedagog-fëmijë	1500	1500	1500	1500	1500

Burimi: SMIA 2015, MASHT



Edhe pse afërsisht gjysma e edukatorëve duket të ketë avancuar në kualifikimet e tyre, nuk është evidente nëse këto kualifikime janë adekuate për profesionin. Edukimi parashkollor kërkon shkathtësi të veçanta pedagogjike dhe trajnimet bashkëkohore mund të adresojnë këtë sfidë. Ende mbetet shqetësuese shkalla relativisht e lartë e edukatorëve me shkollim të mesëm (ISCED 3), i cili në masë të madhe duhet të jetë në fusha të tjera të arsimit, apo pa shkathtësitë e nevojshme për stadin e zhvillimit psiko-fizik të fëmijëve. Sipas praktikave të mira evropiane (Eurostat 2012) nuk është e zakonshme që edukatorët të jenë vetëm me shkollim të mesëm. Ekziston një konsensus dhe praktikë e mirë që minimumi i kërkuar i kualifikimit për edukatorë në edukim parashkollor duhet të jetë ISCED 4 (Shkollë e lartë post-sekondare jo-terciare në fushë përkatëse të studimit).

4.4. Kurrikula e edukimit parashkollor

Në kuadër të objektivës sëkatërt (EPSH 4) të hartuar në vitin 2011, plani parashihte që gjatë ciklit të implementimit të hartohen kurrikulat për moshën 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç, të cilat do të konsideronin çështjet gjinore dhe do të implementohen në përputhje me SZHNFH. Për të arritur këtë objektiv, plani parasheh realizimin e një sërë aktiviteteve duke përfshirë: hartimin e Udhëzimit Administrativ për licencimin e institucioneve private parashkollore, themelimin e një grupi për hartimin e standarteve për mjete didaktike dhe tekste mësimore, hartimin e kurrikulës 0-3 vjet dhe rishikimin e kurrikulës 3-6 vjet duke u përqëndruara në eliminimin e stereotipeve, hartimin e pakove të standardizuara të instrumenteve të vlerësimit, hartimin e standardeve për edukatorë, rishikimin e standardeve të infrastrukturës dhe hartimin e standardeve për bashkëpunim me prindër.

Janë formuar grupet punuese për hartimin e kurrikulës bërthamë për SNKA 0 dhe që përfshin moshat 0-5 vjeç. Këto katër grupe punuese janë: grupi punues i koordinatorëve të nivelit, grupi i koordinatorëve të fushave kurrikulare, grupi i ekspertëve universitar dhe grupi punues i edukatorëve. Sfidë në këtë aspekt mbetet sigurimi i pjesëmarrjes dhe përkushtimit të grupeve punuese për të vazhduar me zbatimin e prioritetit. Në anën tjetër, duhet rritur buxhetin për hartimin e kurrikulës bërthamë të SNKA 0 dhe të ofrohen mundësi për vizita studimore dhe shkëmbim të përvojave me vendet e avancuara.

4.5. Kapaciteti i menaxhimit të institucioneve parashkollore

Të gjithë drejtorët e institucioneve parashkollore publike kanë marrë pjesë në trajnimin për edukimin gjithëpërfshirës dhe kanë ndjekur 7 shtatë module trajnuese të Standardeve të Zhvillimit dhe Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme. MASHT në bashkëpunim me DKA dhe GIZ ka organizuar edhe trajnimin për të gjithë drejtorët e institucioneve parashkollore për menaxhimin e institucioneve parashkollore. Në vitin tjetër duhet përqendruar tek trajnimi i drejtorëve në decentralizimin dhe menaxhimin financiar të shkollave

4.6. Vetëdijësimi mbi rëndësinë e edukimit parashkollor

Vetëdijësimi i prindërve rreth rëndësisë së arsimit parashkollor dhe parafillor ka vazhduar përmes debateve me prindër, drejtorëve të institucioneve publike edukatorëve dhe ekspertëve të fëmijërisë së hershme. Të dhënat në lidhje me përfshirjen në edukimin parafillor në rritje tregojnë për shkallën e sensibilizimit të prindërve në lidhje me rëndësinë. Sidoqoftë, kërkohet në të ardhmen një program për sensibilizim të mëtejshëm rreth edukimit parashkollor, mirëpo të shtohen përpjekjet për zgjerim të infrastrukturës dhe sistemit për akomodim të kërkesave në rritje.

5. Arsimi parauniversitar


Gjatë elaborimit të planit fillestar ishin identifikuar disa sfida me të cilat ballafaqohet arsimi parauniversitar: kapaciteti i institucioneve qendrore, komunale dhe shkollave ishte i kufizuar në zbatimin e kurrikulës së re të bazuar në kompetenca, numri i shkollave që punonin në dy-tri ndrrime ishte i lartë, legjislacioni i arsimit parauniversitar nuk ishte në përputhje me legjislacionin primar në arsim parauniversitar, bartja e përgjegjësi nga niveli qendror në atë lokal ishte ende në proces dhe të dhënat në lidhje me sistemin nuk mundësonin vendimarrje të bazuar në evidencë. Gjithashtu, ishin shfaqur brenga në lidhje me cilësinë dhe arritshmërinë e nxënësve, sistemet për kontrollin e cilësisë nuk ishin funksionale dhe objektet arsimore duhej të përshtateshin me kontekstin e ri arsimor. Një aspekt tjetër esencial ishte kapaciteti i sistemit parauniversitar për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë duke përfshirë komunitetet dhe rastet me nevoja të vecanta. Infrastruktura dhe mjedisi shkollor duhej të eliminonte rastet e dhunës në shkollë dhe të ofronte mjedise mike për fëmijët. Për të adresuar këto sfida dhe prioritetet PSAK Arsimit Parauniversitar (APU) 2011-2012 kishte listuar 12 objektiva:

OBJEKTIVAT ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2011-2016

- 1 Deri në vitin 2016 ndërtohen kapacitete për menaxhim efektiv të sistemit në nivelin qendror dhe komunal, si dhe menaxhim efektiv në nivel shkolle, përfshirë mekanizmat për kycjen më të madhe të grave në menaxhim
- 2 Deri në vitin 2016, legjislacioni është harmonizuar dhe i kompletuar plotësisht për tërë sektorin e arsimit parauniversitar
- 3 Deri në vitin 2014 barten kompetencat për menaxhim financiar nga niveli qendror në atë komunal dhe nga niveli komunal në nivel shkolle
- 4 Deri në vitin 2016, janë funksionalizuar plotësisht mekanizmat për sigurimin e cilësisë në nivel vendi, në nivel komunal dhe në nivel shkolle
- 5 Deri në vitin 2016 shërbimet këshilldhënëse koordinohen në nivel qendror dhe në nivel komune e shkolle duke ofruar qasje të barabartë në shërbime profesionale këshillimore dhe orientuese
- 6 Deri në vitin 2016 janë hartuar, pilotuar dhe implementuar kurrikulat për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, të shoqëruar me përmirësimet e nevojshme në metodologji të mësimdhënies, të të nxënësve dhe të vlerësimit të nxënësve
- 7 Deri në vitin 2014, licencimi i mësimdhënësve është plotësisht funksional dhe përkrah zhvillimin e mësimdhënësve në karrierë, duke qenë i përshtatur me Planin për implementimin e Kornizës së Kurrikulës
- 8 Deri në vitin 2016 ndërtohet sistemi efektiv që bën të mundur gjithëpërfshirjen e nxënësve në arsimin e aftësimin e obligueshëm dhe është i ndjeshëm ndaj perspektivës gjinore, dhe ndaj nevojave të nxënësve të varfër e të pafavorizuar
- 9 Deri në vitin 2016 është vendosur rrjeti efektiv i shkollave të mesme të larta që bën të mundur përfshirjen e të gjithë fëmijëve
- 10 Deri në vitin 2016 shkollat kanë krijuar mjedise jo të dhunshme dhe miqësore për fëmijët në shkollë që janë përkrahëse, të kujdesshme dhe i kultivojnë vlerat demokratike të fëmijëve dhe ofron modele pozitive për të gjithë fëmijët

- 11** Deri në vitin 2016 të paktën një e treta e shkollave të Kosovës do të funksionojnë me një ndërrim të vetëm, ndërsa të tjerat me dy ndërrime, duke ofruar mjedis cilësor dhe me numër optimal të nxënësve në klasë
- 12** Deri në vitin 2016, të gjitha shkollat në Kosovë janë furnizuar me pako standarde të pajisjeve dhe mjeteve mësimore të përshtatshme për zbatimin e Kurrikulimit të ri shkollor

Kosova ka arritur shkallë të lartë të përfshirjes në arsimin parauniversitar, të krahasueshme me praktikat evropiane - përfshirja ende nuk është universale dhe ende mbeten grupe të vogla shoqërore që nuk janë përfshirë në sistem. **Sfida kryesore mbetet arritshmëria jo e kënaqshme** e nxënësve në testet e jashtme. Mekanizmat dhe praktika e sigurimit të cilësisë dhe llogaridhënies ende mbeten të pazhvilluar. Procesi i zbatimit të kurrikulës së re arsimore është mbrapa orarit të përcaktuar në planifikim. Për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve si pasojë e rënies së shtimit natyror të popullsisë, nën-sektori mund të përballet me implikime infrastrukturore dhe të numrit dhe strukturës së mësimdhënësve. Megjithatë progresin e arritur në procesin e bartjes së përgjegjësive nga niveli qendror në nivel lokal, bartja e përgjegjësive financiare në shkollë ka hasur në disa pengesa – mungesa e kapaciteteve të shkollës, mungesa e bordeve të shkollave dhe në disa raste dëshira e komuave për të mbajtur këto përgjegjësi. Shkalla e realizimit të PSAK Arsimit Parauniversitar është si më poshtë:



5.1. Menaxhimi i arsimit parauniversitar

Objektivi i parë i nën-programit të arsimit parauniversitar synon që deri në vitin 2016 ndërtohen kapacitetet për menaxhim efektiv të sistemit në nivel qendror dhe komunal, si dhe menaxhim efektiv në nivel shkolle, përfshirë edhe mekanizmat për përfshirje të grave në menaxhim. Në kuadër të këtij objekti parashihen një varg aktivitete: finalizimi i Sistemit për Menaxhim të Informatave në Arsim (SMIA) me mundësi të mbledhjes dhe përpunimit të informatave relevante, aftësim të personelit të SMIA për mbledhje dhe analizë të dhënave, aprovim të organogramit të ri të MASHT në përputhje me rekomandimet e rishikimit funksional, aftësim të personelit të komunave për ushtrim të përgjegjësive të reja, hartimi i programeve për kualifikim të drejtorëve të shkollave, përcaktim të treguesve kombëtar të arsimit të krahasueshëm me

treguesit e UNESCO, hartimi i standardeve të burimeve njerëzore në nivel komune dhe organizim të trajnimeve për drejtor të shkollave. Aktivitetet e propozuara janë mjaft relevante mirëpo janë më tepër aspektet që prekin të gjitha prgramet e PSAK. Andaj, në këtë pjesë do të prezentohen aktivitetet në lidhje me programin ndërsa një reflektim më i detajuar jipen në kuadër të kapitullit Ndërtimi i Kapacitetit dhe Menaxhimi.

SMIA është funksionale, ka kapacitet për gjenerim të raporteve bazë statistikore dhe janë caktuar persona përgjegjës në nivel qendror për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mirëpo shkalla e shfrytëzimit të të dhënave dhe kapaciteti për prezentim të tyrëështë ende i kufizuar – SMIA është funksionale që nga viti 2012 me mbështetje të Bankës Botërore. Në përgjithësi të dhënat janë të rëndësishme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sidoqoftë, sistemi ka kapacitet të kufizuar për të gjeneruar të dhënat në mënyrë automatike dhe të dhëna në nivel individual dhe shkollor. Të dhënat në sistem nuk janë të integruara me të dhënat tjera të rëndësishme mbi regjistrimin e popullësisë (ASK), financimit (Ministria e Financave), infrastrukturën dhe databazën e mësimdhënësve. Ekipi i SMIA publikon raporte të rregullta ad hoc, vjetore dhe periodike mirëpo shkalla e shfrytëzimit të tyre për politikë-bërje si në nivel qendror ashtu edhe në nivel komunal është e kufizuar. Megjithatë ende ka shqetësime rreth metodologjisë së mbledhjes së të dhënave, përmes SMIA arrihen të gjenerohen raporte të rregullta të treguesve arsimor në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe tregues të UNESCO. MASHT ka bërë progres të ndjeshëm në gjenerim të të dhënave sasiore mirëpo ka kufizime të theksuara në mbledhje të të dhënave cilësore, ndërlidhjen e të dhënave me arritshmëri të nënësit dhe faktorët tjerë social mbi mundësitë e barabarta.

MASHT në parim ka zbatuar rishikimin funksional sipas kërkesave të nivelit qendror dhe ka filluar hapat fillestar për vlerësim të përformancës së stafit mirëpo rishikimi ishte pothuajse në tërësi transpozim i strukturës së vjetër – MASHT ka zbatuar procesin e rishikimit funksional ndërmjet 2013-2015 mirëpo ishte më tepër formalizim i strukturës paraprake se sa ndonjë riorganizim funksional. Përmbajtja e përskrimeve të punës ishte gjithashtu shumë e ngjashme me ato të vjetrat. Në vitin 2015 është inicuar procedura e përskrimit të vendeve të punës dhe vendosjes së objektivave me mbështetje të Projektit për Asistencë Teknike. Kapaciteti i MASHT për planifikim strategjik të burimeve njerëzore dhe ofrim të mbështetjes profesionale për komuna është ende i kufizuar. Nuk është bërë ndonjë përpjekje për riorganizim dhe mbështetje në rishikim funksional të DKA-ve. Struktura organizative në kuadër të DKA në shumë raste është në shpërputhje me linjat kryesore të shërbimeve profesionale programore. GIZ ka mbështetur Kolegjiun e DKA-ve për të publikuar një doracak të rëndësishëm për menaxhim të arsimit në nivel komune.

Janë zbatuar një seri e programeve të trajnimit për planifikim dhe udhëheqje në arsim me mbështetje të partnerëve zhvillimor - Në bazë të dhënave të gjeneruara nga MASHT (2015), janë trajnuar rreth 22 % përqind e zyrtarëve të MASHT, inspektorëve, zyrtarëve të DKA dhe drejtorëve të shkollave në kuadër të trajnimit 'Udhëheqje arsimore'. Në kuadër të një trajnimi tjetër vetëm për Drejtor Shkolle janë trajnuar rreth 402 apo 35% përqind e drejtorëve. Një numër më i madh i drejtorëve dhe anëtarëve të Këshillave Shkollor janë trajnuar në trajnimin për Këshilla Drejtues me 822 pjesëmarrës gjatë 2011-2015 apo 70 % përqind.

Tabela 7: Trajnimet për ngritje të kapacitetit menaxhues 2011-2015

Nr	Trajnimi	2011	2012	2013	2014	2015	Total
1	Udhëheqje arsimore						
	Numri	100	200	100	150	-	550
	% e total	4%	8%	4%	6%	-	22%

2. Trajnimi për drejtor shkolle

Numri	-	-	157	245	-	402
% e total	-	-	14%	21%	-	35%

3. Trajnimi për Këshilla Drejtues

Numri	17	258	263	284		822
% e total	1.6%	22%	23%	24%		70%

Burimi / sqarim

- ☐ Të dhënat e trajnimit janë marrë nga Databaza e trajnimit, MASHT 2015
- ☐ Numri bazë i kuadrit të përfshirë në kuadër të caktuar është si në vijim: Zyrtar të MASHT (190), Zyrtar të DKA (320), Inspektor (63), Udhëheqës shkollë (1150)

Nuk ka të dhëna në lidhje me shkallën e përfshirjes së femrave në trajnim anipse në bazë të analizave të dokumenteve vërehet një kujdes i vecantë në pjesëmarrje të femrës dhe komuniteteve. Shkalla e të trajnuarve në raport me numrin total të zyrtarëve është rreth 50 % përqind. Në linjë me këtë aktivitet është akredituar Trajnimi për Menaxhim dhe Komunikim Talk On dhe ku janë përfshirë pjesa më e madhe stafit të DKA dhe zyrtar të MASHT dhe DKA. MASHT në përgjithësi ka organizuar takime të rregullta me zyrtar komunal dhe sidomos në korniza të zbatimit të kurrikulës së re. Gjithashtu, në vitin 2013 është hartuar dhe riakredituar Trajnimi për Udhëheqje Arsimore. Programi i trajnimeve ka qenë i mbështetur kryesisht nga USAID, GIZ dhe BE dhe mbetet sfidë sigurimi i vazhdimësisë së trajnimeve dhe menaxhimi i njohurisë.

Një pjesë e komunave kanë realizuar planet e tyre të zhvillimit me mbështetje të partnerëve zhvillimor. GIZ dhe USAID ka mbështetur disa komuna dhe shkolla në përpilimin e planeve zhvillimore komunale dhe shkollore. Gjatë periudhës së këtij plani rreth 66% përqind e komunave kanë realizuar planet e tyre zhvillimoredhe rreth 24% e shkollave.

Tabela 8: Numri i planeve zhvillimore në komuna dhe shkolla 2011-2015

	2011	2012	2013	2014	2015	Total
Plane komunale	-	-	10	12	-	22
%	0%	0%	30%	36%		66%
Plane shkollore	-	-	149	126	-	275
%			13%	11%		24%

5.2. Legjislacioni arsimit parauniversitar

Në vitin 2011 është miratuar Ligji për Arsimin Parauniversitar. Është në proces Ligji për Inspektoratin e Arsimit në Kosovë si dhe Ligji për Drejtësi për fëmijë të cilat ligje priten të miratohet në vitin 2015. Rezultatet e arritura deri me tani janë: Në vitin 2011 është miratuar UA - Të drejtat e fëmijëve për parandalimin e braktisjes. Është miratuar UA nr. 19/2102 – krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, dhe në vitin 2015 është nxjerr UA, për normativin profesional për Arsimin e përgjithshëm. Treguesi është relevant edhe më tutje për arritjen e caktuar. Sfidë mbetet zhvillimi dhe kompletimi i bazës së nevojshme ligjore dhe nënligjore për Arsiminparauniversitar.

5.3. Decentralizimi financiar

Me miratimin e Ligjit për arsim parauniversitar, kompetencat për menaxhimin e nën-sektorit dhe menaxhimin financiar i kanë kaluar komunave të Kosovës. Një nga caqet e PSAK ishte që deri në

.....

vitin 2014 të realizohet decentralizimi financiar duke kaluar përgjegjësitë financiare për arsimin parauniversitar nga (i) MASHT tek komunat dhe nga (ii) DKA tek shkollat. Në këtë vit rreth 30 komuna kanë menaxhuar financat e tyre konform Ligjit për Financat Publike të nivelit lokal. Granti specifik për arsimin komunal është realizuar sipas formulës dhe softuerit për kalkulim të grantit arsimor.

Megjithatë progresin e arritur në bartjen e përgjegjësiave financiare nga DKA tek 778 shkolla, zbatimi tërëror i këtij nëncaku ka hasur nëdisa sfida. Mungesa e njohurive teknike, mungesa e kapaciteteve të shkollave për zbatim të menaxhimit financiar, mungesa e Këshillave të Shkollave, mungesa e planeve zhvillimor dhe mosprioritizimi dhe mungesa së kapaciteteve të DKA për monitorim dhe mentorim të shkollave mbeten disa pengesat që duhet trajtuar për arritjen e plotë të nën-caktut. Në vitin pasues, rekomandohet që të rishikohet softueri për formulën e financimit. të rishikohet Udhëzimi administrativ për formulën e financimit, të ngriten kapacitetet e DKA-ve dhe shkollave për menaxhim financiar dhe të fuqizohen mekanizmat e llogaridhënies dhe raportimit nga shkollat.

Nga analiza e treguesve të caktuar rezulton se është realizuar tërësishtkomponenta për bartjen e kompetencave për menaxhim financiar nga niveli qendror në atë komunal, ndërsa është në proces bartja e kompetencave për menaxhim financiar nga niveli komunal në nivel shkolle. Aktualisht vetëm dy komuna e menaxhojnë buxhetin në mënyrë të pavarur, ndonëse 30 % e shkollave e menaxhojnë buxhetin në mënyrë të pavarur. Nga analiza e të cilit nxjerret konkludimi se 100% e shkollave disponojnë me nënxhirollogari dhe e disponojnë kodin që nënkupton se mund të menaxhojnë buxhetin e tyre sikurse të gjitha agjencionet tjera shpenzuese. (Psh. Ministria - MASHT). Poashtu100% e zyrtarëve komunal janë aftësuar për menaxhimin e buxhetit sipas modelit të decentralizuar. Procesi i trajnimit dhe aftësimit të zyrtarëve në nivel shkolle nuk është i kënaqshëm, sepse vetëm 10 % e tyre janë aftësuar për t'a menaxhuar vet buxhetin e tyre. Nukdipsonohet me të dhëna për numrin e shkollave të audituara, ndonëse janë bërë auditime dhegjatë auditimit në disa shkolla është thënë se “drejtorët e shkollave janë thirrur nga auditori gjeneral që të japin sqarime rreth buxhetit të tyre dhe të hyrave vetanake, pasi që drejtorët e shkollave janë autorizues të buxheteve të tyre dhe nga ata kerkohet që të japin përgjegjësi për shpenzimin e buxhetit të tyre”.

5.4. Sigurimi i cilësisë


Caku mbi sigurimin e cilësisë në arsim parauniversitar synon që deri në fund të vitit 2016 janë funksionalizuar plotësisht mekanizmat për sigurimin e cilësisë në nivel vendi, komune dhe shkolle. Ne kuadër të këtij caku është paraparë realizimi i disa aktiviteteve:ndërtohet kapaciteti për vlerësim të jashtëm dhe brendshëm të performancës së shkollës me qëllim të ngritjes së cilësisë në nivel shkolle, bëhet ndarja e Inspektoratit të Arsimit në seksione administrative dhe profesionale për të përmbushur një varg të detyrave që dalin nga ndryshimet legislative dhe themelohet Autoriteti për Kurrikulum, Vlerësim dhe Standarde si trup këshilldhënës i MASHT për këto fusha. Në përgjithësi caku është tejet relevant për arritjen e qëllimit të arsimit parauniversitar për të ofruar arsim cilësor përmes përsosjes së stafit mësimdhënës dhe arritshmërisë së nxënësve.

Sidoqoftë, aktivitetet e listuara në kuadër të caktuar janë të mangëta dhe në disa raste edhe jo relevante për arritjen e caktuar. Kultura e menaxhimit të cilësisë do të duhej të kishte një sistem koherent të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm. Në kuadër të vlerësimit të jashtëm do të duhej listuar prioriteti i ndërtimit të sistemit për vlerësim të nxënësve, vlerësimi të shkollave dhe vlerësimi të mësimdhënësve. Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë do të duhej ishte paraparë ndërtimi i mekanizmave të brendshëm për sigurim të cilësisë në ligjshmëri, menaxhim, arritshmëri të nxënësve, mësimdhënie, kurrikulë, infrastrukturë dhe resurseve tjera


tëmësimdhënis. Si pjesë e sigurimit të cilësisë do të duhej ishin caktuar zyrtarët përgjegjës për sigurim të cilësisë në shkollë, zbatuar procesi i vetë-vlerësimit dhe planet e përmirësimit.

Janë ndërtuar mekanizmat e vlerësimit të jashtëm të nxënësve dhe Kosova ka marrë pjesë në PISA 2015 mirëpo ende ka shqetësime në lidhje me integritetin e mekanizmave dhe arritshmërinë e nxënësve - Në Kosovë, Divizioni për Vlerësim dhe Standarde organizon vlerësim vjetor të jashtëm të nxënësve përmes testit të maturës dhe testit të semi-maturës. MASHT zbaton dy lloj teste të vlerësimit të jashtëm të nxënësve: testi i maturës që aplikohet pas përfundimit të shkollës së mesme të lartë dhe testi i semi-maturës pas përfundimit të shkollimit të mesëm të ulët. Sistemi i vlerësimit të fëmijëve pas përfundimit të Klasës së pestë (5) është pilotuar mirëpo ende pritet të zbatohet në mënyrë sistematike. Në vitin 2015 Kosova ka marrë pjesë për herë të parë në Programin Ndërkombëtar të Vlerësimit të Studentëve (PISA) mirëpo rezultatet ende nuk janë publikuar. Në përgjithësi ekziston një sistem institucional dhe praktikë e vlerësimit të jashtëm të nxënësve. Sidoqoftë, ende nuk ekziston praktika e zhvilluar e analizimit të rezultateve dhe nxjerrjes së konkluzioneve pasuese për politikë-bërje. Gjithashtu, në disa raste është kontestuar integriteti i vetë sistemit për shkak të praktikave të kopjimit gjatë testimit në të kaluarën. Gjatë vitit të fundit janë marrë masa shtesë për të rikthyer besimin në sistem të vlerësimit dhe inicuar projekte për digjitalizim të procesit.

Është shënuar përparim i lehtë në arritshmërinë e nxënësve në testet e semi-maturës (klasa 9) dhe testin e maturës mirëpo mbetet shqetësim shkalla e ulët e arritshmërisë në matematikë – në bazë të të dhënave vjetore të MASHT, rezultatet nga vlerësimi i jashtëm i nxënësve në testin e semi-maturës tregojnë për një rritje të ndjeshme të arritshmërisë mesatare të nënësve nga rreth 55 % përqind në vitin 2011 në rreth 63 % përqind në vitin 2015 (shiko Grafikon). Arritshmëria në testin e maturës ka një trend pozitiv nga 47 % përqind në vitin 2011 në 54.5 % përqind në vitin 2015. Luhatjet në arritshmërinë e testit të maturës ndër vite janë të pazakonshme dhe shfaqin tendencën të anomalisë në administrim. Nga të dhënat ekzistuese, nxënësit përformojnë më mirë në segmentin e leximit ndërsa kanë arritshmëri shumë të ulët në matematikë (rreth 35 % përqind). Ende nuk janë publikuar rezultatet e arritshmërisë në Testin Ndërkombëtar PISA 2015. Mirëpo ndërlidhja e arritshmërisë së nënësve me ato të vendeve të avancuara do të ishte një instrument i rëndësishëm i llogaridhënies.



Është shënuar përmirësim i parametrave sasiordhe financimit (inputet) në arsimin parauniversitar dhe këto krahas zhvillimit profesional të mësimeve mund të shpjegojnë rritjen në arritshmëri të nxënësve në teste të jashtme – Në bazë të të dhënave të SMIA janë shënuar ndryshime pozitive dhe përmirësim të inputeve në arsimin parauniversitar. Përmirësim i ndjeshëm vërehet në financim të nën-sektorit nga 188.9 milion euro në vitin 2011 në 211 milion euro në vitin 2015. Në anën tjetër janë shënuar hapa përmirësimi edhe në parametrat sasi të cilësisë si raporti klasë-nxënës dhe mësimeve-nxënës. Raporti nxënës për klasë në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në vitin 2011 ishte mestarisht 17.3 nxënës për klasë në krahasim me 16.4 nxënës për klasë në vitin 2015. Në anën tjetër, vërehen edhe përmirësime edhe në arsimin e mesëm të lartë. Raporti nxënës për klasë në arsimin e mesëm të lartë në vitin 2011 ishte mesatarisht 20.2 nxënës për klasë në krahasim me 15.6 nxënës për klasë në vitin 2015.



Zvogëlimi i numrit të nxënësve për klasë dhe zvogëlimi i nxënësve për mësimeve janë parametra të rëndësishëm sasi. Ky përmirësim vjen pjesërisht për shkak të rënies demografike dhe uljes së numrit të nxënësve dhe investimeve shtesë në kuadrin të mësimeve dhe infrastrukturës. Sidoqoftë, përmirësimi të këtyre parametrave janë vërejtur kryesisht në zona rurale e më pak në zona urbane. Shkollat e arsimit parauniversitar në qendrat e mëdha urbane vazhdojnë të kenë numër tejet të lartë të nxënësve për klasë. Kjo ka rezultuar për shkak të lëvizjes së popullsisë nga zonat rurale në zona urbane. Në të ardhmen duhet kujdesur që të ketë optimizim të këtyre parametrave dhe investime shtesë në infrastrukturë në zona urbane.

Praktika e vlerësimit të jashtëm të shkollës është ende e pazhvilluar në mungesë të kornizës ligjore dhe kapacitetit institucional dhe financiar - Vlerësimi i shkollave apo inspektimet vlerësojnë performancën e shkollave kundrejt një modeli të caktuar të treguesve. Ata reflektojnë sin të rezultateve ashtu edhe në proceset që mundësojnë arritjen e rezultateve. Në shumicën e sistemeve të avancuara Evropiane të arsimit. Përgjegjësia për vlerësimin e rezultateve dhe realizimin e inspektimit qëndron tek Inspektorët e Arsimit. Ndërtimi i kapacitetit të inspektimit të shkollave dhe praktika e vlerësimit të jashtëm të shkollave janë elemente kyçe në garantim të cilësisë. Në Kosovë, institucioni përgjegjës për vlerësim të shkollave është

Inspektorati i Arsimit. Ekzistojnë disa paqartësi ligjore rreth fushëveprimit të inspektimit në arsim profesional Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka përgjegjësi për vlerësim të institucioneve të arsimit të mesëm të lartë profesional dhe ofertuesve të aftësisë profesionale. Sidoqoftë, Inspektoriati i Arsimit ka rol kyç në vlerësim të jashtëm të edukimit parashkollor, institucioneve parauniversitare fillore, mesme të ulta, mesme të larta të përgjithëshme dhe ka përgjegjësi për të kontrolluar ligjshmërinë në institucionet e arsimit të lartë. Inspektorati deri vonë ka qenë vetëm një nga departamentet e MASHT mirëpo në bazë të propozim ligjit të ri ai transformohet në organ të agjenci brenda kornizës së MASHT.

Në shumicën e vendeve të avancuara Evropiane vlerësimet e jashtme përqëndrohen në një varg të gjerë të aktiviteteve shkollore duke vlerësuar aspektet menaxhieriale të shkollës, mësimdhënësit, rezultatet e nxënësve, infrastrukturën dhe mjedisin mësimor dhe ligjshmërinë. Korniza e vlerësimit të jashtëm në sisteme të avancuara përmban një liste të detajuar të treguesve të secilës komponentë dhe mbaron përmes një raporti përmbledhës në baza periodike (1-3 vjetecare). Në procedurë të vlerësimit përfshihen ekspertë të jashtëm, palë të interesit dhe përfaqësues të komunave. Praktika e inspektimit të standardizuar dhe sistematik nuk është e zhvilluar në Kosovë. Nuk ka ndonjë evidencë të që procesi i vlerësimit të jashtëm bazohet në ndonjë kornizë uniforme të vlerësimit. Inspektorati në masë të madh nuk ka qasje proaktive në vlerësim dhe më tepër bazohet në praktikën e reagimit përmes raporteve *ad hoc*. Në kuadër të praktikës së inspektimit është zhvilluar elementi i inspektimit të ligjshmërisë dhe në disa raste edhe hospitimi gjatë mësimdhënies. Anipse kapacitetet njerëzore janë të kufizuara (62 inspektorë), procesi i vlerësimit të shkollave do të mund të avancohej përmes përfshirjes së ekspertëve të jashtëm dhe komunave në proces.

MASHT ka zhvilluar bazën ligjore që përcakton strukturën e karrierës së mësimdhënësve, normativin dhe zhvillimin profesional. Sipas përcaktimit të Udhëzimit Administrativ, mësimdhënësit kategorizohen në të rregullt, avancuar, mentor dhe mësues i merituar. Matja e performancës së mësimdhënësve është dispozitiv ligjor i Inspektoratit të Arsimit. Megjithatë, sistemi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve nuk është zbatuar ende. Skema e pagave është lineare dhe e bazuar kryesisht në arritje para shërbimit (kualifikimet) dhe përvoja e punës. Arsyetimi më i shpeshtë për mos zbatim të sistemit ka qenë mungesa e burimeve financiare mirëpo shpenzimet në paga të mësimdhënësve pothuajse janë dyfishuar gjatë këtij cikli të planit dhe ato nuk janë bazuar në kritere të performancës në shërbim. Sistemi aktual mundëson një licencë të përkohëshme dhe mësimdhënësit janë të obliguar të ndjekin një numër prej 120 orëve trajnim.

Për të avancuar **menaxhimin e cilësisë në arsimin parauniversitar** MASHT ka vënë theksin tek udhëzimet e ngritjes së cilësisë së brendshme, zbatimin e mekanizmave për vlerësim të cilësisë së jashtme dhe ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit. Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE-ja, kambështetur zhvillimin e një Strategjisë gjithëpërfshirëse të sigurimit të cilësisë për Arsimin Parauniversitar të Kosovës. Gjatë vitit 2015 është hartuar drafti i parë i këtij dokumenti, i cili pritet të finalizohet më tutje gjatë vitit 2015.

5.5. Shërbimet këshilluese


Përmes këtij objektiviti plani parashihte rritjen e shërbimeve këshilldhënëse (shërbimet e pedagogut, psikologut dhe punëtorit social) në komuna dhe shkolla dhe ato të kordinoheshin ndërmjet nivelit qendror dhe lokal. Gjatë ciklit të zbatimit të planit MASHT ka ndryshuar politikën fillestare duke u përqëndruara në ndërtim të shërbimeve në nivel shkolle në vend të shërbimeve në nivel komune. Në bazë të dhënave të MASHT punësuar 64 pedagogë dhe psikologë shkollor. Shkalla e progresit për tu arritur caku është shumë largë sepse përqindja e shkollave të cilat e ofrojnë këtë shërbim është nën 6 % përqind. MASHT të ndihmuar nga BEP kanë ndryshuar qasjen

dhe kanë zhvilluar bazën ligjore për institucionalizimin e shërbimeve këshilldhënëse në nivel shkollë. Në kuadër të gjithëpërfshirjes të aktivizohen ekipet këshilluesetë komunës. Rezultat konkret konsiderohet Zhvillimi i UA nr. 34/2014- Funksioni i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë (pedagogut dhe psikologut shkollor). Numri i personelit të angazhuar në shërbime këshilluese prittet të rritet në vitin 2016. Sidoqoftë, udhëzimet, doracakët e punës dhe trajnimi tyre për shërbim në sistem arsimor mbetet prioritet për ciklin e ardhshëm të planifikimit.

5.6. Kurrikula

Në kuadër të këtij caku parashihen disa aktivitete që ndërlidhen me zbatimin e kurrikulës së re: shpalosen planet për Kornizën Kombëtare të Kurrikulumit (KKK) në tërë vendin përmes një fushate efektive të informimit, hartohen doracakë të trajnimeve, angazhohen dhe trajnohen zhvilluesit e kurrikulës, trajnohen mësimezhënësit, drejtorët e shkollave dhe zyrtarët e MASHT dhe DKA, hartohen materialet e reja për mësimezhënë dhe mësimezhënë, hartohen materialet e kurrikulës edhe në gjuhët tjera të komuniteteve, hartohen instrumentet e reja të vlerësimit dhe zbatohet kurrikula në të gjitha shkollat.

KKK promovon një qasje të bazuar në kompetencë, e zhvilluar përmes të mësuarit të orientuar në shkathtësi. Kalimi nga kurrikula e bazuar në përmbajtje në atë të bazuar në kompetencë është një nga masat esenciale për të ngritur nivelin e arritshmërisë tek fëmijët. Kurrikula e reformuar është e strukturuar rreth shtatë fushave të të mësuarit që zbatohen nga arsimit parashkollor deri në arsimin e mesëm të lartë: gjuhët dhe komunikimi, arti, metematika, shkenca, shoqëria dhe mjedisi, shëndetësia dhe mirëqenia, jeta dhe mjedisi. Kompetencat themelore përfshijnë komunikimin dhe të shprehurit, të menduarit, mësimezhënë, jeta, puna, kompetencat personale dhe qytetare. Kurrikula e re e inicuar në vitin 2011 mundëson decentralizimin dhe vendimarrjen e bazuar në shkollë (rreth 10-20 % e përmbajtjes) dhe krijohet mundësia që ato të përcaktojnë përmbajtjen shtesë. Sidoqoftë, zbatimi i kësaj reforme kërkon më shumë resurse materiale mësimore, trajnime të mësimezhënësve, instrumente të reja të vlerësimit dhe kontribut aktiv nga të gjithë akterët.



Kurrikula e re është duke u zbatuar në 8 % përqind të institucioneve arsimore dhe ka ngecje në zbatim krahasuar me planet fillestare - Kurrikula e re është pilotuar në vitin e parë në 10 shkollë dhe pastaj është zgjeruar edhe në 90 shkollë tjera fillore dhe të mesme. Sipas

planit fillestar ajo do të zotohej brenda 2011-2014. Sidoqoftë, në bazë të rrjedhës aktuale procesi i zbatimit është mbrota në kohë. Deri në fund të vitit 2015 vetëm 8 % përqind e shkollave janë duke e zbatuar këtë reformë. Procesi i zbatimit është përballur me një varg sfida: vështirësitë për të transformuar modelet e mësimdhënies dhe të mësuarit nga mësimdhënësi tek nxënësi, vështirësi për të zbatuar instrumentet e vlerësimit të arritshmërisë së nxënësit dhe në disa raste edhe mungesës së burimeve adekuate njerëzore dhe materiale. Reforma krijon parakushte të një pjesëmarrje më aktive të nxënësit mirëpo kjo është sfida sidomos për kuadrin mësimor të shtyer në moshë që mund të jetë rutinizuar me filozofi të ndryshme të mësimdhënies. Në anën tjetër, të mësuarit tek nxënësit shpesh është ndërlidhur me memorizimin dhe zbatimin i praktikës së mendimit kritik dhe pjesëmarrje aktive kërkojnë kohë për tu përshtatur.

Janë trajnuar rreth 30 % përqind e mësimeve, krijuar mekanizmat për zbatim dhe materialet ndihmëse mirëpo hartimi i teksteve mëimore sipas kurrikulës së re është ende në fazën fillestare - Zbatimi i kurrikulës është shtrirë në 92 shkolla në 30 komuna të ndryshme. Sipas kategorizimit të nivele të arsimit rezulton që Kurrikula e re është duke u zbatuar në 33 institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe në 59 institucione të arsimit të mesëm të lartë. Sipas të dhënave të MASHT janë trajnuar rreth 30% e mësimeve rreth aspekteve të përmbajtjes, didaktikës dhe vlerësimit të bazuar në kompetenca.

Tabela 9: Aktivitetet në lidhje me zbatimin e Kurrikulës së re 2011-2015

Nr	Trajnimit	2011	2012	2013	2014	2015	Total
	Numri shkollave që zbatojnë KKK		10	10	92	92	
	Numri i komunave që zbatojnë KK		7	7	30	30	
	Numri i trajnereve të KKK		90	90	126	183	183
	% e mësimeve të trajnuar	0%	0%	0.5%	15%	14%	30%
	Numri aktivave profesionale			30	140	180	180
	Numri doracakeve të KKK			8	8	9	9

Për të siguruar bazë të qëndrueshme për zbatim të KKK janë trajnuar edhe 183 trajnerë në të gjitha komunat dhe janë krijuar 180 aktiva profesionale të bazuar në shtatë fushat e kurrikulës dhe me pjesëmarrje të mësimeve. Aktivat profesionale janë menduar si instrumente të shkëmbimit të praktikave të mira në zbatim të kurrikulës. Gjithashtu, janë hartuar 9 Doracak për KKK. Kurrikula e re është përkthyer edhe në gjuhën turke, romë dhe boshnjake. Megjithatë përpjekjet asnjë shkollë ku mësimi realizohet në gjuhën serbe nuk ka marrë pjesë në proces të zbatimit.

Plani kishte paraparë edhe zhvillimin e kurrikulës në gjuhën serbe së bashku me materialet e mësimdhënies dhe mësimeve. Sidoqoftë, nuk janë shënuar hapa vendimtar në këtë krijim (OSCE, 2015). Gjithashtu, ende nuk janë zhvilluar përshkrimet e lëndëve të gjuhëve të komuniteteve tjera për komunitetin shumicë si 'Gjuha Serbe si gjuhë jo-ametare', 'Gjuha Turke si gjuhë j-ametare' etj. Në planin e ardhshëm duhet kushtuar vëmendje në zhvillimin e teksteve mbi identitetin e komuniteteve jo-shumicë dhe duhet bërë përpjekje shtesë në kompletim të materialeve të kurrikulës në gjuhën serbe.

5.7. Licencimi i mësimeve

Eshtë zhvilluar baza ligjore për licencimin, promovimin dhe vlerësim të performancës së mësimeve mirëpo promovimi dhe graditimi në karrierë nuk është zbatuar në mungesë të kapaciteteve, praktikës dhe kufizimeve financiare—

Këshilli për Licencim të Mësimdhënësve (KLM) ka licencuar rreth 22,000 mësimdhënës me licenca të përkohëshme. Sistemi aktual mundëson një licencë të përkohëshme dhe mësimdhënësit janë të obliguar të ndjekin një numër prej 120 orëve trajnim për të përfituar licencën apo avancuar kualifikimet në rastet kur ato janë nën kërkesat minimale. Sistemi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve nuk është zbatuar ende. Skema e pagave është lineare dhe e bazuar kryesisht në arritje para shërbimit (kualifikimet) dhe përvoja e punës. Arsytimi më i shpeshtë për mos zbatim të sistemit ka qenë mungesa e burimeve financiare mirëpo shpenzimet në paga të mësimdhënësve pothuajse janë dyfishuar gjatë këtij cikli të planit dhe ato nuk janë bazuar në kriteret e performancës në shërbim. Kanë ekzistuar iniciativa për të zbatuar një gradim pa kosto financiare mirëpo edhe këto kanë qenë të kufizuara nga mungesa e një sqasje sistematike për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe kapacitetit për të zbatuar praktikën e vlerësimit.

Janë bërë hapa të rëndësishëm në avancimin e legjislacionit sekondar mbi zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe krijimin e një sistemi për avancim të kualifikimeve dhe cilësisë përmes trajnimeve - Gjatë ciklit të zbatimit të këtij plani programet e zhvillimit profesional në formën e avancimit të kualifikimeve apo trajnimit të mësimdhënësve janë organizuar dhe mbështetur nga niveli qendror (MASHT) me mbështetje të partnerëve zhvillimor dhe organizatave të specializuara. Një praktikë e tillë mund të ketë qenë e kushtezuar dhe nga mungesa e kapacitetit të shkollës për të planifikuar dhe administruar buxhetin, mungesa e bordeve të shkollave apo prioritizimi i aspekteve tjera në sistemin arsimor. Komunitetet përgjithësisht nuk alokojnë buxhet për zhvillim profesional të mësimdhënësve. Sidoqoftë, në vitin 2013 dhe 2014 janë rishikuar dy udhëzime administrative: udhëzimi administrativ (16/2013) mbi sistemin e zhvillimit profesional dhe udhëzimi administrativ (15/2013) për financimin e zhvillimit profesional. Në bazë të dispozitave ligjore, MASHT përkushtohet që të delegoj fondet për zhvillim profesional të komunitetave me kushtin që ato të jenë në gjendje të ofrojnë plane zhvillimore komunale dhe që ofertuesit e përzgjedhur për zbatim të jenë të akredituar nga niveli qendror. Planet komunal do të bazoheshin në planet individuale të shkollave.

Kalkulimi i orëve të realizuar përmes të dhënave të ofruara nga MASHT (2015) rezulton që mesatarisht rreth gjysma (50 %) e mësimdhënësve janë përfshirë në trajnime të ndryshme mbi kurrikulën e re, teknologjinë informative, vlerësimin e nxënies, metodikën e mësimdhënies dhe trajnime lëndore (Shiko Tabelën në Aneks). Nga kjo rezulton që megjithë progresin e arritur në ofrimin e trajnimeve ende nuk është arritur caku për përfshirje të të gjithë mësimdhënësve në minimum 30 orë trajnimi në vit.

Tabela 10: Përfshirja e mësimdhënësve në trajnime shprehur në orë dhe % (2011-2015). Burimi: MASHT 2015

	2011	2012	2013	2014	2015
Numri mësimdhënësve	9486	13777	12381	12696	9173
% total mësimdhënës	41%	58%	53%	54%	39%
Orë trajnimi mesat.	26	33	19	36	29
Orë të planifikuara	60	60	120	120	120

Një pjesë e komunave kanë realizuar planet e tyre të zhvillimit të ku zhvillimi profesional i mësimdhënësve është një nga elementet kyce me ndihmën e GIZ. Organizata poashtu ka mbështetur komunitetet dhe shkollat përmes doracakëve dhe trajnimeve për hartim të planeve zhvillimore. USAID ka mbështetur disa komuna dhe shkolla në përpilimin e planeve zhvillimore për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe ka ndihmuar në trajnimin e aktivave profesionale. Gjatë periudhës së këtij plani rreth 66% përqind e komunave kanë realizuar planet e tyre zhvillimore dhe rreth 24% e shkollave. Planet e zhvillimit të mësimdhënësve janë pjesë integrale.

.....

Mirëpo në rreth 22 raste shkollat poashtu kanë krijuar edhe plane specifike për zhvillim profesional. Deri më tani, sistemi për delegim të financimit për zhvillim profesional tek komuna ende nuk është realizuar aq më pak delegimi i këtyre përgjegjësive në shkolla.

5.8. Gjithëpërfshirja

Nuk mund të konstatohet saktësisht % e braktisjes, ndonëse janë dhënë shifra konkrete. Nga të dhënat rezulton se ka rënie në shkallën e braktisjes nga viti 2011e deri në vitin 2014 nga 0.48 sa ishte në vitin 2011 në 0.12% në vitin 2014, ndërkaq sa i përket shkallës së braktisjes së shkollimit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët rezulton se nga numri i përgjithshëm i nxënësve të cilët e kanë braktisur mësimin në shkollimin e obliguar, % e braktisjes për gjininë femëroremesatarisht është 51.43% krahasuar me 48.57 % të gjinisë mashkullore. Shkalla e braktisjes sipas gjinive në arsimin e mesëm të lartë është 26.7% gjinia femërore ndërsa 73.3% gjinia meshkullore.

Konsiderohet se shkaqet e rritjessë mesatares se % së braktisjes së shkollimit të nxënësve të gjinisë meshkullore në shkollimin e mesëm të lartë duhet kerkuar në mungesën e mbikëqyrjes nga familja, përkeqësimin e gjendjes ekonomike dhe të kushteve të jetesës si dhe nevoja e inkuadrimit të nxënësve si “krah pune” me ose pa dijeninë e prindërve, etj. Ndërkaq, sa i përket shkallës së braktisjes së komuniteteve nuk ka shënime konkrete. Vlerësimi i progresit mbi shkallën e treguesve të mësipërm tregon se nuk disponohet me të dhëna të mjaftueshme për arritjen e cakut. Në mbështetje të analizës së aktivitetëve, hetohet mungesë e rezultateve që deshmon se caku është larg për t’u arritur meqë shkalla e realizimit mbetet ndërmjet 30-60%. Caku konsiderohet se është relevant për kontekstin aktual dhe strategjinë pasuese dhe PSAK ka shërbye si pikë referuese për akterët institucional, jo-qeveritar dhe partnerët zhvëllimor.

Është hartuar korniza për **monitorim dhe vlerësim të implementimit të Plani Kombëtar për Veprim kundër Braktisjes së Shkollës**, me perkrahjen e UNICEF. Treguesit sasiorë të ndikimit të Planit janë kalkuluar dhe publikuar për nivel kombëtar (publikimet e SMIA); Është realizuar dhe publikuar nga IPKhulumtimi lidhur me mospërfshirjen dhe braktisjen e fëmijëve nga shkolla në shtatë komuna (F.Kosovë, Obiliq, Ferizaj, Klinë, Pejë, Istog, Malishevë). Janë disajnuar dhe testuar instrumentet për identifikimin, menaxhmin e rasteve të braktisjes dhe referimin; Janë hartuar dhe aprovuar udhëzuesit për funksionalizmin e EPRMB-ve nga MASHT. ECMI në partneritet me UNICEF ka perkrahur gjashtë komuna (F.Kosovë, Obiliq, Ferizaj, Klinë, Pejë, Istog) në hartimin dhe implementimin e planeve komunale për përfshirjen e fëmijëve në shkollë dhe adresimin e braktisjes nga shkolla. Është hartuar Udhëzimin Administrativ (UA) nr. 19/2012 për Krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar.

Është ofruar mbështetje për komunat për zbatimin e UA në fjalëpërmes projektit “Avancimi i qasjes dhe mbetjes në arsim për fëmijët e cënuar dhe në disavantazh” i mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF-i) dhe zbatuar nga Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë, gjithmonë në bashkërendim me MASHT-in dhe komunat e përfshira në këtë projekt. Është hartuar Doracaku për ekipet komunale dhe për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar i cili ka për qëllim fuqizimin e institucioneve edukativo-arsimore për rritjen e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim, në kushte dhe ambiente të sigurta dhe të shëndetshme.

Disa nga sfidat janë: Intensifikimi i komunikimit në mes të nivelit qendror dhe komunal lidhur me implementimin dhe monitorimin e politikave të cilat kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen. Përfshirja e fëmijëve që asnjëherë nuk janë regjistruar në shkollë, që janë fëmijë me probleme sociale si dhe atyre me aftësi të kufizuara, etj. Evidentimi i saktë në SMIA i nxënësve që kanë braktisur shkollën, duke mos ngatërruar nxënësit që kanë lëvizur nga një shkollë në shkollën

tjetër. Ngritja e vetëdijes së komunitetit të prindërve për arsim të qëndrueshëm për fëmijët e tyre.

Janë hartuar⁷ udhëzime administrative për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta që dalin nga Ligji për Arsim Parauniversitar. Sfidat kryesore janë: Rritja e numrit të përfshirjes të fëmijëve dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në të gjitha nivelet e arsimit. Shtimi i numrit të mësuesve mbështetës dhe asistentëve për shkolla të rregullta që t'i mbështesin nxënësit me nevoja të veçanta dhe mësimdhënesit që punojme me ta, she Zhvillimi i parametrave për kalkulimin e buxhetit për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, etj.

Mbledhja e të dhënave për braktisjen tek komunitetet jo-shumicë duhet të trajtohet në planin e ardhëshëm. Raportet (OSCE, 2015) flasin se vetëm një pjesë e vogël e ekipeve për parandalim të braktisjes në arsim të obligueshëm (PRTAN) janë themeluar ndërsa disa tjera ende nuk janë aktivizuar. Plani pasues duhet të nënvizoj rëndësinë e funksionalizimit të plotë të këtyre ekipeve.

5.9. Rrjeti i shkollave

Numri i transfereve ndër-komunale në arsimin e mesëm të lartë, në pyetësor nuk janë ofruar shënime të nevojshme. Nga analiza e aktiviteteve rezulton se caku konsiderohet jo relevant për kontekstin aktual dhe për strategjinë pasuese dhe se caku nuk ka shërbye si pikë referuese për akterët institucional, jo qeveritar dhe partnerët zhvillimor. Poashtu, edhe nga analiza e aktiviteteve nuk disponohet me të dhëna fare. Mund të hamendësohet se nuk është kuptuar natyra e problemit. Sfidë mbetet optimalizimi i shpërndarjes së rrjetit të institucioneve në tërë territorin e Kosovës.

5.10. Mjedisi miqësor

Në bazë të analizës së treguesve rezulton se për numrin e rasteve të dhunës në shkollë nuk ka të dhëna relevante për vitet 2011-2014, ndërkaq për vitin 2015 janë prezentur 10 raste. Arsytet qendrojnë në faktin sepas miratimit të Rregullores QRK-NR 21/2-13 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar dhe dukuritë negative, në SMIA është krijuar një modul i veçantë për raportimin e rasteve të dhunës në IAP nga janari i vitit 2015. Nga të dhënat që ofrohen për treguesit e fenomenit rezulton nevojën për ndërmarrjen e një reforme gjithëpërfshirëse për përkujdesje dhe shëndet të nxënësve, përshtatje të aktiviteteve sipas niveleve, kontrollit sistematik për zvogëlimin e obezitetit të fëmijëve, etj. Konsiderohet se caku ende është relevant për kontekstin aktual dhe meriton të planifikohet në strategjinë pasuese, ndonëse caku i PSAK ka shërbye si pikë referuese.

Është hartuar dhe aprovuar Protokoli për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkolla në vitin 2013 nën udhëheqjen e Zyres së Kryeministrit /ZQM ; Janë organizuar shtatë tryeza të rrumbullakëta me ç'rast, institucionet kyçe (shkollat, DKA-të, Qendrat për punë sociale, policia etj.) janë njoftuar lidhur me përgjegjësitë e tyre për realizimin e Protokolit për parandalimin dhe referimin e dhunës në shkolla; Është krijuar moduli për raportimin e dhunës në shkolla kuadër të SMIA dhe zyrtarët në 30 institucione arsimore (kopshte, shkolla fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë) janë duke u trajnuar në përdorimin e tij konform Protokolit; Është hartuar programi për krijimin dhe trajnimin e mediatorëve për parandalimin e dhunës në shkollë përmes të cilit "KEC " do të ndihmojë krijimin e 30 grupeve të mediatorëve në nivel shkolle. Është bërë prezantimi i të dhënave nga Universiteti i Hamburgut për projektin: Shëndeti i fëmijëve në Kosovë (një studim reprezentues 10 vjet pas luftës). Ky projekt është aprovuar nga MASHT dhe është realizuar në Komunën e Gjakovës nga OJQ "Children for tomorrow" në bashkëpunim me Universitetin e Hamburgut. (2011-2012).; Janë siguruar të dhëna për çështjen e ambulancave shëndetësore në shkolla dhe funksionimin e tyre.

Si sfida të mundshme janë: Raktualizimi i iniciatives për ambulancat në shkolla, Përkujdesja e shtuar dhe kontrolli i vazhdueshëm i shëndetit të nxënësve. Respektimi rigoroz i Protokolit për parandalimin e dhunës, Zgjerimi i programit të ofruar nga KEC, në koordinim me MASHT dhe ZK/ZQM, i cili ndihmon implementimin e Protokolit, jo vetëm në shtatë komuna, sa aktualisht i mbulon edhe në komunat tjera, si dhe Zgjerimi i konceptit të shkollave promovuese të shëndetit në të gjitha shkollat

5.11. Infrastruktura

Në bazë të analizës së treguesve rezulton se shkollat në Kosovë aktualisht funksionojnë edhe në një por edhe në dy ndërrime, ndonëse numri i shkollave të ndërtuara dhe të renovuara është inkurajues. Nga analiza e pasqyrës së të dhënave rezulton se ka shtim sistematik të numrit të godinave shkollore nga 1148 në vitin 2011 në 1165 në vitin – numri i godinave të ndërtuara në periudhën prej 2011 e deri në vitin 2015 vazhdimisht është në rritje, mesatarisht për 9.4 godina brenda vitit kalendarik. Ndërkaq, nga të dhënat reale për proporcionin nxënës m² rezulton se ka rritje proporcionale nga 2.9 m² në vitin 2011 përkatësisht 2012 në 3.2 m² në vitin 2014 dhe 2015.

Nga numri i përgjithshëm i shkollave, % e shkollave në zonat rurale rezulton të jetë relativisht i vogël, por që ka tendencë të lehtë ngritjeje, nga 3.23 në vitin 2011 në 3.75 në vitin 2015. Sa i përket numrit mesatar të nxënësve për shkollë në zonat rurale ka tendencë të rënies për shkak të migrimit popullsisë në relacionin fshat- qytet nga 165.600 në vitin 2011 në 162.833 në vitin 2015. Sa i përket numrit mesatar të nxënësve për shkollë në zonat urbane ndonëse ka pas tendencë ngritjeje në vitin 2012 për 1.260 nxënës, numri i nxënësve në vitet në vijim ka rënie të vazhdueshme nga 229.978 në vitin 2013 në 220.487 nëqjashtëmujorin e dytë të vitit 2015. Proporcioni nxënës - klasë / paralele në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, si pasojë e ndërtimit të godinave të reja dhe renovimit të atyre të dëmtuara, ka tendencë rënie mesatarisht për 1.2% për vit. Kështu nga 24 nxënës për klasë/paralele sa ishte në vitin 2011 në 20.7% në vitin 2015. Ndërkaq edhe numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë ndjek të njëjtin trend, ka rënie të vazhdueshme si rrjedhojë e migrimit dhe emigrimit të popullsisë por edhe dukurisë së braktisjes së mësimi të shkollës.

Nga analiza e treguesve rezulton se është shumë afër (për 2.5%) për t'u arritur planifikimi i bërë në PSAK, që 1/3 e shkollave të punojnë në një ndërrim. Është inkurajues fakti se 35.3 % e shkollave kanë punuar në një ndërrim, 64.68 % e shkollave punojnë në dy ndërrime dhe vetëm 1.58% shkollave punojnë në tri ndërrime. Konsiderohet se me ndërtimin e objekteve të reja dhe me renovimin e objekteve të **dëmtuara** është kontribuar edhe në shkurtimin e distancës së shkollës nga shtëpia mesatarisht për 1.58 km. për vjet, pra nga 2.04 km. sa ishte në vitin 2011 në vetëm 0.6 km. në vitin 2015. Numri i shkollave të lidhur në ujësjellës nga 1148 shkolla sa ishin në vitin 2011 në 1165 shkolla në vitin 2015.

5.12. Tekstet dhe resurset mësimore

Një nga arritjet kryesore furnizimi i 134 shkollave me pako minimale të pajisjeve dhe mjeteve mësimore konsiderohet nismë e suksesit. Aktiviteti është shoqëruar me veprime konkrete, si: Janë trajnuar mësime për zbatimin e kurrikulit të ri, janë udhëzuar ata për shfrytëzimin e teksteve aktuale dhe janë udhëzuar të aplikojnë burime tjera alternative, janë hartuar Standardet për tekstet shkollore (Prishtinë, 2011), etj. Sfidë konsiderohet pajisja e të paktën 1/3 të shkollave me pako standarde të pajisjeve dhe të mjeteve mësimore.

MASHT furnizon shkollat dhe nënësit e arsimit filleor dhe të mesëm të ulët me libra falas mirëpo ende ekzistojnë shqetësime rreth mungesës së kapacitetit për distribuim dhe cilësisë së teksteve mësimore - në kuadër të politikës së teksteve mësimore

pas miratimit të Udhëzimit Administrativ, MASHT është përgjegjëse për furnizimin e shkollave të klasave 1-9 me tekste mësimore. Tekstet mësimore ofrohen pa pagesë për çdo vit shkollor në ndërkohë që nxënësit janë të obliguar ti kthejnë kopjet pas përfundimit të vitit shkollor. Megjithatë pak nga nxënësit zbatojnë këtë obligim dhe edhe në ato raste kur kthehen janë të dëmtuara për shkak të cilësisë së dobët (UNDP, 2015). Në anën tjetër për shkak të sfidave në menaxhim të qëndrueshëm të procesit dhe mungesës së mekanizmave për monitorim janë shfaqur dyshime mbi numrin shumë të lartë të kopjeve të printuara (ZAGj, 2014). Procesi i centralizuar duhet të rishikohet për të evituar humbjet në proces.

Tregu i teksteve mësimore duhet të liberalizohet, të përfshij më shumë autorë dhe të standardizohen sipas praktikave ndërkombëtare dhe të jenë neutrale ndaj paragjytimeve shoqërore - Megjithë progresin e arritur në përmirësimin e cilësisë ekzistojnë shqetësime në lidhje me cilësinë pedagogjike të teksteve mësimore. Përzgjedhja e autorëve për përpilim të teksteve mësimore duhet të rishikohet për të evituar tendencat monopolistike në proces (UNDP, 2015). Në anën tjetër, ekzistojnë ende shqetësime mbi përmbajtjen e teksteve mësimore dhe nëse ato janë neutrale ndaj paragjytimeve shoqërore (ESI, 2015). Gjithashtu, pas zbatimit të Kurrikulës së re kërkohet që tekstet mësimore të jenë të orientuara sipas diciplinave dhe rezultateve të të mësuarit. Rekomandohet që të rishikohet përmbajtja e teksteve në mënyrë që ato të jenë të përshkathshme për nivelin psiko-fizik të zhvillimit të fëmijëve dhe të pilotohet me me libra të standardizuar ndërkombëtar për shkencat ekzakta dhe të natyrës.

Ende mbetet sfida publikimi i teksteve mësimore në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë. Kjo mungesë është më e theksuar në arsimin e mesëm të lartë. Edhe në rastet kur ekzistojnë tekstet mësimore ato janë në shumë raste të përkthyer nga gjuha shqipe dhe përkthimi nuk është profesional (OSCE, 2015).

6. Arsimi dhe aftësimi profesional


Në fazën fillestare të shqyrtimit të planit në kuadër të arsimit dhe aftësimit profesional ishin identifikuar një seri sfidash: buxheti i alokuar për arsim dhe aftësim profesional ishte i vogël dhe nuk garanonte parakushte për përmirësim të cilësisë, shkollat profesionale në disa raste funksionin me dy ndrrime, stafi mësimdhënës joadekuat, nuk kishte mekanizma për sigurim të jashtëm të cilësisë dhe barasvlerësimit, kurrikulat nuk ishin të ndërlidhura domosdoshmërisht me kërkesat e tregut të punës dhe mungonte sistemi i modularizuar për transfer të kredive. Gjithashtu, Kosova nuk kishte një Kornizë Kombëtare të Kualifikimeve të harmonizuar me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe përshkrimet e profesioneve pothuajse mungonin në tërësi. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ishte themeluar pak kohë para përpilimit të planit dhe mungonin kapacitet bazë njerëzore dhe materiale për zbatim të kornizës së kualifikimeve. Praktika profesionale nuk ishte e sistematizuar dhe mungonin lidhjet e bashkëpunimit ndërmjet shkollave dhe ndërmarrjeve. Për të adresuar këto sfida, PSAK 2011-2016 kishte listuar tetë 8 objektiva:

OBJEKTIVAT ARSIMIT PROFESIONAL 2011-2016

- 1 Deri në vitin 2014 praktika profesionale e nxënësve është e organizuar në bashkëpunim të ngushtë me ndërmarrjet dhe sigurohet përkrahje për të gjithë nxënësit si dhe është krijuar sistemi për këshillim dhe orientim në karrierë
- 2 Deri në vitin 2014, shkollat profesionale kanë arritur autonomi financiare dhe operacionale
- 3 Deri në vitin 2014 Qendrat e Kompetencës janë bërë pjesë integrale e sistemit kombëtar AAP të bazuar në shkollë.
- 4 Deri në vitin 2014, të fuqizohen lidhjet ndërmjet profileve profesionale që ofrohen nga institucionet e AAP, tregun e punës dhe zhvillimin e burimeve njerëzore dhe janë bërë më relevante për shkathtësitë që ndihmojnë punësimin
- 5 Deri në vitin 2016 është krijuar një sistem gjithëpërfshirës dhe funksional për vlerësim dhe sigurim të cilësisë në të gjitha shkollat e arsimit profesional
- 6 Deri në vitin 2014 kurrikulumit të arsimit profesional është në pajtim me nevojat e tregut të punës, standardet profesionale dhe praktika e mirë evropiane
- 7 Deri në vitin 2016 është siguruar mundësi mobiliteti dhe punësimi për nxënësit brenda dhe jashtë Kosovës
- 8 Deri në vitin deri në vitin 2016 ekziston Korniza Kombëtare e Kualifikimeve dhe janë vendosur procedurat për akreditim dhe sigurim të cilësisë

Rreth gjysma e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë zgjedhin një nga profilet e arsimit profesional, por ndërlidhja mes shkollimit profesional me tregun e punës mbetet sfida që kërkon trajtim të mënjëhershëm - procesi i Torinos duhet të aplikohet me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit profesional, i cili konstatohet se tani nuk është në nivelin e duhur. Megjithatë numrin e madh të ndërmarrjeve të angazhuara për ofrimin e praktikës profesionale, numri i praktikantëve të angazhuar ende mbetet shumë i vogël. Vendosja e bashkëpunimit mes shkollave dhe ndërmarrjeve ka qenë ndër sfidat kryesore për nënsektorin e arsimit profesional. Ndërtimi i kapaciteteve të stafit të shkollave për të siguruar cilësinë që kërkohet nga tregu i punës

dhesigurimin e bashkëpunimit mes shkollave dhe ndërmarrjeve si: sigurimi i instruktoreve të cilët merren me praktikatat e angazhuar në ndërmarrje, rishikimin e standarteve ekzistuese të profesionit dhe vendosja e standarteve që mungojnë, janë çështje të cilave i duhet kushtuar vëmendje. Në anën tjetër fillimii procesit i akreditimit të shkollave profesionale nga ana e Ministrisë, nuk duket të jetë opsion i mundshëm për një diapazon afatshkurtër. Shkalla e zbatimit të PSAK Arsimit Profesional në bazë të indeksit është si më poshtë:



6.1. Praktika në arsimin profesional

Për të adresuar sfidën e mungesës së një kornize sistematike të praktikës profesionale në arsimin profesional, plani kishte listuar një seri aktivitetsesh: të krijohet një sistem koherent i këshillimit në karrierë për ata që hyjnë në sistemin e AAP dhe për ata që kthehen për arsim dhe aftësim të mëtejshëm, sistemi i këshillimit në karrierë të lidhet në mënyrë dinamike me sistemin përkatës të informatave për tregun e punës, të zhvillohet një kornizë kombëtare e shërbimit për këshillim në karrierë, zhvillimi i strategjisë për ngritjen e praktikës profesionale që reflekton gjithëpërfshirjen, të ndërtohet një shërbim kombëtar për këshillim në karrierë dhe të identifikohet dhe trajnohet së paku një zyrtar në secilën komunë për udhëzim në karrierë dhe këshillim krahas trajnimit të mësimdhënësve për udhëzim në karrierë dhe inkurajim të përfshirjes së femrave. Aktivitetet tjera konsistojnë në zhvillim të kritereve të barabarta për nxënësit që kryjnë praktikën profesionale, themelimin e mekanizmit stimulues për ndërmarrjet që ofrojnë praktikë, licencimin e këtyre ndërmarrjeve, themelimin e Qendrës Kombëtare për Orientim në Karrierë dhe zhvillim të politikave për mirëqenie shëndetësore për nxënësit gjatë praktikës.

Nuk ka lidhje të strukturuar ndërmjet shkollave profesionale dhe bizneseve, duke krijuar një mungesë besimi dhe dyshime për cilësinë e ofertës së sistemit të AAP. MASHT në vitin 2013 ka lansuar strategjinë për Praktikën Profesionale 2013-2020 dhe ka përgatitur dy udhëzues për ndërmarrjet dhe shkollat profesionale, me qëllim që të ofrojë mundësinë për bashkëpunim me të madh, por deri më tani nuk ka ndonjë marrëveshje ndërministrrore për ta lehtësuar këtë bashkëpunim dhe për zhvillimin e partneriteteve publiko-private në fushën e AAP. Gjithashtu me këto dokumente MASHT po mundohet që të rrisë bashkëpunimin me përfaqësuesit e partnerëve

social, bizneseve dhe sektorit privat për dizajnimin e politikave, zhvillimin e standardeve të profesionit dhe zhvillimeve të kurrikulave dhe në tërësi në zhvillimin e reformave në fushën e AAP. Në këtë kontekst edhe numri i marrëveshjeve shkollë profesionale dhe ndërmarrje për praktikën profesionale të nxënësve ka shënuar rritje, por kjo gjë nuk është e mjaftueshme. Gjithashtu edhe shërbimet për këshillim në karrierë dhe përcjelljes së punësimit të posadiplomuarve mungojnë në shumicën e SHP dhe numri i nxënësve që kanë përfituar nga këto shërbime është shumë i vogël.

Në vitin 2014 MASHT ka miratuar Udhëzimin administrativ (UA 05/2014) që rregullon qëllimet, strukturën dhe përgjegjësitë e Agjencisë të Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit të Rriturve (AAPARR). Këshilli për arsim dhe aftësim profesional ka funksionuar bazuar në Ligjin për arsim dhe aftësim profesional. Agjencia ka filluar së funksionuari dhe është në proces të konsolidimit. Këshilli në anën tjetër formalizon pjesëmarrjen e akterëve institucional, tregut të punës dhe partnerëve social në politikë-bërjen e arsimit profesional dhe përcaktimin e prioritetëve strategjike në kuadër të MASHT. Funksionalizimi i këtyre mekanizmave parashihet të ndikoj pozitivisht në krijimin e një qasje më koherente në arsimin profesional, të bashkoj të gjithë akterët relevant si ofertuesit ashtu edhe kërkuesit e arsimit profesional dhe të avancoj prioritetin e AAP, **ndërlidhjen e arsimit profesional me tregun e punës.**

Me qëllim të **përmirësimit të ndërlidhjes me tregun e punës**, MASHT po ashtu gjatë vitit 2014 është përqëndruar që të mbështes shkollat profesionale në(i) rritjen e numrit të bashkpëunimeve dhe marrëveshjeve me subjekte të tregut të punës dhe punësimit dhe (ii) të mbështes dhe udhëzoj shkollat në zbatimin e Strategjisë për praktikën profesionale. Rreth 60 % e nxënësve në shkollat profesionale kanë patur mundësinë që të angazhohen në praktikë profesionale dhe janë evidentuar rreth 700 marrëveshje të ndryshme me subjekte afariste, publike dhe shoqërore për praktikë profesionale.

6.2. Autonomia financiare dhe operacionale

Plani parasheh që në arritjen e objektivit për fuqizim të autonomisë financiare dhe operacionale do të duhej realizuar disa aktivitete: analizimi i shpenzimeve për programe shkollimi të arsimit profesional në 13 komuna, zhvillimin e një formule të veçantë për financimin e shkollave të arsimit profesional që bazohet të profile, krijohet një sistem qeofron mundësi të barabarta për bursa për femrat dhe komunitetet, thjeshtëzim të procedurave për menaxhim financiar për xhirollogaritë e shkollave, zhvillimi i kriterëve financiarë për shkollat me profile specifike dhe numër më të vogël të nxënësve, trajnimi i drejtorëve të shkollave të arsimit profesional për menaxhimin e veprimit autonom financiar, rishikimin e numrit të shkollave të arsimit profesional dhe zvogëlimi i tyre në krahasim me vendndodhjen e Qendrave të Kompetencës dhe përgatitjen e hartës së ofruesve të arsimit profesional.

Përkundër zhvillimeve pozitive për autonomi financiare dhe ngritjes së kapaciteteve të menaxherëve të shkollave për menaxhim, është i nevojshëm decentralizimi i mëtejshëm dhe autonomia në lidhje me buxhetin e shkollave të AAP për planifikim, drejtim dhe menaxhim nga komunat në nivel të shkollave, për të lidhur prioritetet e shkollave dhe alokimin e buxhetit. Kjo do të duhej të mbështetej duke zhvilluar kapacitetin e drejtorit për të menaxhuar vetëbuxhetin e shkollës. Është e nevojshme zhvillimi i sistemeve më efektive dhe më fleksibile të buxhetit të shkollave të AAP për të përmbushur nevojat e ndryshme të profileve të AAP, pasi shpenzimet ndryshojnë në një shkallë të madhe. Duhet të thjeshtësohen procedurat administrative dhe burokratike për gjenerimin e të ardhurave vetanake, burimet financuese dhe nevojat e menaxhimit dhe institucionet e AAP duhet të inkurajohen dhe stimulohen në këtë drejtim. Kjo do të ketë një ndikim të madh në ofrimin e shkathhtësive që kërkohen nga tregu i punës. Politika qeveritare duhet të marrë parasysh themelimin e programeve formale post-sekondare të AAP

brenda QK me programe fleksibile për të përmbushur nevojat e ndryshueshme dhe zhvillimin personal për të siguruar qëndrueshmëri financiare të tyre.

Me qëllim të rregullimit të **autonomisë operacionale dhe financiare** të institucioneve të arsimit profesional, MASHT ka miratuar Udhëzimin administrativ (UA 01/2014) për organizimin dhe planifikimin e arsimit dhe aftësimit profesional në institucionet publike dhe Udhëzimin administrativ (UA 07/2014) për rregullimin e veprimtarisë ekonomike të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional. Kjo paraqet një hap tutje në rregullimin e kushteve dhe kritereve për veprimtarinë ekonomike për institucionet e arsimit profesional. Udhëzimi u mundëson institucioneve që të zgjerojnë veprimtarinë shërbyese dhe prodhuese, të menaxhojnë mjetet vetanake, të angazhojnë ekspertë të jashtëm në procesin mësimor dhe për të rregullar angazhimin e stafit në aktivitete prodhuese dhe shërbyese.

Ndërsa sa i përket çështjes së financimit të publik të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional janë shqyrtuar mundësitë për (i) krijimin e një nën-sektori buxhetor në nivel qendror dhe nivel komunal dhe MASHT po shqyrton mundësinë e ndryshimit të formulës së financimit sipas sektorëve /profileve perkatëse. Në sajë të këtij aktiviteti legjislativ por edhe veprimeve tjera për trajnimin e udhëheqësve të shkollave dhe krijimit të kodeve të veçanta buxhetore, konsiderohet që është arritur caku i PSAK për avancim të autonomisë së 61 shkollave të arsimit profesional. Sidoqoftë, ende mbetin vështirësi teknike në kthimin e mjeteve vetanake nga buxheti arsimor komunal.

Modeli i financimit të institucioneve të arsimit profesional është propozuar nga MASHT mirëpo ende nuk është në proces të zhvillimit. Vështirësitë në këtë kuadër konsistojnë në krijimin e shkallëve dhe profileve të ndryshme të financimit varësisht nga nevojat e veçanta infrastrukturore për arsim profesional. Finalizimi i këtij procesi ishte një nga caqet e nënprogramit për arsim profesional në kuadër të PSAK në vitin 2014, mirëpo për shkak të nevojës për diskutime dhe elaborime shtesë ky aktivitet prioritar pritet të trajtohet gjatë vitit në vazhdim. Sektori i arsimit profesional ka përfituar një përqindje të lartë të financimit nga partnerët zhvillimor që nga miratimi i PSAK, mirëpo vitin e fundit janë vërejtur rënie të kontributeve. Andaj, si për të avancuar autonominë operacionale dhe financiare por edhe për të krijuar plane për të kompenzuar zvogëlimin e asistencës së jashtme, duhet të trajtohet dhe zgjedhet çështja e formulës së financimit të arsimit profesional. Po ashtu, duhet bërë një plan veprimi për të zgjeruar mundësinë e bashkëfinancimit nga punëmarrësit.

6.3. Integrimi i Qendrave të Kompetencës

Gjatë elaborimit të planit Qendrat e Kompetencës ishin themeluar nga qeveria, por nuk ishte specifikuar qartë qëndrueshmëria e tyre. Në fakt ato ishin themeluar me qëllim që të ofronin shkollim të mesëm të lartë e që ishin përgjegjësi e komunave, por ishin menduar si iniciativa qendore në mbështetje të arsimit profesional. Për të integruar QK plani parashihte disa aktivitete: zhvillim më të detajuar të konceptit të QK duke definuar vendin e tyre në sistemin e arsimit profesional dhe mënyrën si janë të integruara në rrjetin e shkollave të komunitetit, krijimin e një formule të financimit të qëndrueshëm për të gjitha QK dhe shkollat profesionale varësisht nga profilet, aftësim të mësimdhënësve të shkollave tjera në kuadër të QK dhe ofrim të infrastrukturës së trajnimit, freskimin e kurrikulës lëndore në module për QK me 20 profile për shkollë dhe zhvillimin e QK-ve për të funksionuar si udhëzues për karrierë dhe pika këshillim dhe sigurimi të informacionit për tregun e punës (praktikë profesionale dhe mundësi pune).

Ka zhvillime shumë pozitive në qendrat e kompetencës për sa i përket infrastrukturës, ngritjes së kapaciteteve të tyre, zhvillimin e standardeve të profesionit sipas kërkesave të tregut të punës, kurrikulave modulare të bazuara në kompetenca dhe materialeve mësimore. Gjithashtu për 18

profile është bërë edhe analiza e shpenzimeve, por duhet të sigurohet qëndrueshmëria financiare e këtyre QK pas ndërprerjes së përkrahjes së partnerëve zhvillimor. Sepse profilet profesionale që ofrohen në to kanë shpenzime të mëdha dhe buxheti që kanë këto shkolla është i pamjaftueshëm për të siguruar zhvillim dhe qëndrueshmëri. Pra, për këto qendra duhet të rishikohet koncepti dhe të shndërrohen në qendra multifunksionale në funksion të qëllimit për të cilin janë krijuar.

MASHT gjatë kësaj periudhe raportuese përpos që ka mandatur AAARRAP për të përkrahur zhvillimin e Qendrave Aktuale të Kompetencës (QK), ka miratuar edhe Udhëzimin administrativ (UA 07/2014) që rregullon avancimin, autonominë dhe funksionalizimin e institucioneve të arsimit profesional. Me këto veprime krijohet një strukturë institucionale dhe rregulla administrative për qeverisje dhe **promovim të Qendrave të Kompetencës** konform prioritetit strategjik të nënprogramit të arsimit profesional. Krahas angazhimit për të mbështetur tri qendrat aktuale, MASHT ka bërë planin mbështetës për avancimin e dy qendrave të reja të kompetencës përshkollën emesme të makinerisë (Prishtinë) dhe shkollën teknike në (Prizren). Ministria, po ashtu ka shtuar përpjekjet që QKtë shërbejnë edhe si qendra burimore për shkollat tjera profesionale dhe të shkëmbjenë praktikën e mira me qëllim të lehtësimit të procesit të zbatimit të kënaqshëm të kushteve dhe kriterëve të arsimit profesional. Zbatimi i plotë i caktuar të nënprogramit për avancim të QK-ve tjera kushtëzohet nga kufizimet buxhetore

6.4. Relevanca e profileve për tregun e punës

Është zhvilluar praktika e mbledhjes së të dhënave të tregut të punës mirëpo mungojnë mekanizmat dhe kapacitetet për koordinim institucional dhe përfshirje të palëve të interesit- Përmirësimi i Sistemit të Informatave të tregut të punës dhe krijimi i një lidhje efektive ndërmjet SMIA dhe Qendrave Rajonale të Punësimit (QRP) dhe palëve tjera me interes është imperativ. Po kështu marrëveshja e realizuar kohëve të fundit për SMIAL dhe integrimin e Sistemit të Menaxhimit të Informatave në arsimin parauniversitar, me atë universitar dhe Sistemin e informatave të tregut të punës është zhvillim shumë pozitiv. Por, duhen përmirësuar mekanizmat për identifikimin dhe parashikimin e nevojave për shkathtësi të punëdhënësve në të ardhmen, për të planifikuar më mirë sistemin e AAP. Poashtu, mbetet sfida hartimi i Kornizës bërthamë të kurrikulës për AAP, ri-shqyrtimi i kurrikulave ekzistuese të AAP dhe zhvillimi i kurrikulave të reja modulare të bazuara në kompetencë sipas Standardeve profesionale dhe që i përmbushin kriteret e AKK për akreditim, bazuar në nevojat e tregut të punës, planeve zhvillimore të Qeverisë. Krahas reformimit të kurrikulave është e nevojshme rritja e kapacitetit për tranzicion në tregun e punës dhe shkallën e punësimit të të diplomuarve.

Mungon praktika, mekanizmat dhe kapaciteti për analizim, ndërlidhje dhe parashikim të nevojave të tregut të punës - Nuk kemi sistem aktiv për ndërlidhjen e të dhënave të tregut të punës me arsimin në Kosovë dhe nuk ka ndonjë evidencë se ato janë shfrytëzuar në reformimin e profileve në arsimin profesional. Aktualisht ekzistojnë tri sisteme të të dhënave që mund të shfrytëzohen për të prodhuar të dhëna të përafërta: Sistemi i regjistrimit të të papunëve që mirëmbahet nga Ministria e Punës (LMIS), të dhënat në lidhje me fuqinë punëtore nga Agjencia e Statistikave (ASK) dhe studimet në lidhje me disponimin e ndërmarrjeve në raport me mjedisin biznesor e ku shkathtësitë e fuqisë punëtore janë një nga dimensionet si BEEPS (2013) nga Banka Botërore. Kosova ka nevojë urgjente për një sistem për përpunimin e të dhënave që ndërlidh të dhënat e kategorive të shkollimit të ISCED dhe Eurostat me të dhënat e kategorive të punësimit (ISCO) dhe sektorëve ekonomik (NACE). Të dhënat statike sasiore mund të jenë të dobishme për të dhënë indikacione numerike në lidhje me kërkesën e tregut të punës, mirëpo ato duhet të kombinohen më të dhëna cilësore (BEEPS) dhe produktivitetin e fuqisë punëtore (OECD). Ndërlidhja sasiore me tregun e punës nuk nënkupton domosdoshmërisht që fuqia punëtore të ketë arritur shkallën e duhur të cilësisë.

Tregu i punës në Kosovë nuk gjeneron vende të mjaftueshme për absorbim të fuqisë punëtore, mirëpo kërkesa për disa profile të shkathtësive mbetet e pambuluar në ndërkohë që është rritje numri i të nxënësve të papunë, të profilizur në sektor me kërkesë të ulët apo me mungesë të shkathtësive të transferueshme - Tregu i punës në Kosovë ballafaqohet me dy probleme strukturore e që ndërlidhen me shkallën dhe cilësinë e sistemit arsimor. Fillimisht shkalla e kërkesës në tregun e punës është e ulët dhe trendi i vendeve të punës të gjeneruara vitet e fundit nuk garanton punësim të të diplomuarve. Së dyti, ekziston edhe problemi i mospërputhjes së cilësisë së kualifikimit dhe tregun e punës – ekzistojnë disa sektorë ekonomikë që ballafaqohen me mungesë të shkathtësive adekuatë. Rezultatet e anketës së ndërmarrjeve BEEPS (Bank Botërore, 2013) tregojnë se rreth 76 % përqind e ndërmarrjeve në Kosovë raportojë se shkathtësitë dhe shkollimi i fuqisë punëtore paraqesin problem për operimin e biznesit.


Në anën tjetër pjesëmarrja e fuqisë punëtore me kualifikim të lartë në sektorin privat është vetëm 7% nga e gjithë fuqia punëtore e punësuar në këtë sektor. Kjo është dukshëm më e ulët se sa pjesëmarrja mesatare e punëtorëve me arsimim terciar në fuqi punëtore në Kosovë rreth 20% (OECD, 2015). Përveç punëtorëve me arsimim terciar, ndërmarrjet raportojnë pakënaqësi edhe me nivelin e shkathtësive të punëtorëve me shkollim të mesëm të lartë profesional. Punëdhënësit raportojnë se fuqia punëtore nuk ka shkathtësi adekuatë të përgjithshme të transferueshme siç janë komunikimi, zgjidhja e problemeve, shkathtësi matematike-numerike, shërbime për klientë, etj. Kjo vë në pah rëndësinë e cilësisë së shkollimit të ulët dhe atij të mesëm që ndonjëherë nuk merret parasysh në diskutimet e lidhjes në mes të shkollimit dhe tregut të punës.

Sistemi i arsimit profesional të mesëm të lartë ka orientim të lartë të nxënësve në fushat e shkencave shoqërore, biznesit dhe juridikut, shëndetësisë dhe shkencave kompjuterike ndërsa vërehet orientim në nivelin e shanseve për punë me shkathtësi nga fushat e shërbimeve, përpunimit/prodhimit dhe bujqësisë - Studimi i përshtatshmërisë së profileve të arsimit profesional nuk është qëllimi primar i këtij vlerësimi. Sidoqoftë, vlerësimi inkorporon disa të dhëna rudimentare që japin indikacione fillestare mbi këtë fenomen. Vlerësimi ka krahasuar të dhënat mbi numrin e studentëve të regjistruar në profile të arsimit profesional (EMIS, 2014) me numrin/trendin e krijimit të vendeve të punës sipas shkathtësive ndërmjet viteve 2003-2013 (ASK, 2014). Kategorizimi i profileve dhe shkathtësive të vendeve të punës është realizuar përmes kategorive të shkathtësive të Eurostat. Të dhënat fillestare tregojnë që numri i nxënësve në arsim të mesëm të lartë që ndjekin profilet e kategorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies është rreth 5 herë më e lartë (14.6%) se sa numri i vendeve të punës të krijuar në këtë sektor të shkathtësive në dekadën e fundit (3%). Ekziston një shpërputhje e vogël por e ndjeshme ndërmjet numrit të vendeve të punës të krijuara në kategorinë shkenca shoqërore, biznes dhe juridik (28%) me numrin e nxënësve që studiojnë në këto profile (35%).

Përderisa në kategoritë e caktuara kemi numër më të lartë të nxënësve se sa fuqia e absorbimit në treg të punës, ekzistojnë disa sektorë ku numri i nxënësve është më i vogël se sa trendi i krijimit të vendeve të punës. Kemi një shpërputhje të theksuar ndërmjet numrit të nxënësve në kategorinë e shërbimeve (9%) me numrin e vendeve të punës të krijuara në dekadën e fundit (27) %. Numri i studentëve në profilet që ndërlidhen me shërbimet si shërbimet personale (hoteleri, turizëm, floktar dhe estetikë), shërbimet e transportit, mbrojtje e natyrës dhe përkujdesje e kafshëve dhe shërbime të sigurimit të pronës dhe sigurimit fizik janë rreth 3 tre herë më e vogël se sa potenciali i tregut të punës. Kemi edhe një shpërputhje modeste në kategorinë inxhinieri, përpunim dhe ndërtim ku numri i studentëve të këtyre profileve është i lartë por ende nën potencial të tregut të punës. Kjo jap indikacione se arsimi profesional duhet të përkujdeset për një numër më të madh të studentëve në profilet ekzistuese apo të reja në përpunim ushqimor, makineri, përpunim druri,

përpunim të metaleve, përpunim të gomës, pajisje elektrike, zdrukhtari, përpunim të plastikës, tekstil dhe përpunim të lëkurës.


Figura 20: Orientimi i nxënësve të AAP në raport me vendet e punës të krijuara ndërmjet 2004-2014. Burimi ASK dhe MASHT



Ekziston një shpërputhje e konsiderueshme ndërmjet nevojave të tregut të punës dhe profileve industriale të komunave dhe orientimin e nxënësve dhe profilet e ofruara në shkollim të mesëm dhe të lartë profesional - Nëse analizohen profilet dhe orientimi i studentëve sipas komunave, atëherë vërehen disa anomali dhe shpërputhje të ofertës arsimore me kërkesën e tregut të punës. Arsimi profesional në komunat si Novobërdë, Dragash, Fushë Kosovë, Shtime, Rahovec dhe Deçan janë qëndritës kryesisht të orientuara kah profilet e juridikut dhe administrimit të biznesit, duke neglizhuar apo nënvleftësuar rëndësinë e bujqësisë, përpunimit dhe shërbimeve. Në anën tjetër orientimi i studentëve në profilet e inxhinierisë, prodhimit dhe ndërtimtarisë është tepër i lartë në komunat ku dominon bujqësia dhe zhvillimi rural. Pothuajse të gjithë nxënësit e arsimit profesional në Istog dhe Klinë janë të orientuar në profile me kontribut modest në ekonominë lokale. Bujqësia dhe veterinaria janë pothuajse tërësisht të neglizhuara në komunat me bujqësi të zhvilluar, si Rahoveci (vreshtat), Dragashi (flora dhe fauna), Mitrovicë (blegtoria dhe rritja e peshqve), Pejë (prodhimet bujqësore dhe ushqimore), Kamenicë (bimët dhe përpunimi i drurit).

Në komunat tjera si Hani i Elezit, Glogovc, Mitrovicë që njihen për nxjerrje të metaleve dhe përpunim, orientimi i nxënësve në profilet gjegjëse është shumë i vogël ose inekzistent. Numri i studentëve në fushën e shëndetit dhe mirëqenies në qendrat rajonale të mjekësisë (Mitrovicë, Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjilan) është i lartë në krahasim me shanset për punë. Gjithashtu, profilet nënvleftësojnë rëndësinë e shërbimeve si radiologji, anesteziolog, teknik i dhëmbëve, farmaci, fizioterapi dhe mami dhe favorizojnë studime në profile jo mirë të specifikuar. Vërehet një mungesë e profileve dhe numri adekuat të nxënësve në fushën dhe shkathtësitë e shërbimeve personale, shtëpiake, sigurimit fizik, kujdesit estetik, floktari, rrobaqepësi në rajonet e mëdha urbane si Prishtina, Ferizaj dhe Prizren. Nevoja për shkathtësi dhe profesionistë në fushën e shërbimeve duket të jetë rreth pesë herë më e madhe se sa orientimi aktual i studentëve. Nuk ka nevojë për analiza të detajuara mbi tregun e punës për të vërejtur shkallën e shpërputhjes së ofertës arsimore. Kërkohe reagim urgjent në korrektimin e këtij

shtegu duke përdorur procesin e vlerësimit të jashtëm për (mos) akreditim të profileve, apo duke përdorur shumtë financiar për fushat prioritare dhe financim të pjesëshëm për fushat tjera.




Vërehet progres në avancim të nivelit të kualifikimit arsimor të stafit mësimdhënës, mirëpo është e vështirë të konkludohet ndonjë impakt pozitiv, për aq sa kualifikimet mund të jenë jashtë lëndëve përkatëse dhe të kufizuara nga mungesa e avancimit të shkathtësive pedagogjike - Një element i rëndësishëm për ndërlidhjen me tregun e punës dhe përmirësim të cilësisë në arsimin profesional është edhe kuadri mësimdhënës. Nuk ekziston ndonjë program i veçantë për përgatitje në arsimin profesional për avancimin të kualifikimeve. Universiteti i Prishtinës ka bërë ca hapa në hartimin e një kurrikule master të përqëndruar tek arsimi profesional. Sidoqoftë, përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies varet në masë të madhe nga kapaciteti i sistemit arsimor për të balancuar stafin me shkathtësi lëndore pedagogjike, por edhe kuadër më përvojë specifike nga tregu i punës dhe industria. Nga analiza e të dhënave vërehet një përparim i moderuar në avancim të kualifikimeve të stafit nga vitit 2010/2011 deri në vitin 2013/2014 (ASK, 2014). Shkalla e mësimdhënësve me përgatitje të avancuar terciare dhe universitare është rritur ndjeshëm (94 %), ndërkohë që është zvogëluar numri i mësimdhënësve me kualifikim të lartë teknik.

Sidoqoftë, përmirësimi nominal i kualifikimeve nuk nënkupton domosdoshmërisht që kualifikimet janë të përshtatshme për profilet e ofruara dhe nuk garanton përsosje të metodave didaktike në mungesë të një programi specifik për arsim profesional. Sipas të dhënave të rrumbullakësuar të SMIA (2015) rreth 40% e mësimdhënësve nuk kanë nivelin adekuat dhe kualifikimin përkatës për lëndët që ofrojnë. Angazhimi i kuadrit mësimdhënës me kualifikim

post-sekondar jo terciar, si shkolla e lartë teknike, nuk është në përputhje me Udhëzimin mbi Normativin e Mësimdhënësve (MASHT, 2014) dhe është jashtë praktikave të mira Evropiane.

Figura 22: ASK (2015) Kualifikimet e mesimdhënësve në AAP
2010/2011-2013/2014



6.5. Menaxhimi i cilësisë në arsim profesional

Sistemit të arsimit profesional, sikurse edhe atij parauniversitar në përgjithësi, i mungon praktika e vlerësimit të jashtëm dhe mekanizmat e brendshëm të sigurimit dhe menaxhimit të cilësisë. Plani parashikonte që ky prioritet duhej adresuar duke zbatuar një seri aktivitesh gjatë viteve 2011-2016: rishikimi i sistemit të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë duke u bazuar në praktikat më të mira kosovare dhe evropiane, ndërtohen kapacitetet për vlerësim dhe sigurim të cilësisë në kuadër të sektorit, zhvillimi i standardeve për vlerësim të bazuar në kompetencë dhe në qasje modulare, zhvillimi i procedurave për njohje të të nxënësve paraprak dhe zhvillimi i procedurave për njohje të arsimit paraprak.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka ndërtuar dhe është duke i zbatuar mekanizmat për sigurim të cilësisë në IAAP. Gjithashtu ka organizuar një seri të trajnimeve për vlerësim, vetëvlerësim, mentorim, sigurim të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë në të gjitha regionet dhe për të gjitha institucionet e AAP. Përkundër faktit që ka numër shumë të kufizuar të stafit, u është ofruar përkrahje të gjitha IAAP në hartimin e raporteve të vetëvlerësimit, ndërtimin e planeve të përmirësimit dhe të gjitha IAAP kanë arritur të hartojnë këto raporte. Megjithatë në shumicën e shkollave profesionale nuk është zgjidhur si duhet statusi i koordinatorëve të cilësisë. Por ajo që është më e rëndësishmja, cilësia e sistemit të AAP lë shumë për të dëshiruar dhe kjo është vërtetuar edhe me provimin e maturës në afatin e parë në Qershor 2015, kur vetëm rreth 31% e nxënësve të shkollave profesionale kanë treguar rezultat pozitiv. Gjithashtu, në procesin e validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të IAAP janë përfshirë vetëm dy SHP private, ndërsa SHP publike ende nuk janë të përfshira në këtë proces.

Orientimi strategjik për **avancim të cilësisë** në kuadër të PSAK konsiston në krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe funksional për vlerësim dhe sigurim të cilësisë në arsimin profesional. Në këtë kuadër prioritetizohet ndërtimi i strukturës së sigurimit të cilësisë dhe njohja e të nxënësve paraprak. Gjatë vitit 2014, MASHT ka miratuar dy udhëzime administrative që sforcjnë përpjekjet për zbatim të këtij prioriteti. Është aprovuar Udhëzimi administrativ (UA 32/2014) që përcakton kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësimin

profesional - proceset e mbrendshme dhe miratuar Udhëzimi administrativ (UA 02/2014) për numrin e nxënësve me module dhe kualifikime, resurset, infrastruktura shkollore dhe siguria e nxënësve.

Ndërtimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë përfshin edhe zhvillime tjera të ndërlidhura ligjor dhe institucionale. Këtu vlen të nënvizohet (i) mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë, (ii) mekanizmat e jashtëm të sigurimit të cilësisë programore dhe institucionale, (iii) mekanizmat tjerë relevant në procesin e inspektimit të zbatueshmërisë së kornizës ligjore - Inspektorati i Arsimit. Në kuadër të mekanizmave të mbrendshëm të sigurimit të cilësisë MASHT ka draftuar udhëzimin që mandaton krijimin e zyrave dhe zyrtarëve për sigurim të cilësisë dhe zbatimin e procesit të vetë-vlerësimit vjetor. Gjatë këtij viti të gjitha shkollat profesionale kanë kompletuar raportet e vetë-vlerësimit, anipse ende mbetet hapësirë për të përmirësuar cilësinë e tyre. Parametrat e stafit, infrastrukturës, resurseve dhe udhëzime tjera relevante do të mundësojnë krijimin e referencave të qarta të cilësisë. Po ashtu, MASHT ka miratuar edhe Udhëzimin administrativ për Njohjen e të nxënësve paraprak.

KKK është organ tjetër i themeluar nga MASHT për sigurim të cilësisë në sistemin e AAP dhe nëpërmjet saj AKK ushtron funksione të rëndësishme për sigurimin e cilësisë: validim (p.sh. aprovim) i kualifikimeve, akreditimi i institucioneve, sigurim të cilësisë së vlerësimeve (verifikimit) dhe miratimi i certifikatave të lëshuara nga shkollat AAP. Kapacitetet e AKK janë ende të kufizuara për të zbatuar procesin e paraprak të akreditimit institucional të shkollave profesionale mirëpo janë bërë plane dhe diskutime parapërgatitore në këtë drejtim. Krahas progresit të zbatimit të Kurrikulës së re, MASHT ka shtuar përpjekjet për vetëdijësimin e shkollave mbi rolin e cilësisë përmes trajnimeve me partnerët zhvillimor. Për ti ndihmuar krahasueshmërinë ndërkombëtare të të nxënësve, MASHT në vitin 2014 ka implementuar projektin e vlerësimit ndërkombëtar të nxënësve PISA dhe organizuar provimin e Maturës

6.6. Kurrikula dhe standardet profesionale

Gjatë diskutimeve fillestare në lidhje me arsimin profesional ishte konkluduar që zhvillimi i kurrikulave kishte qenë pjesërisht i shkëputur nga zhvillimet ekonomike dhe përmbante trajtat të vazhdimësisë së funksionimit të kushtëzuar nga zhvillimet e dekadave të kaluara. Adresimi i këtij prioriteti nënkuptonte rishikimin e standardeve të profesionit dhe kurrikulave dhe rregullimi i tyre sipas trendeve bashkëkohore në arsimin profesional. Plani parasheh realizimin e disa aktiviteteve; zhvillimin e standardeve për kurrikulën e arsimit profesional në bashkëpunim me industrinë, analizimin e metodave të zhvillimit të kurrikulës dhe të dhënave të tregut të punës, rishikimit të numrit të profileve të ofruara nga arsimi profesional, zhvillimi i standardeve për 10% të profesioneve të ofruara nga arsimi profesional si dhe materialet mësimore deri në vitin 2012 dhe përditësimin e kurrikulës duke u bazuar në nevojat e tregut dhe prioritetet e zhvillimit të burimeve njerëzore. Poshtu ishte paraparë që deri në vitin 2016 do të zhvilloheshin të gjitha standardet e profesionit, do të reformoheshin të gjitha kurrikulat dhe materiali i mësimdhënies.

Profilat dhe kurrikulat për QK të përkrahura nga partnerët zhvillimor, kanë respektuar procedurat e domosdoshme për të krijuar një sistem të AAP të bazuar në kërkesë duke zhvilluar së pari standardet e profesionit. Megjithatë, përkundër ri-shiqimit të kurrikulave për të gjitha profileve për shkak të klasës së 13, megjithatë shumica e tyre mbetin irrelevante për tregun e punës dhe janë shikuar pa ndonjë analizë të mirëfilltë dhe pa zhvilluar paraprakisht standardet e profesionit. Kurrikulat që ofrohen momentalisht kryesisht janë të dy llojeve; kurrikula të lëndëve të teorisë profesionale dhe module të praktikës profesionale dhe kurrikula modulare. Prandaj, paraprakisht duhet të ndërtohet sistemi për analizën e mungesës së shkathtësive, ndërtimin e standardeve të profesionit për sektorë prioritarë dhe të zhvillohen kurrikulat e

.....

bazuara në kompetenca sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe kërkesave të AKK për validim të kualifikimeve profesionale.

Procesi i **pilotimit të Kurrikulës së re dhe kurrikulës bërthmë** në arsimin profesional ka filluar si zbatuari në dy shkolla (Lipjan dhe Prishtinë) ndërsa për vitin pasues rrjeti i përfshirjes është zgjeruar edhe në tri shkolla në Gjilan, tri shkolla në Ferizaj, 6 shkolla në Prishtinë, 4 shkolla në Pejë, 5 shkolla në Mitrovicë, 2 shkolla në Prizren dhe 2 shkolla në Gjakovë. Aktualisht procesi i pilotimit është zbatuar apo është në zbatim e sipër në 27 shkolla profesionale. Procesit të pilotimit i ka paraprirë edhe trajnimi i mësimeve në seminarët për zbatimin në praktikë të Kornizës së Kurrikulës, aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit të zbatimit të kurrikulës së re dhe Metodologjia e mësimit, materialet mësimore dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve. Mësimeve kanë përfituar edhe nga udhëzuesit praktik për secilën fushë të kurrikulës së re.

Poashtu, MASHT ka aprovuar edhe dy udhëzime administrative : Udhëzimi administrativ (UA 35/2014) që përcakton kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë dhe Udhëzimi administrativ (UA 16/2014) që përcakton kualifikimet dhe modulet e arsimit postsekondar, emërtimin dhe funksionimin e tyre. Po ashtu, është miratuar Udhëzimi administrativ (UA 31/2014) për njohjen e mësimit paraprak.

6.7. Mobiliteti dhe punësimi i nxënësve

Objekti synonte që deri në vitin 2016 të sigurohen mundësi mobiliteti dhe punësimi për nxënësit brenda dhe jashtë Kosovës. Në kuadër të këtij prioriteti ishin listuar një seri aktivitete: mbledhjen informata për tregun e punës duke përdorur informatat dhe burimet e Ministrisë së Punës, Tregtisë, Odës Ekonomike dhe Agjencisë së Statistikave, zhvillimi i programeve që sigurojnë interesim të shtuar dhe mobilitet të fuqisë punëtore, punësim më të madh dhe transfer të kredive, zhvillimi i SMIA dhe aftësimi i administratorëve të shkollave për të mbajtur shënimet për punësimet e nxënësve, vlerësimi i pilotëve për përcjelljen e nxënësve, zhvillimi i strategjive për përkrahjen e bizneseve të diplomuarve të arsimit profesional, promovimi dhe përkrahja e programeve për fillimin e bizneseve, zhvillimi i rrugëve afatgjata të progresit për nxënësit në nivele më të larta ISCED 4 dhe 5 dhe krijimi i skemave qeveritare për bursa për 50 nxënës çdo vit për praktikë profesionale⁶ mujore jashtë vendit.

Përkundër disa përparimeve dhe iniciativave shumë të kufizuara në këtë drejtim ka shumë ngecje të mëdha dhe është bërë shumë pak përparim. Grantet për zhvillimin e planeve të bizneseve dhe themelimin e bizneseve të reja janë kryesisht të mbështetura nga partnerët dhe janë shumë të kufizuara në numër, ndërsa sistemi i bursave kryesisht mbulon një numër të kufizuar të nxënësve nga komuniteti i RAE.

6.8. Sistemi kombëtar i kualifikimeve

Objekti parashikon që deri në vitin 2016 ekziston sistemi funksional kombëtar i kualifikimit dhe janë hartuar procedurat për ekuivalencë, akreditim dhe sigurim të cilësisë. Në korniza të objektivit të formuluar në vitin 2011 parashihen disa aktivitete kryesisht të ndërlidhura me zhvillimin e kapacitetit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve: institucioni ka të punësuar të gjithë personelin e nevojshëm dhe ka krijuar kapacitetet e duhur për implementimin e kornizës kombëtare të kualifikimeve, personeli dhe ekspertët e AKK bëjnë pilotimin e akreditimit të programeve dhe të institucioneve dhe janë hartuar procedurat për implementimin e kornizës së kualifikimeve. Poashtu, MASHT do përkrahte shkollat dhe institucionin në procesin e akreditimit të programeve e të institucioneve.

7. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në kuadër të PSAK 2011-2016 ishte vendosur si nën-program i vecantë me qëllim të adresimit të disa sfidave me të cilat kuadri mësimdhënës ballafaqohet në kohën e incimit të planit. Sistemi në përgjithësi synonte që të përmirësonte cilësinë e mekanizmave të përgatitjes së mësimdhënësve para-shërbimit dhe gjatë shërbimit. Pas aftësimit akademik mësimdhënësit duhet kaluar edhe një periudhë të caktuar për përgatitje pedagogjike. Në kohën e planifikimit fillestar ekzistonte një strukturë e fragmentuar e përgatitjes së mësimdhënësve dhe ishin disa fakultete të Universitetit të Prishtinës të involvuar në proces. Synimi primar në dimensionin e kualifikimit para shërbimit ishte që të unisohen standardet, ndërliqhet oferta arsimore me kërkesën në treg dhe të zhvilloheshin mekanizma për inkuadrimitin e mësimdhënësve të fakulteteve jo-arsimore. Dimenzioni i aftësimit profesional pas shërbimit ishte i orientuar kah ngritja e shkathtësisë të mësimdhënësve për ofrimin e kurrikulës së re dhe përmirësimin të metodave të mësimdhënies. Plani i ZHPM kishte 13 objektiva:


OBJEKTIVAT ZHVILLIMI PROFESIONAL I MESIMDHENESVE 2011-2016

- 1 Deri në fund të vitit 2016 të gjitha udhëzimet administrative për zhvillimin profesional të mësimdhënësve janë harmonizuar me rregullativën ligjore në fuqi dhe zbatuar
- 2 Deri në fund të vitit 2016 të paktën 80 % përqind e përfaqësuesve të MASHT, DKA dhe drejtorëve të shkollave janë trajnuar në programe të akredituara për udhëheqje dhe menaxhim dhe është përmirësuar barazia gjinore
- 3 Deri në fund të vitit 2014 janë ndërtuar kapacitetet për vlerësimin e nevojave të zhvillimit profesional të mësimdhënësve
- 4 Deri në fund të vitit 2014 është ndërtuar sistemi për futjen e të dhënave për trajnime
- 5 Deri në vitin 2016 do të akrediton të paktën 40 programe për zhvillim profesional të bazuar në nevojat e mësimdhënësve
- 6 Deri në fund të vitit 2016, MASHT në bashkëpunim me AKK certifikon dhe licencon trajnerët e programeve të ZHPM
- 7 Deri në fund të 2016, 90 % e mësimdhënësve ka ripërtrirë licencën, ndërsa 5-10% janë promovuar në një nivel më të lartë dhe duke respektuar barazinë gjinore
- 8 Deri në fund të vitit 2016 janë krijuar mekanizmat për zhvillimin me bazë në shkollë për të siguruar qëndrueshmëri të trajnimeve brenda shkollave
- 9 Deri në fund të vitit 2016 funksionojnë mekanizmat për monitorim dhe vlerësim të programeve të trajnimit dhe të ndikimit të tyre
- 10 Deri në fund të vitit 2016, të paktën 15% e zyrtarëve të arsimit dhe mësimdhënësve marrin pjesë në programe të përbashkëta rajonale dhe ndërkombëtare të ZHPM
- 11 Deri në fund të vitit 2013, të nxënit nga arsimi joformal dhe aftësimi në shërbim njihet nga fakultetet arsimore me rastin e kualifikimit/rikualifikimit të mësimdhënësve

- 12 Deri në fund të vitit 2016, të gjitha programet e fakulteteve arsimore janë tëharmonizuara me politikat arsimore të MASHT, si dhe 80% e personelit të këtyre fakulteteve janë aftësuar në programe të ZHPM
- 13 Deri në fund të vitit 2016 janë rritur mundësitë për zhvillimin e kërkimeve shkencore në fakultetet arsimore

Megjithë progresin e arritur, shkalla e realizimit të PSAK ZHPM 2011-2016 është e ulët në krahasim me caqet dhe aktivitetet fillestare - Progresi më i madh vërehet në hartimin dhe përditësimin e legjislacionit të zhvillimit profesional të mësimeve dhe harmonizim të programeve të kualifikimit para-shërbimit me Kornizën e Kurrikulës. Elemente kyçe të këtij nën-programi mbulohen nga udhëzime administrative mirëpo mungojnë mekanizma të qëndrueshëm për zbatim të legjislacionit. Progres i ndjeshëm vërehet edhe në avancim të kualifikimeve të mësimeve.

Figura 23: Shkalla e zbatimit të PSAK Zhvillimi profesional i mësimeve 2011-2016




Është zhvilluar praktika e akreditimit të programeve të zhvillimit profesional mirëpo burimet materiale dhe njerëzore janë të kufizuara. Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë edhe në licencim të mësimeve dhe zhvillim të kapaciteteve menaxhuese. Është rishikuar baza ligjore për licencim të mësimeve dhe është realizuar licencimi përmes modalitetit të përkohshëm të mësimeve mirëpo ende mungon praktika e vlerësimit të performancës dhe promovimit të bazuar në kritere të licencimit. Nuk ekziston një praktikë koherente e vlerësimit të nevojave të mësimeve anipse në nivele komunale janë bërë disa hapa në hartim të planeve për zhvillim profesional të mësimeve. Gjithashtu, me përjashtim në disa raste të izoluara, nuk ekziston praktika e mirë e vlerësimit të ndikimit të trajnimeve në mësime.

Në përgjithësi kapaciteti për politikë-bërje në zhvillim profesional të mësimdhënësve është i kufizuar në mungesë të një sistemi koherent të mbledhje së të dhënave - Evidenca rreth kuadrit mësimor është mjaft e fragmentuar në databaza të ndryshme si në SMIA në lidhje me numrin e mësimdhënësve, databazën e licencimit të mësimdhënësve në lidhje me trajnimet. Sidoqoftë, mungon kapaciteti institucional dhe burimet njerëzore për mbledhje të centralizuara, monitorim dhe vlerësim të mësimdhënësve. Gjatë procesi të vlerësimit është konkluduar edhe mungesa e një kornize strategjike të treguesve në lidhje me mësimdhënësit dhe është hasur në vështirë të mëdha në gjetjen dhe analizën e të dhënave. Të dhënat statitike janë të disponueshme mirëpo të shpërndara ndërsa të dhënat dinamike mbi cilësinë, performancën dhe korrelacionin me arritshmërinë e nxënëve është vështirë të gjenden. Nuk ekziston praktikë e studimit dhe monitorimit të treguesve cilësor.

Aktivitetet e ZHPM janë në shpërputhje me objektivat apo nganjeherë janë me peshë të vogël për të ndikuar në lëvizje të trendeve - PSAK 2011-2016 rreth zhvillimit profesional (ZHPM) është befasisht i varfër. Objektivat janë shpesh të pasqaruara dhe në disa raste janë mikro aktivitetet rreth trajnimit dhe jo qëllime strategjike. Objektivat nuk ishin në kongruencë me qëllimet dhe pesha e aktiviteteve të parapara është shpesh e vogël për arritje të synime. Në përgjithësi, plani i ardhshëm duhet të vendos një objektivë dhe aktivitete adekuata rreth zhvillimit të mësimdhënësve para shërbimit, një objektivë të zhvillimit të mësimdhënësve gjatë shërbimit duke përfshirë edhe mentorimin, një objektivë në lidhje me kushtet e punës dhe rekrutimit, një objektivë në lidhje me menaxhimin e cilësisë në mësimdhënie duke përfshirë raportet nxënë-mësimdhënës, normativit dhe vlerësimit të performancës, një objektivë në lidhje me mundësitë e barabarta (aspektet gjinore, etnike dhe moshës) dhe një në lidhje me menaxhimin e sistemit të zhvillimit të burimeve njerëzore në mësimdhënie (zhvillimi i politikave, vlerësimi i jashtëm, mbledhja e të dhënave dhe vlerësimi i nevojave).

Është përmirësuar barazia gjinore në kuadrin mësimdhënës duke arritur baraspeshë ndërmjet meshkujve dhe femrave mësimdhënës mirëpo mësimdhënëset femra dominojnë në nivele të ulëta të shkollimit ndërsa meshkujt mësimdhënës në nivele të larta - Kuadri mësimdhënës në Kosovë ndërmjet 2010/2011 dhe 2014/2015 pothuajse është i njëjtë për nga numri. Sidoqoftë, zëvendësimet dhe pensionimi i vazhdueshëm ka shërbyer për të arritur barazi gjinore.

Figura 24: Numri i mesimdhenesve sipas gjinise 2008-2014



Bilanci gjinor i fuqisë punëtore ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshem gjat viteve të fundit. Numri i femrave mësimdhënësve është rritur për rreth 2000 krahasuar me vitin 2008 (SMIA, 2015). Megjatë, analizat më të detajuara tregojnë që shkalla e angazhimit të gjinisë femrore është pothuajse totale në edukim parashkollor dhe dominon në nivelin fillor. Bilanci luhetet në favor të mësimdhënësve meshkuj në nivelet më të larta si ai i arsimit të meëm të ulët dhe meëm të lartë.

Tabela 11: Kuadri i mësimdhënësve sipas gjinisë (SMIA, 2014/2015)				
	ISCED 0 (parashkollor)	ISCED (1-2) fillor dhe mesem ulët	ISCED 3 mesem lartë	Toal
Meshkuj	0.3%	53.4%	61.2%	49.8%
Femra	99.7%	46.6%	38.8%	50.2%

Pjesëmarrje tejet e lartë e mësimdhënësve të shtyer në moshë (mbi 50 vjeç) në kuadrin mësimdhënës - Të dhënat mbi moshën e mësimdhënësve shfaqin një tendencë të plakjes së fuqisë punëtore. Rreth 41 % e mësimdhënësve janë më të vjetër se 50 vjeç dhe Kosova është ndër vendet Evropiane me përqindjen më të lartë të mësimdhënësve mbi 50 vjeç (Eurostat 2012/SMIA 2015). Struktura e moshës sjell në sipërfaqe edhe një prezencë të lartë të mësimdhënësve në moshë të re nën 30 vjeç (14%) – dukshëm më e lartë se mesatarja e BE (28). Mbi bazën e këtyre të dhënave në disa raste mund të aludohet që kuadri mësimdhënës ka përbërje të pazakonshme strukturore. Shkalla e lartë e mësimdhënësve të shtyer në moshë nënkupton që në vitet në vazhdim pritet trend i ngjeshur i pensionimit (rreth 500 për cdo vit) dhe aktivitet i ngjeshur i rekrutimit.

Shkalla e lartë e mësimdhënësve me moshë të shtyer në disa raste interpretohet edhe si pengesë sidomos në procesin e reformimit të rutinave të mësimdhënies, qasjes didaktike dhe zbatimit të kurrikulave të reja. Mundësia e përrirjes së fuqisë punëtore nuk është domosdoshmërisht aspekt pozitiv meqë shumica e këtij kuadri buron nga shkollat e mëparshme të larta pedagogjike dhe me përvje me të madhe. Rekrutimi i fuqisë së re punëtore mund të ketë impakt pozitiv vetëm nëse përfshin 10 % e studentëve më të mirë dhe standard të jashtëm të filtrimit në formë të testit kombëtar për profesionin.

Progres i ndjeshëm në avancim të kualifikimeve të mësimdhënësve mirëpo shkalla e mësimdhënësve me të pakualifikuar dhe të kualifikuar por në lëndë jopërkatese është rreth 42 % përqind. Rritja e pagave në mënyrë lineare dhe duke anashkaluar sistemin e vlerësimit të performancës dhe promovimit në karrierë mund të ndikoj negativisht në motivim të kuadrit-në bazë të të dhënave të prezentuara në grafik vërehet një ulje e ndjeshme e përqindjes së mësimdhënësve me shkollim të mesëm dhe shkollë të lartë profesionale nga rreth 56 % përqind në vitin 2010/2011 në rreth 32 % përqind. Në të njëjtën kohë është shtuar numri i mësimdhënësve me kualifikim universitar.

Sidoqoftë avancimi në kualifikime jo-domosdoshmërisht adreson përshtatshmërinë e mësimdhënësve me lëndët në kurrikulën e re. Rreth 42 përqind e mësimdhënësve kanë ose kualifikime universitare jo-përkatese ose kualifikime të niveleve më të ulëta se sa përcaktimi në normativin e mësimdhënësve. Në bazë të mostrës prej rreth 80 % përqind të numrit të mësimdhënësve (SMIA, 2015) vërehet se shkalla më e madhe e mësimdhënësve pa kualifikime adekuate është në komunat Suharekë, Klinë, Skenderaj, Rahovec, Prizren, Mitrovicë (rreth 50%). Gjendje më e mirë vërehet në komunat Prishtinë, Fushë Kosovë, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Gjakovë dhe Pejë. Të dhënat e prezentuara nuk janë të tërësishme mirëpo në bazë të mostrës së nxjerrur nga SMIA (2015) mirëpo mostra është shumë e lartë për të nxjerrur disa konkludime bazë. Ekipi i

vlerësimi nuk arriti ti siguroj të dhënat e arritshmërisë së nxënësve për të analizuar nëse ka ndonjë korrelacion me arritshmërinë e nxënësve në komuna.

Figura 25: Kualifikimet e mesimdhënësve 2010/2011-2014/2015






Figura 26: Shkalla e mësimeve të (pa) kualifikuar në komuna (SMIA, 2015)



Përmirësim i ndjeshëm i kushteve të punës së mësimeve të (pa) kualifikuar - Pagesat e mësimeve të (pa) kualifikuar janë nominalisht të ulëta në të gjithë vendet e Evropës Jug-lindore. Sidoqoftë,

.....

pagea e mësimdhënësve në Kosovë është ndër më të lartat në rajon. Ekzistojnë dy lloj treguesish për të monitoruar kushtet e pagesës dhe punës për mësimdhënës – rroga e mësimdhënësve në raport me rrogën mesatare dhe të hyrat vjetore të mësimdhënësve në raport me BPV (GDP) për kokë. Të hyrat e mësimdhënësve në Kosovë pothuajse janë dyfishuar gjatë 2010-2015. Të hyrat mesatare të mësimdhënësve janë rreth 10 % përqind më të larta se rroga mesatare. Ndërsa të hyrat mesatare vjetore të mësimdhënësve janë rreth 145 % përqind mbi të ardhurat mesatare për kokë banori (për capita). Rritja e rroga ka krijuar parakushte për tërheqje të një kuadri më të kualifikuar dhe ka krijuar parakushte për zbatim të mekanizmave për përzgjedhje. Përmirësimi i imazhit të profesionit dhe kushteve të punës evidentohet edhe nga interesimi në rritje i studentëve për të aplikuar në programet e kualifikimit të mësimdhënësve. Në anën tjetër, ngarkesa dhe norma e mësimdhënies në Kosovë rreth 20 orë në javë dhe është dukshëm më e ulët sesa në vendet e avancuara Evropiane (ndërmjet 25-40 orë).



7.1.Legjislacioni i zhvillimit profesional të mësimdhënësve

MASHT ka miratuar Udhëzimin Administrativ (UA 09/2014) për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ ishte përcaktimi i normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm në edukim parashkollor, parfillor, fillor dhe të mesëm. Përmes këtij instrumenti ligjor, institucionet shkollore dhe mësimdhënësit që nuk plotësojnë parakushtet e kualifikimeve të përcaktuara dhe që janë më të rinj se 51 vjec, obligohen që të vazhdojnë avancimin profesional pa shkëputje nga puna. Zhvillimi profesional realizohet në programet dhe profilet e përcaktuara nga MASHT si dhe programet e akredituara të zhvillimit profesional. Gjatë kësaj periudhe është miratuar edhe Udhëzimi Administrativ (UA 25/2014) për licencimin e mësimdhënësve me qëllim që të krijoj një sistem koherent të licencimit të bazuar në kualifikime, përvojës, zhvillimit profesional dhe performancës. Udhëzimi i ri administrativ definon llojet e licencave dhe kriteret e licencimit.

MASHT poashtu ka miratuar dy udhëzime të rëndësishme mbi vlerësimin e performancës dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Udhëzimi Administrativ (UA 14/2013) mbi vlerësimin e performancës përcakton standardet e performancës, bartësit e procesit të vlerësimit dhe instrumentet e vlerësimit të performancës. Udhëzimi administrativ (UA 16/2013) përcakton modalitetet e zbatimit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe rregullon rolin e MASHT dhe komunave në proces. Ndërsa Udhëzimi Administrativ (UA 15/2013) rregullon financimin e

zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Përmes këtij instrumenti MASHT ruan një pjesë të buxhetit për zhvillim profesional të mësimdhënësve por edhe përkushtohet që të delogoj atë tek komunat në rastet kur ato kanë planet dhe projektet e zhvillimit profesional dhe të bazuara në institucione të akredituara.

7.2.Kapaciteti për menaxhim

Objekti parashihet që deri në fund të vitit 2016, të paktën 80% e përfaqësuesve të MASHT, inspektorët, zyrtarët e DKA dhe drejtorët e shkollave janë trajnuar në programe të akredituara për udhëheqje arsimore dhe menaxhim dhe është përmirësuar barazia gjinore. Në kuadër të caktuar janë paraprë një seri e aktiviteteve duke përfshirë: mbajtje të takimeve të rregullta në mes MASHT, DKA, Shkollave dhe komuniteti, përgatitja dhe akreditimi i programit për udhëheqje arsimore duke marrë parasysh barazinë gjinore, organizim të trajnimeve për udhëheqje dhe menaxhim për stafin e MASHT, DKA dhe drejtorët e shkollave duke marrë në konsideratë barazinë gjinore.

Në bazë të dhënave të gjeneruara nga MASHT (2015), janë trajnuar rreth 22 % përqind e zyrtarëve të MASHT, inspektorëve, zyrtarëve të DKA dhe drejtorëve të shkollave në kuadër të trajnimit 'Udhëheqje arsimore'. Në kuadër të një trajnimi tjetër vetëm për Drejtor Shkolle janë trajnuar rreth 402 apo 35% e drejtorëve. Një numër më i madh i drejtorëve dhe anëtarëve të Këshillave Shkollor janë trajnuar në trajnimin për Këshilla Drejtues me 822 pjesëmarrës gjatë 2011-2015 apo 70 % përqind.

Tabela 12:Trajnimet për ngritje të kapacitetit menaxhues

Nr	Trajnimi	2011	2012	2013	2014	2015	Total
1	Udhëheqje arsimore						
	Numri	100	200	100	150	-	550
	% e total	4%	8%	4%	6%	-	22%
4.	Trajnimi për drejtor shkolle						
	Numri	-	-	157	245	-	402
	% e total	-	-	14%	21%	-	35%
5.	Trajnimi për Këshilla Drejtues						
	Numri	17	258	263	284		822
	% e total	1.6%	22%	23%	24%		70%

Burimi / sqarim

- ☐ Të dhënat e trajnimit janë marrë nga Databaza e trajnimit, MASHT 2015
- ☐ Numri bazë i kuadrit të përfshirë në kuadër të caktuar është si në vijim: Zyrtar të MASHT (190), Zyrtar të DKA (320), Inspektor (63), Udhëheqës shkolle (1150)

Nuk ka të dhëna në lidhje me shkallën e përfshirjes së femrave në trajnim anipse në bazë të analizave të dokumenteve vërehet një kujdes i vecantë në pjesëmarrje të femrës dhe komuniteteve. Nga rezultatet e përpunuara kuptohet që me gjithë aktivitetin e ngjeshur trajnues nuk është arritur synimi për trajnim të 80 % të zyrtarëve. Shkalla e të trajnuarve në raport me numrin total të zyrtarëve është rreth 50 % përqind. Në linjë me këtë aktivitet janë organizuar edhe Trajnimet e Programit Talk On ku gjatë vitit 2015 janë trajnuar 40 zyrtar të MASHT dhe DKA. MASHT në përgjithësi ka organizuar takime të rregullta me zyrtar komunal dhe sidomos në korniza të zbatimit të kurrikulës së re. Gjithashtu, në vitin 2013 është hartuar dhe riakredituar Trajnimi për Udhëheqje Arsimore. Programi i trajnimeve ka qenë i mbështetur kryesisht nga

.....

USAID, GIZ dhe BE dhe mbetet sfidë sigurimi i vazhdimësisë së trajnimeve dhe menaxhimi i njohurisë.

7.3.Vlerësimi i nevojave për trajnime

Si pjesë e synimit të vlerësimit të nevojave për trajnim të mësimdhënësve ishte paraparë që deri në fund të vitit 2014 janë ndërtuar kapacitetet për vlerësimi të nevojave për zhvillim profesional. Për të arritur këtë objektivi ishte paraparë që të hartohen procedurat dhe kriteret për vlerësim të nevojave për zhvillim profesional dhe që të angazhohet një agjenci për vlerësim të nevojave dhe ndërtim të kapaciteteve për vlerësim. Gjatë analizës së rezultateve në arritjen e këtij caku nuk është vërejtur ndonjë përparim për të ndërtuar një sistem të tillë. Vlerësimi i nevojave për trajnim është pjesë esenciale në planifikimin e zhvillimit të burimeve njerëzore në kuadrin mësimdhënës. Një ngecje e tillë mund të rezultoj edhe nga mungesa e një qasje holistike dhe afat-gjatë e zhvillimit të mësimdhënësve.

Ekipi i vlerësimit ka hasur në disa vështirësi në mbledhjen edhe të dhënave bazë për mësimdhënësit. Inicimi të programeve të trajnimeve do të duhej ti parprij një vlerësim i nevojave për trajnim apo boshllëqeve që ekzistojnë në kuadrin mësimdhënës. Këto procese realizohen në konsultim me mësimdhënësit, drejtorët, shkollat dhe palët tjera të interesit. Sidoqoftë, nuk ka evidencë për ndonjë studim paraprak cilësor apo sasior rreth kësaj çështje. Në kushte optimale Divizioni për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve do të duhej të kishte një mekanizëm periodik i cili definon nevojat e përgjithëshme, komunale, shkollore dhe individuale. Ky proces konsultativ mund të realizohet përmes një ankete me moster të përzgjedhur në rast se ka vështirësi në konsultime me të gjera. Në anën tjetër, komunat dhe shkollat kanë rol kyc në vlerësim të nevojave mirëpo nuk ka ndonjë mekanizëm që bën përmbledhjen e këtyre inputeve në proces të vlerësimit të nevojave për trajnim (TNA). Në mungesë të praktikës apo burimeve njerëzore Divizioni do të duhej angazhuar apo nën-kontraktuar organizata të specializuara në këtë drejtim. Nuk ka ndonjë evidencë që kjo të jetë realizuar gjatë këtij cikli të zbatimit të planit.

Gjatë intervistave me palët e interesuara ekipi është informuar në lidhje me disa iniciativa për vlerësim të këtyre nevojave dhe studimeve të realizuara nga GIZ, USAID dhe Instituti Pedagogji. Ekipi i vlerësimit ka hasur në disa dokumente që trajtojnë vlerësimin e ndikimit të trajnimit ex post të realizuara nga IPK dhe GIZ. Sidoqoftë, vlerësimi i nevojave për trajnime bëhet ex ante. Në kuadër të aktiviteteve parashihet angazhimi i një Agjencie për vlerësim të nevojave për kapacitete dhe vlerësim. Mirëpo ky aktivitet nuk është kompletuar. Ekipi i vlerëson se ka vështirësi në të kuptuarit e procesit të planifikimit dhe ndërtimit të burimeve njerëzore në sistemin arsimor. Korniza e akterëve të angazhuar në proces është e fragmentuar dhe e orientuar në projekte të mbështetura nga donatorët. Është domosdoshme që të ndërtohet kapaciteti dhe praktika në kuadër të MASHT për një proces të tillë. Gjithashtu, praktika e kordinimit të palëve të interesit (komunave, shkollave, mësimdhënësve, sindikatave, fakulteteve) rreth këtyre prioriteve është e kufizuar. Trajnimi në formën e punëtorive është pothuajse modaiteti i vetëm dhe nuk ka evidencë nëse është vlerësuar përshtatshmëria e procesve tjera si trajnimit në vend të punës dhe mentorimi.

7.4.Databaza e trajnimeve

Synimi për ndërtim të databazës së trajnimeve parasheh që ky sistem softuerik të jetë në funksion deri në vitin 2014. Në korniza të këtij synimi janë indkuadruar dis aktivitete: krijohet programi softuerik për programet e trajnimit dhe mësimdhënësit e trajnuar, hartohen procedurat për futjen e të dhënave për trajnime, aftësohen personat përgjegjës për futjen e të dhënave. Baza për futjen e të dhënave për programet e trajnimit dhe për mësimdhënësit e trajnuar është ndërtuar në aspektin teknik mirëpo nuk mund të konkludohet që ajo është funksionale. Gjatë procesit të vlerësimit Ekipi ka hasur në vështirësi për të mbledhur të dhëna bazë. Anipse në kuadër të këtij

.....

procesi janë trajnuar 7 bartës/inspektor rajonal për popullimin e të dhënave të trajnimit dhe një zyrtar nga MASHT, ka ende vështirësi në qasjen dhe përpunimin e tyre për qëllime të të evidencës në vendimarrje.

Të dhënat e kërkuara për trajnimet dhe programet ishte dashur të kalkuloheshin manualisht. Gjatë diskutimeve me palët e interesuara në proces, ishte pohuar që vështirësitë për qasje dhe përdorim të të dhënave mund të rezultojnë qoftë për shkak të mungesës së një sistemi për futjen e të dhënave apo për shkak të kompleksiteteve teknike. Sidoqoftë, ndërtimi i databazës për futjen dhe regjistrimin e të dhënave ishte paraparë si mekanizëm esencial në procesin e licencimit dhe vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. Ekipi i vlerësimit supozon që rëndësia dhe përqëndrimi në mbledhjen dhe gjenerimin e raporteve kolektive apo individuale mund të jetëzbehur si rezultat i mungesës së hapave institucional për zbatim të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe gradimit.

7.5.Akreditimi i programeve për ZHPM

Caku parasheh realizimin e një varg aktiviteteve që ndërlidhen me hartimin dhe zbatimin e trajnimeve mbi kornizën e re, trajnime pedagogjike, lëndore dhe ato që ndërlidhen me teknologjinë informative dhe arsimin profesional. Gjithashtu, caku synon jetësimin e procesit të akreditimit të programeve të shkurtëra të trajnimit dhe publikimin e katalogut të trajnimeve. Në këtë kuadër parashihet edhe inkurajimi i institucioneve të arsimit të lartë për të ofruar programe tranuese për mësimdhënësit në shërbim. Në bazë të analizës së të dhënave të prezentuara rezulton që është bërë progres i konsiderueshëm në akreditimin e programeve të tranimit, ofrimit të tranimit për profile jo-arsimore dhe publikimit të katalogut të trajnimeve. Sidoqoftë, të dhënat e katalogut të fundit nuk janë të përditësuara megjithatë sipas planeve të MASHT katalogu i ri do të publikohet në fund të vitit 2015. Në anën tjetër, oferta e kurseve të trajnimit nga institucionet publike të edukimit është ende e kufizuar.

Tabela 13:Numri i programeve të akredituara

1	Numri i programeve të akredituara	147
2	Numri i programeve jo-arsimore	23
3	Numri i programeve në katalog	87
4	Numri i programeve të trajnimit nga IAL	10

Një numër i madh i trajnimeve ishin të karakterit lëndor, pedagogjik dhe metodik (shih Tabelen e trajnimeve në aneks). Gjithashtu, janë trajnuar rreth 810 mësimdhënës të arsimit profesional mbi metodat e mësimdhënies dhe rreth 300 mësimdhënës të shkollave pilote që zbatojnë kurrikulën e re.

Siteti për regjistrim të trajnimeve të mësimdhënësve ende nuk arrin të regjistroj të gjitha të dhënat në databazë për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe në disa raste edhe paqartësive që ekzistojnë në lidhje me kriteret e raportimit të të dhënave.

7.6.Certifikimi i trajnerëve

Synimi i planit në kuadër të këtij caku ishte realizimi i disa aktiviteteve: organizimi i trajnimeve për trajner për programe të ndryshme të trajnimit dhe organizimi i trajnimeve për trajner për komunitete të ndryshme. Në bazë të rrjedhës së aktiviteteve të raportuara nga MASHT janë organizuar trajnimet për trajner dhe certifikuar një numër i madh i trajnerëve sipas metodologjisë TOT (Trajnimi për trajner). Zbatimi i këtij aktiviteti është bërë në suaza të Udhëzimit Administrativ(4/2010) ku krahas akreditimit të programeve të trajnimit duhet të

certifikohen edhe trajnerët e programeve. Certifikimi dhe trajnimi është realizur me ndihmën e GIZ, USAID dhe Komisionit Evropian (Projekti i Binjakëzimit). Në kuadër të përpjekjeve për zbatim të kurrikulës së re janë trajnuar edhe 1317 fasilitator si pjesë e realizimit të projektit BEP/USAID. Nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e trajnerëve të komuniteteve jo-shumicë.

7.7.Licencimi dhe promovimi i mësimdhënësve

Licencimi dhe gradimi i mësimdhënësve është kryesisht i kushtëzuar nga zhvillimi i një sistemi të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. Sipas praktikave të mira Evropiane vlerësimi mund të bëhet qoftë individualisht qoftë si komponentë e vlerësimit të jashtëm të shkollave. Proceset vlerësimit të performancës marrin në konsideratë elemente të ndryshme të performancës duke përfshirë arritshmërinë e nxënësve, performancën e shkollës, nivelin e kualifikimeve dhe performancën gjatë shërbimit. Ekzistojnë praktika të ndryshme të zbatimit të vlerësimit dhe ato variojnë në vende të ndryshme Evropiane - bordi i shkollës (Holandë), drejtori i shkollës (Slloveni), sistemi kaskadë ku drejtori komunal vlerëson drejtorin e shkollës, drejtori i shkollës mësimdhënësit senior dhe mësimdhënësit senior kuadrin më të ri (Sllovakia).

Në Kosovë është zhvilluar baza ligjore për licencimin, promovimin dhe vlerësim të performancës së mësimdhënësve mirëpo nuk është zbatuar në mungesë të kapaciteteve, praktikës dhe kufizimeve financiare - MASHT ka nxjerrur një Udhëzim Administrativ për Licencimin e Mësimdhënësve në vitin 2010 mirëpo ai është reformuar përmes Udhëzimit të ri (25/2014) i cili garanton një sistem më koherent të licencimit dhe promovimit të bazuar në kualifikim, përvojë, performancë dhe zhvillim profesional. Megjithatë, sistemi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve nuk është zbatuar ende. Skema e pagave është lineare dhe e bazuar kryesisht në arritje para shërbimit (kualifikimet) dhe përvoja e punës. Arsyetimi më i shpeshtë për mos zbatim të sistemit ka qenë mungesa e burimeve financiare mirëpo shpenzimet në paga të mësimdhënësve pothuajse janë dyfishuar gjatë këtij cikli të planit dhe ato nuk janë bazuar në kriteret e performancës në shërbim. Sistemi aktual mundëson një licencë të përkohëshme dhe mësimdhënësit janë të obliguar të ndjekin një numër prej 120 orëve trajnim për të përtrirë licencën apo avancuar kualifikimet në rastet kur ato janë nën kërkesat minimale. Deri në përfundim të vitit 2015, KLM ka licencuar rreth 22,000 mësimdhënës me licencë të rregullta. Kanë ekzistuar iniciativa për të zbatuar një gradim pa kosto financiare mirëpo edhe këto kanë qenë të kufizuara nga mungesa e një sqasje sistematike për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe kapacitetit për të zbatuar praktikën e vlerësimit.

Si pjesë e këtij caku ka qenë edhe organizimi i së paku 30 orë në vit për mësimdhënës në aspekte të ndryshme lëndore, pedagogjike, metodike dhe njohuri tjera. Kalkulimi i orëve të realizuar përmes të dhënave të ofruara nga MASHT (2015) rezulton që mesatarisht rreth gjysma (50%) e mësimdhënësve janë përfshirë në trajnime të ndryshme mbi kurrikulën e re, teknologjinë informative, vlerësimin e nxënies, metodikën e mësimdhënies dhe trajnime lëndore (Shiko Tabelën në Aneks). Nga kjo rezulton që megjithë progresin e arritur në ofrimin e trajnimeve, ende nuk është arritur caku për përfshirje të të gjithë mësimdhënësve në minimum 30 orë trajnimi në vit.

Tabela 14: Përfshirja e mësimdhënësve në trajnime shprehur në orë dhe % (2011-2015). Burimi: MASHT 2015

	2011	2012	2013	2014	2015
Numri mësimdhënësve	9486	13777	12381	12696	9173
% total mësimdhënës	41%	58%	53%	54%	39%
Orë trajnimi mesat.	26	33	19	36	29
Orë të planifikuara	60	60	120	120	120

7.8. Zhvillimi profesional i bazuar në shkollë

Në shumicën e sistemeve Evropiane të arsimit, planet për zhvillim të vazhdueshëm profesional përgatiten në nivel të shkollave dhe ato shpesh janë të detyrueshme. Megjithatë, autoritetet e nivelit qendror vendosin tema dhe aktivitete prioritare. Për më tepër, autoritetet qendrore edhe përcaktojnë se çfarë trajnime shtesë duhet ti nënshtrohen mësimdhënësve në mënyrë që të kualifikohen për ndonjë një pozitë më të lartë. Në disa sisteme tjera kërkohet që mësimdhënësve të kenë edhe plane individuale të zhvillimit profesional. Mirëpo, praktika më e aplikuar është qëshkolla të ketë plan të zhvillimit profesional të mësimdhënësve ndërsa niveli qendror dhe komunal kanë aktivitete mbështetëse dhe sigurimi të cilësisë. Aktivitetet si kualifikimet apo trajnimet e ofruara i nënshtrohen qoftë procesit të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë apo akreditimit të trajnimeve. Inspektoratet e arsimit në shumë raste japin rekomandime se ku duhet të përqëndrohen shkollat. Forma më e zakonshme e financimit të zhvillimit profesional është në formën e fondeve shtesë për shkollat ndërsa në disa vende tjera shkollat vendosin sipas nevojës, rrethanave dhe planeve zhvillimore.

Në Kosovë gjatë ciklit të zbatimit të këtij plani programet e zhvillimit profesional në formën e avancimit të kualifikimeve apo trajnimit të mësimdhënësve janë organizuar dhe mbështetur nga niveli qendror (MASHT) me mbështetje të partnerëve zhvillimor dhe organizatave të specializuara. Një praktikë e tillë mund të ketë qenë e kushtezuar dhe nga mungesa e kapacitetit të shkollës për të planifikuar dhe administruar buxhetin, mungesa e bordeve të shkollave apo prioritizimi i aspekteve tjera në sistemin arsimor. Komunitetet përgjithësisht nuk alokojnë buxhet për zhvillim profesional të mësimdhënësve. Sidoqoftë, në vitin 2013 dhe 2014 janë rishikuar dy udhëzime administrative: udhëzimi administrativ (16/2013) mbi sistemin e zhvillimit profesional dhe udhëzimi administrativ (15/2013) për financimin e zhvillimit profesional. Në bazë të dispozitave ligjore, MASHT përkushtohet që të delegoj fondet për zhvillim profesional të komunave me kushtin që ato të jenë në gjendje të ofrojnë plane zhvillimore komunale dhe që ofertuesit e përzgjedhur për zbatim të jenë të akredituar nga niveli qendror. Planet komunal do të bazoheshin në planet individuale të shkollave.

Një pjesë e komunave kanë realizuar planet e tyre të zhvillimit e ku zhvillimi profesional i mësimdhënësve është një nga elementet kyce me ndihmen e GIZ. Organizata poashtu ka mbështetur komunat dhe shkollat përmes doracakëve dhe trajnimet për hartim të planeve zhvillimore. USAID ka mbështetur disa komuna dhe shkolla në përpilimin e planeve shkollore për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe ka ndihmuar në trajnimin e aktivave profesionale. Gjatë periudhës së këtij plani rreth 66% përqind e komunave kanë realizuar planet e tyre zhvillimore dhe rreth 24% e shkollave. Planet e zhvillimit të mësimdhënësve janë pjesë integrale. Mirëpo në rreth 22 raste shkollat poashtu kanë krijuar edhe plane specifike për zhvillim profesional. Deri më tani, sistemi për delegim të financimit për zhvillim profesional tek komuna ende nuk është realizuar aq më pak delegimi i këtyre përgjegjësisë në shkolla.

Tabela 15: Numri i planeve zhvillimore në komuna dhe shkolla 2011-2015

	2011	2012	2013	2014	2015	Total
Plane komunale	-	-	10	12	-	22
%	0%	0%	30%	36%		66%
Plane shkollore	-	-	149	126	-	275
%			13%	11%		24%

Mirëpo si pjesë e planeve për zbatim të kurrikulës së re janë bërë hapa të rëndësishëm në trajnimin

.....

e rreth 100 kordinatorëve me bazë në shkollë, rreth 720 fasilitator dhe rreth 1150 aktiva profesionale. Kjo strukturë duhet të jetë pjesë esenciale e sistemit për zhvillim me bazë në shkollë jo vetëm për zbatim të kurrikulës së re mirëpo i të gjithë sistemit të zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Në përgjithësi caku dhe aktivitetet janë realizuar në shkallën 50 % përqind. Disa nga mekanizmat e nevojshëm janë krijuar mirëpo ende nuk ka hapa vendimtar në financim të shtuar për ti bërë ato më të qëndrueshme.

7.9. Monitorimi/vlerësimi i trajnimeve

Në kuadër të këtij synimi parashihej zbatimi i disa aktiviteteve: përcaktimi i përgjegjësive për monitorim të trajnimeve në nivel të MASHT, DKA dhe shkollave, krijimin e mekanizmave për monitorim dhe vlerësim të programeve të ZHPM, hartim të planit dhe instrumenteve për vlerësim, organizim të rregullt të procesit të monitorimit dhe vlerësimit, hartim të raportit të vlerësimit së bashku me rekomandime dhe ndërtim të kapaciteteve të ekipeve të specializuara për të mbikqyrur, mentoruar dhe këshilluar mësimdhënësit pas vijimit të programeve të aftësisë.

Gjatë intervistave me palët e interesuara ekipi është informuar në lidhje me disa iniciativa për vlerësim ndikimit të trajnimeve të të realizuara nga GIZ në lidhje me trajnimete mbështetura në disa komuna, USAID. Një shembull i mirë i vlerësimit të ndikimit të trajnimeve është aktiviteti i Instituti Pedagogjik (IPK) në lidhje me trajnimet mbi kurrikulën e re. Një qasje e tillë duhet të zgjerohet dhe sistematizohet në të gjitha proceset e trajnimit. Sidoqoftë, Ekipi i vlerëson se ka vështirësi në të kuptuarit e procesit dhe rëndësisë së monitorimit dhe vlerësimit të ndikimit të trajnimeve. Aktivitetet e vlerësimit dhe monitorimit të ndikimit të trajnimeve janë kryesisht iniciativa të organizatave që mbështesin ato trajnime. Nuk ekziston ndonjë sistem koherent, i instrumenteve dhe kapacitete për të bërë një vlerësim dhe monitorim të rregullt të ndikimit të trajnimeve. Në kuadër të aktiviteteve parashihet që MASHT në bashkëpunim me komunat të nxjerrin një raport vjetor në lidhje me këtë proces mirëpo ky aktivitet nuk është zbatuar rregullisht. Është domosdoshme që të ndërtohet kapaciteti dhe praktika në kuadër të MASHT për një proces të tillë. Gjithashtu, praktika e kordinimit të palëve të interesit (komunave, shkollave, mësimdhënësve, sindikatave, fakulteteve) rreth këtyre prioriteve është e kufizuar.

7.10. Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare

Objekti synonte të mbështeste mobilitetin e stafit mësimdhënës në kuadër të iniciativave dhe aktiviteteve rajonale dhe ndërkombëtare. Sidoqoftë, një objektivë e tillë mund të vlerësohet si e avancuar për stadin e zhvillimit të sistemit në përgjithësi. Gjatë procesit të zbatimit të planit janë organizuar disa takime rajonale në projekte të ndryshme kryesisht në Shqipëri, Maqedni, Sllovenia, Serbi dhe Turqi. Vlerësohet e rreth 950 mësimdhënës kanë marrë pjesë në ndonjë aktivitet. Mirëpo shkalla e pjesëmarrjes prej rreth 4 % përqind të mësimdhënësve është larg caktit të synuar prej 15 % përqind. Një pjesëmarrje më e mirë dhe ekspozim ndaj përvojave ndërkombëtare vërehet tek zyrtarët e MASHT (rreth 28 %). Ka patur disa vizita studimore relevante në shumë vende me sisteme të avancuara të shkollimit. Ekipi vlerëson se në të ardhmën duhet shqyrtuar një mekanizëm i qëndrueshëm për mobilitet, shkëmbim të stafit dhe avancim të kualifikimeve me vende rajonale si Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi dhe me vende tjera të BE-së si Sllovenia, Letonia, Bullgaria. Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira rajonale dhe ndërkombëtare gjatë reformimit të sistemit arsimor dhe atij të zhvillimit profesional të mësimdhënësve është shumë i rëndësishëm sidomos për MASHT, DKA dhe drejtorë të shkollave.

7.11. Njohja e mësimit paraprak

Në kuadër të caktit që parashesh që deri në fund të vitit 2013, të nxëniet nga arsimi joformal dhe aftësimi në shërbim njihen nga fakultet me rastin e kualifikimit/rikualifikimit të mësimdhënësve

ishin paraparë disa aktivitete primare: zhvillimi i politikave për barasvlerësim të arsimit formal dhe joformal, zhvillimin e politikave për barasvlerësim të trajnimeve të mësimdhënësve para dhe atyre në shërbim dhe krijimin e mekanizmave në fakultetet arsimore për njohjen e të nxëniet nga arsimit joformal dhe aftësimin e mësimdhënësve në shërbim. Gjatë periudhës së ciklit të planit është arritur progres i konsiderueshëm në avancim të kualifikimeve të mësimdhënësve. Sipas shifrave të ofruara nga MASHT gjatë viteve 2010/2011-2014/2015 janë regjistruar rreth 5184 mësimdhënës në programin për Avancimim të Kualifikimeve (AKM) ndërsa 4296 kanë diplomuar. Nga të dhënat kuptohet që rreth 25% përqind e kuadrit mësimdhënës kanë qenë të përfshirë në këtë program të ofruara në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit (UP) në katër qendrat rajonale (Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Gjiilan). Në vitin 2015 është marrë vendimi për kualifikimin e mësimdhënësve/pedagog mirëpo nuk është zbatuar në mungesë të kapacitetit të Fakultetit të Edukimit (UP). Ende nuk është miratuar baza ligjore dhe mekanizmi për njohje të mësimin paraprak dhe jo-formal para dhe gjatë shërbimit.

7.12. Harmonizimi i programeve të fakulteteve

Në vitin 2011, MASHT ka propozuar një strukturë të re për programet arsimore të mësimdhënësve të bazuar në rekomandimet nga vlerësimi i programeve të Fakultetit të Edukimit. Në vitin pasues është marrë vendimi përmes së cilit të gjitha institucionet e arsimit të lartë duhej rishikuar programet arsimore në përputhshmëri me dispozitat e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe rekomandimeve të Agjencisë së Akreditimit (MASHT, 2012). Pikat kryesore të strukturës së re të programeve për kualifikim të mësimdhënësve para shërbimit ishin që programet e edukimit të mësimdhënësve të bazuar në lëndë do të rezultojnë me titull Master (300 ECTS) nga të cilat 180 ECTS (3 vjet) në trajnim akademik dhe 120 ECTS (2 vjet) në pedagogji dhe mësimdhënie praaktike. Gjithashtu, programet e edukimit të mësimdhënësve duhet të përfshijnë trajnime akademike të ofruara nga njësitë akademike dhe trajnim pedagogjik dhe mësimdhënie praktike të ofruara nga Fakulteti i Edukimit për të gjitha nivelet dhe profile e arsimit. Ky vendim nuk ka ndikuar në ndryshim të strukturës së Edukimit Parashkollor ku programet e kualifikimit rezultojnë me titullin Bachelor (240 ECTS).

Tabela 16: Programet dhe studentët e Fakultetit të Edukimit, Universiteti i Prishtinës 2014/2015

Universiteti i Prishtinës			
	Programi	Niveli	Nr total studenteve
1	Arsimi fillor	BA	599
2	Edukimi Parashkollor	BA	268
3	Pedagogji e përgjithshme	BA	255
4	Programi Gjuhe Shqipe	BA	255
5	Programi Gjuhë Angleze	BA	179
6	Programi Teknologji Informative	BA	193
7	Programi Matematike/ Informatikë	BA	170
8	Programi Fizike Kimi	BA	80
9	Programi Biologji Kimi	BA	141
10	Programi Gjeografi Edukatë Qytetare	BA	222
11	Programi Histori Edukatë Qytetare	BA	162
12	Programi Udhëheqje në Arsim	MA	46
13	Programi Mësimdhënia dhe Kurrikula	MA	54
14	Programi Pedagogji e Përgjithëshme	MA	66

Programet e edukimit parashkollor dhe parafillor janë themeluar edhe në Universitetin e Prizrenit, Gjakovës,

Tabela 17: Programet e Edukimit, Institucionet e reja publike 2014/2015

	Programi	Niveli	Nr total studenteve
Universiteti i Prizrenit			
1	Arsimi fillor	BA	181
2	Edukimi Parashkollor	BA	150
Universiteti i Gjakoves			
3	Arsimi Fillor	BA	327
4	Edukimi Parashkollor	BA	317
Universiteti i Gjilanit			
5	Arsimi fillor	BA	133
6	Edukimi Parashkollor	BA	104
Universiteti i Mitrovices			
7	Arsimi fillor	BA	128
8	Edukimi Parashkollor	BA	58

7.13. Kërkimi shkencor në zhvillim profesional të mësimdhënësve

Kërkimi shkencor në zhvillim profesional të mësimdhënësve në tërësi është i kufizuar. Gjatë kësaj faze të raportimit është themeluar Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim të Arsimit (IHZH) në Fakultetin të Edukimit, Universiteti i Prishtinës mirëpo nuk është hasur në ndonjë strategji të hulumtimit, projekte konkrete apo alokim të fondeve për këtë qëllim. Stafi akademik është i orientuar kryesisht në mësimdhënie dhe projektet hulumtuese janë iniciativa individuale në raste të izoluara. Projektet e hulumtimit bazë për mësimdhënie mbulohen kryesisht nga organizata ndërkombëtare apo jo-qeveritare. Në kuadër të MASHT hulumtimet rreth sistemit arsimor realizohen përmes Institutit Pedagogjik (IPK). Gjatë tryezave dhe diskutimeve me palë të interesit ishte shfaqur nevoja e ndarjes së punës dhe sqarimit të rolit të IPK në raport me IHZH.


8. Arsimi i lartë dhe shkenca

Gjatë procesit të hartimit të PSAK 2011-2016 në kuadër të nën-programit për arsimin e lartë ishin identifikuar disa sfida. Në rradhë të parë arsimi i lartë nuk kishte një kornizë ligjore për operim të institucioneve të arsimit të lartë. Pjesëmarrja në arsim të lartë ishte tejet e ulët dhe kërkohej shtimi i kapacitetit për numër më të madh të studentëve. Rritja e numrit të studentëve nënkupton rritje të buxhetit për arsim të lartë dhe kjo nuk ishte pa sfida, ndërkohë që arsimi kishte edhe prioritetet tjera nën-sektorale. Gjithashtu, plani prioritzonte ndërtimin e mekanizmave për ndërlidhjen e programeve me kërkesat e tregut të punës. Praktika e menaxhimit të cilësisë ishte relativisht e re në kontekstin e arsimit të lartë në Kosovë. Mjedisi për mësimnxënie në arsim të lartë ishte joadekuat si për nga aspekti infrastrukturual, ashtu edhe mungesa e mjeteve të konkretizimit dhe mësimnxënies. Në anën tjetër, shkalla e ndërkombëtarizimit dhe mobilitetit të kuadrit mësimdhënës dhe studentëve ishte mjaft e ulët në kontekst të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë. Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, u identifikuar një sërë objektivash:

OBJEKTIVAT ARSIMIT TË LARTE 2011-2016

- 1 Deri në vitin 2012 të hartohen aktet nënligjore dhe të harmonizohen statutet e institucioneve të arsimit të lartë me legjislacionin e ri
- 2 Deri në vitin 2016 të rritet pjesëmarrja në arsim të lartë e grup-moshës 18-25 në 35 % përqind duke respektuar barazinë gjinore
- 3 Deri në vitin 2014 të sigurohet mbështetje e vazhdueshme dhe mundësi të barabarta për përfshirje në arsim të lartë për të gjitha grupet etnike, gjinore, moshës, religjionit dhe grupeve me nevoja të vecanta
- 4 Deri në vitin 2014 programet studimore të përshtaten me nevojat e tregut të punës
- 5 Të rritet buxheti dhe ngritet kapaciteti në zbatim të buxhetit sipas ligjeve të rishikuara.
- 6 Deri në fund të vitit 2016,
- 7 Deri në vitin 2016

Shkalla mesatare e realizimit të objektivave në kuadër të nën-programit arsimi i lartë të PSAK 2011-2016 dhe të shprehur në bazë të indeksit sasior është 2.5 - Në kuadër të programit të shkalla maksimale e realizimit është në kuadër të objektivave Përfshirja (AL 2) dhe Mundësitë e barabarta (AL 3). Shkalla e realizimit është e pjesëshme në zbatim të objektivit për përmirësim të legjislacionit (AL 1), përmirësim të infrastrukturës (AL 10), Ndërkombëtarizim dhe Cilësi (AL 7). Plani ka ngecje të theksuar në realizim të objektivave dhe aktiviteteve në Ndërlidhje të arsimit të lartë me tregun e punës (AL 4), Buxhet dhe menaxhim financiar (1.5), kapacitet të institucioneve për gjenerim të mjeteve vetanake (AL 6) dhe kërkim shkencor (AL 8).

Figura 28: Indeksi i zbatimit të PSAK Arsimit lartë: planifikimi dhe realizimi

Shprehur në tërësi, shkalla e përfshirjes së studentëve në arsimin e lartë ka shënuar progres shumë të lartë duke tejkaluar caqet fillestare. Përqindja e përfshirjes së femrës në arsimin e lartë është e kënaqshme dhe e balancuar me përfshirje të meshkujve. Legjislacioni i arsimit të lartë ka qenë kompletuar dhe është në proces të reformimit. Mekanizmi për vlerësim të jashtëm të cilësisë sipas Udhëzimeve Standarde Evropiane (ESG) është në funksion të rregullt Sidoqoftë, parametrat e mbrendshëm të cilësisë si raporti mësimdhënës-student dhe financimi për kokë studentit janë përkeqësuar. Kjo mund të ketë ndikuar negativisht në numrin tejet të vogël të të diplomuarve në arsimin e lartë publik në krahasim me numrin shumë të lartë të të regjistruarve.

Janë bërë investime kapitale në përmirësim të infrastrukturës për themelimin e disa objekteve të institucioneve publike dhe disa hapa në pasurim të bibliotekave mësimore. Agjencia e Akreditimit të Kosovës është anëtarësuar në ENQA dhe EQAR dhe janë bërë disa hapa për përmirësim të sistemit të barsvlerësimit (ENIC/NARIC) dhe mobilitet të studenteve. Shkalla e ulët e kërimit shkencor, mungesa e një formule të financimit unike dhe që stimulon performancën si dhe shpërputhjet e programeve të arsimit të lartë me tregun e punës mbesin sfida që duhet trajtuar në vitet në vazhdim.

8.1. Legjislacioni i arsimit të lartë

Ligji i rishikuar i arsimit të lartë ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2011 dhe duhej shoqëruar nga akte nënligjore dhe hartimi i statuteve të institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me këtë Ligj. Megjithatë ishte parashikuar një afat 12 muor për plotësimin e këtij detyrimi ligjor, korniza prej 17 aktesh nënligjore, është plotësuar në periudhën 2011-2015. Deri në momentin e vlerësimit nuk janë nxjerrë të paktën tri udhëzime të rëndësishme që përmenden shprehimisht në Ligj:

- UA që rregullon fushëveprimin e konsultimeve në mes të MASHT dhe këshillave drejtues të universiteteve publike (neni 11);
- UA që rregullon metodologjinë e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë (neni 21, pika 1);
- UA që rregullon vlerësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë në kuptim të përmbushjes së objektivave strategjike të përcaktuara (neni 23, pika 2).

Statutet e dy institucioneve publike që kanë ekzistuar në kohën e hyrjes në fuqi të Ligjit, Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Prizrenit, janë harmonizuar me Ligjin dhe janë ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës në shtatorin e vitit 2012, përkatësisht në maj 2013. Edhe statutet e institucioneve private janë harmonizuar me ligjin dhe janë miratuar nga MASHT brenda afatit ligjor. Ndërkohë, ka vazhduar hartimi i statuteve për institucionet e arsimit të lartë të themeluara më vonë. Kështu, Statutit i Universitetit të Pejës është ratifikuar në maj 2013, ndërsaq universitetet e reja në Mitrovicë, Gjakovë dhe Gjilan vazhdojnë të operojnë në bazë të statuteve të përkohshme. Nuk ka evidencë të saktë për hartimin e rregulloreve përcjellëse të statuteve që është një çështje interne e institucioneve të arsimit të lartë. Statutet e universiteteve publike rëndom japin një afat prej 3-6 muaj për harmonizimin e rregulloreve me statutet e reja, por, edhe në rast të mos-harmonizimit të tyre, statutet kanë prioritet në zbatim, në raport me rregulloret.

Gjatë vitit 2015 MASHT ka hartuar projektligjin e ri për arsimin e lartë që sjell ndryshime domethënëse në rregullimin e këtij sektori. Nëse ky Ligj aprovet, atëherë do të ketë sërish nevojë për harmonizim të akteve nënligjore të MASHT dhe atyre juridike të institucioneve të arsimit të lartë me këtë ligj. Me të hyrë në fuqi të ligjit të ri, MASHT duhet të hartojë një plan dinamik të aprovimit të akteve nënligjore të ndërlidhura, me kufizime të qarta kohore dhe ndarje të përgjegjësisë. Sipas nevojës, mund të formohen grupe pune me pjesëmarrje të ekspertëve të jashtëm dhe të përfaqësuesve të IAL, në mënyrë që aktet nënligjore të ofrojnë një mjedis sa më efektiv për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë. Po ashtu, rekomandohet që, sa më shpejtë, të aprohen statutet e institucioneve të reja publike të arsimit të lartë.

8.2.Përfshirja në arsimin e lartë

Derisa në vitin 1999 Kosova ka pasur një institucion publik të arsimit të lartë dhe një tjetër privat, pesëmbëdhjete vjet më vonë i ka 7 institucione publike të akredituara dhe 30 private, pa e llogaritur Universitetin e Mitrovicës Veriore i cili operon pa akreditim në Kosovë. Kështu, Kosova ka 20 institucione të arsimit të lartë për 1 milion banorë që tejkalon shumëfish mesataren e bashkimit Evropian prej 7 institucioneve të arsimit të lartë në 1 milion banorë. Grafiku 1 jep një krahasim të Kosovës me disa vende evropiane. Edhe numri i studentëve në arsimin e lartë ka shënuar rritje të ndjeshme gjatë pesë vjetëve të fundit, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, siç shihet nga tabela 1. Në tabelën 2 janë dhënë tre tregues të pjesëmarrjes në arsimin e lartë. Treguesi i parë, përqindja e studentëve në raport me popullatën e moshës 18-25 vjeç është masa që është përdorur gjatë planifikimit të PSAK 2011-16 me synim që kjo pjesëmarrje të jetë 35% deri në vitin 2016. Siç shihet nga tabela 2, ky cak është tejkaluar në vitin akademik 2011/12, ndërsa në vitin akademik 2014/15 ka arritur në 43.5%. Megjithatë, treguesi i tillë nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare, prandaj edhe janë dhënë dy tregues të tjerë që bëjnë të mundur krahasimin me vendet e tjera.





Tabela 18: Numri i studentëve në arsimin e lartë

Emërtimi	2010/11	2011/12	2012/13	2013/14	2014/15
Universiteti i Prishtinës	47,385	51,987	53,818	46,836	52,665
Universiteti i Prizrenit	1,700	2,784	5,875	7,775	7,775
Universiteti i Pejës	1,207	2,149	3,781	3,285	6,883
Universiteti i Mitrovicës				648	2,074
Universiteti i Gjakovës				585	1,391
Universiteti i Gjiçanit				1,694	1,437
Universiteti i Mitrovicës Ve.	9,230	10,562	10,681	10,264	10,000
Institucionet publike	59,522	67,482	74,155	71,087	82,225
Institucionet private	26,982	31,013	34,685	36,709	38,153
Totali	86,504	98,495	108,840	107,796	120,378

Burimet: Të dhënat nga institucionet e arsimit të lartë dhe AKA. Të dhënat për Universitetin e Prizrenit dhe atë të Mitrovicës Veriore për vitin 2014/15 janë vlerësime. Meqë të dhënat për institucione private për vitin 2014/15 nuk kanë qenë të kompletuara, është vlerësuar se numri i studentëve duhet të rritet për 5 mijë.

Përqindja e studentëve në raport me popullsinë e moshës 20-24 vjet është tregues që përdoret nga Eurostat për të shprehur shkallën e pjesëmarrjes në arsimin e lartë. Nga tabela 2 shihet se ky tregues ka shënuar rritje të vazhdueshme, duke arritur në 69.1%, që tejkalon mesataren e BE prej 62.7%. Treguesi tjetër ka të bëjë me numrin e studentëve në 100,000 banorë dhe shfrytëzohet nga UNESCO. Edhe ky tregues shënon rritje të vazhdueshme në periudhën 2011-2015. Me 6,669 studentë në 100 mijë banorë, Kosova tejkalon të gjitha vendet evropiane dhe mesataren e BE prej 3,987.



Kosova, tanimë tejkalon të gjitha vendet evropiane me pjesëmarrje në arsimin e lartë, në raport me numrin e banorëve, ndërkohë që pjesëmarrja e projektuar e grup-moshës 18-25 prej 35% në arsimin e lartë është tejkaluar që në vitin akademik 2011/12. Po ashtu, në arsimin e lartë është arritur një shkallë e lakmueshme e barazisë gjinore, ku femrat dominojnë në popullatën studentore. Numri i programeve studimoreka shënuar rritje domethënëse, sidomos në nivelin master. Ndërkaq, një element ku vërehet ngecja është numri i stafit akademik me kontratë të rregullt pune, sidomos në institucionet publike të arsimit të lartë. Meqë ka arritur pjesëmarrje të lakmueshme të qytetarëve në arsimin e lartë, Kosova nuk ka nevojë të merr masa të veçanta për të stimuluar pjesëmarrjen në arsimin e lartë, përveç për grupet e marginalizuara, që janë analizuar në kuadër të caktut 3. Në vend të kësaj, përqendrimi duhet të jetë tek cilësia, ku shtimi i personelit

akademik me kontratë të rregullt është hapi i parë. Po ashtu, qeveria duhet të përcaktohet për kuota të përballueshme të studentëve, në mënyrë që të mos krijojë teprice të fuqisë punëtore të kualifikuar, veçanërisht në ato fusha studimore që mbulohen nga më shumë institucione të arsimit të lartë (për më shumë hollësi shih cakun 4).

8.3.Mundësitë e barabarta

Kur bëhet fjalë për përfshirjen në arsimin e lartë, në Kosovë nuk ekziston problemi i përfshirjes së femrës në këtë nivel të arsimit, e as që ka probleme të tilla në raport me përkatësinë religjioze të studentëve. Në përgjithësi, problemi nuk lidhet as me komunitetin serb, nga se ky komunitet është kryesisht i përfshirë në Universitetin e Mitrovicës së Veriut dhe në një kolegji privat që operon në këtë qytet. Nga aspekti politik, temë mund të jetë integrimi i Universitetit të Mitrovicës së Veriut në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës, por diskutimi rreth kësaj teme tejkalon kornizat e vlerësimit të PSAK-ut. Ka vite që MASHT aplikon vende të rezervuara për regjistrim në studime në institucionet publike të arsimit të lartë për pjesëtarët e disa komuniteteve etnike në Kosovës: turq, boshnjakë, rom, ashkali dhe egjiptian. Universiteti i Prishtinës ka raportuar për vende të rezervuara që nuk janë plotësuar në vitin shkollor 2014/15 për shkak të mungesës së interesimit ose mosplotësimit të kushteve minimale për pranim nga kandidatët. Po ashtu, ka pasur raportime për shpërdorimin e vendeve të rezervuara nga individë që janë prezantuar si pjesëtarë të komuniteteve joshqiptare me qëllim të përfitimit.


Nga krahasimi i të dhënave me ato të regjistrimit të popullsisë llogaritet se pjesëmarrja e këtyre komuniteteve në arsimin e lartë publik është 10.7% në raport me grup-moshën 20-24. Ndërkaq, ky përpjesëtim tek popullata shqiptare është 47.2%. Objektivisht, disa nga arsytet për pjesëmarrje më të vogël të komuniteteve joshqiptare në arsimin e lartë publik mund të jetë fakti se të dhënat kanë të bëjnë vetëm me vendet e rezervuara, ndërkohë që pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të konkurrojnë edhe jashtë këtyre vendeve. Pasta, mosnjohja e gjuhës shqipe tek pjesëtarët e disa komuniteteve mund të jetë pengesë për studime në këtë gjuhë, kur merret parasysh se numri i programeve studimore në gjuhën boshnjake dhe turke është i vogël. Për të inkurajuar kryerjen e shkollimit të mesëm të lartë, MASHT ka dhënë 583 bursa për studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në këtë nivel. Ndërkaq, 33 bursa janë dhënë për studentë të arsimit të lartë, ku 46% e përfituesve kanë qenë femra. Shumë pak ka informacion për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara dhe kategorive sociale të marginalizuara në arsimin e lartë në Kosovë. Komunitat në Kosovë japin bursa për studentët në nevojë. Ndërkaq, në vitin 2014 Qeveria ka përgjysmuar pagesat në institucionet publike të arsimit të lartë, duke liruara nga pagesa kategori të caktuara të studentëve në nevojë.

Pjesëmarrja e femrës në arsimin e lartë ka shënuar rritje, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Derisa në vitin akademik 2010/11 ajo ishte 47.2%, pesë vjet më vonë arriti në 50.2%, duke marrë parasysh se 49.7% e popullsisë së Kosovës janë femra. Pjesëmarrja e femrës në sektorin publik është më e lartë – 53.3%, ndërsa në sektorin privat femra mbetet më pak e përfaqësuar – 41.2%. Kjo diskrepancë kërkon një analizë më të thelluar, pasi mund të ndodhë se bëhet fjalë për paragjykimë gjinore me rastin e bërjes së shpenzimeve për shkollim.

Megjithëse pjesëmarrja në arsimin e lartë është në rritje të vazhdueshme, nuk ka fakte bindëse se nga kjo rritje përfitojnë të gjitha grupet sociale. Kjo ndodh për shkak të mungesës së të dhënave. Për aq sa janë në dispozicion, të dhënat flasin se MASHT ofron trajtim preferencial për komunitetet etnike joshqiptare, ndërsa ndodh që vendet e rezervuara në institucione publike të mos plotësohen, qoftë për shkak të mungesës së interesimit, qoftë për shkak të mosplotësimit të kushteve minimale për pranim. Nëse analizohen masat e këtij caku do të vërehet një progres në hartimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe sigurimin e ndihmës financiare për pjesëtarët e komuniteteve joshqiptare (masat 3.1 dhe 3.2), por nuk ka progres të dukshëm në zbatimin e

masave strategjike me të cilat parashihet themelimi i një fondi për ndihmë financiare studentëve në gjendje jo të mirë sociale (masa 3.3) dhe sigurimi i kushteve më të mira për studentë me aftësi të kufizuara (masa 3.4).

Figura 31: Përqindja (%) studentëve sipas etnisë/gjinisë në raport me numrin total



MASHT-i duhet t'i vazhdojë përpjekjet për përfshirjen sa më të madhe të komuniteteve joshqiptare në arsimin e lartë të Kosovës. Në rastin e vendeve të rezervuara duhet të precizohen kritere që nuk lejojnë keqpërdorime nga ana e kandidatëve. Po ashtu, duhet të vazhdojë dhënia e bursave për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, pasi shumica dërrmuese e tyre i takojnë kategorisë së qytetarëve që jeton në varfëri ekstreme. Krahas kësaj, rekomandohet krijimi i skemave financiare për mbështetjen e studentëve nga familjet e varfra që nuk mund ta përballojnë vet shkollimin. Ndërkaq, mbetet aktuale rritja e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në arsimin e lartë. Në këtë plan duhet të hartohen politika të qarta për të mbështetur këtë lloj përfshirje, ashtu siç veprohet në nivelin e arsimit parauniversitar.

8.4.Ndërlidhja e arsimit të lartë me tregun e punës


Nuk kemi sistem të aktiv për ndërlidhjen e të dhënave të tregut të punës me arsimin në Kosovë dhe nuk ka ndonjë evidencë se ato janë shfrytëzuar në reformimin e profileve në arsimin profesional. Aktualisht ekzistojnë tri sisteme të të dhënave që mund të shfrytëzohen për të prodhuar të dhëna të përafërta: Sistemi i regjistrimit të të papunëve që mirëmbahet nga Ministria e Punës (LMIS), të dhënat në lidhje me fuqinë punëtore nga Agjencia e Statistikave (ASK) dhe studimet në lidhje me disponimin e ndërmarrjeve në raport me mjedisin biznesor e ku shkathtësitë e fuqisë punëtore janë një nga dimensionet si BEEPS (2013) nga Banka Botërore. Kosova ka nevojë urgjente për një sistem për përpunimin e të dhënave që ndërlidh të dhënat e kategorive të shkollimit të ISCED dhe Eurostat me të dhënat e kategorive të punësimit (ISCO) dhe setorëve ekonomik (NACE). Të dhënat statike sasiore mund të jenë të dobishme për të dhënë indikacione numerike në lidhje me kërkesën e tregut të punës mirëpo ato duhet të kombinohen më të dhëna cilësore (BEEPS) dhe produktivitetin e fuqisë punëtore (OECD). Ndërlidhja sasiore me tregun e punës nuk nënkupton domosdoshmërisht që fuqia punëtore ti ketë arritur shkallën e duhur të cilësisë.

Studime të ndryshme tregojnë se probleme kyçe që pengojnë zhvillimin ekonomik në Kosovë janë ekonomia e pazhvilluar me kapacitet të ulët për të krijuar vende të reja pune dhe mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar. Tregu i punës në Kosovë ballafaqohet me dy probleme strukturore e që ndërlidhen me shkallën dhe cilësinë e sistemit arsimor. Fillimisht shkalla e kërkesës në tregun e punës është e ulët dhe trendi i vendeve të punës të gjeneruara vitet e fundit nuk garanton

punësim të të diplomuarve. Së dyti, ekziston edhe problemi i mospërputhjes së cilësisë së kualifikimit dhe tregun e punës – ekzistojnë disa sektorë ekonomik që ballafaqohen me mungesë të shkathtësive adekuate. Rezultatet e anketës së ndërmarrjeve BEEPS (Bank Botërore, 2013) tregojnë se rreth 76 % përqind e ndërmarrjeve në Kosovë raportojë se shkathtësitë dhe shkollimi i fuqisë punëtore paraqesin problem për operimin e biznesit. Punëdhënësit e anketuar në kuadër të një studimi të financuar nga USAID kanë qenë të njëzëshëm në pohimin e tyre se kurrikulat e arsimit profesional dhe atij të lartë nuk kanë ndonjë relevancë për tregun e punës në Kosovë, si dhe se mungojnë sistemet që bëjnë ndërlidhjen në mes të kurrikulave dhe tregut të punës

Në anën tjetër pjesëmarrja e fuqisë punëtore me kualifikim të lartë në sektorin privat është vetëm 7% nga e gjithë fuqia punëtore e punësuar në këtë sektor. Kjo është dukshëm më e ulët se sa pjesëmarrja mesatare e punëtorëve me arsimim terciar në fuqi punëtore në Kosovë rreth 20% (OECD 2015). Nga të dhënat rezulton se sektori publik absorbon shumicën e fuqisë punëtore të kualifikuar. Përveç punëtorëve me arsimim terciar, ndërmarrjet raportojnë pakënaqësi edhe me nivelin e shkathtësive të punëtorëve me shkollim të mesëm të lartë profesional. Punëdhënësit raportojnë që fuqia punëtore nuk ka shkathtësi adekuate të përgjithëshme siç janë komunikimi, zgjidhja e problemeve, shkathtësi matematike-numerike, shërbime për klientë, etj. Kjo vë në pah rëndësinë e cilësisë së shkollimit të ulët dhe atij të mesëm, që ndonjëherë nuk merret parasysh në diskutimet e lidhjes në mes të shkollimit dhe tregut të punës.

Figura 31: % e studenteve sipas fushave të studimit në Kosovë, BE (28) dhe trendit të krijimit të vendeve të punës sipas shkathtësive (2003-2013)



Nuk ka ndonjë studim gjithëpërfshirës për përshtatjen në mes të shkathtësive të të diplomuarve dhe nevojave të tregut të punës mirëpo ka mjaft fakte që dëshmojnë të kundërtën. Megjithatë nuk e kemi synim primar, vlerësimi inkorporon disa të dhëna rudimentare që japin indikacione fillestare mbi këtë fenomen. Vlerësimi ka krahasuar të dhënat mbi numrin e studentëve të regjistruar në profile të arsimit të lartë (AKA, 2015) me numrin/trendin e krijimit të vendeve të punës sipas shkathtësive ndërmjet viteve 2003-2013 (ASK, 2014). Kategorizimi i profileve dhe shkathtësive të vendeve të punës është realizuar përmes kategorive të shkathtësive të Eurostat. Të

dhënat fillestare të orientimit të studentëve të arsimit të lartë në raport me fushat e shkathësive, për të cilat janë krijuar vende punë në tërësi në Kosovë ndërmjet 2003-2013 (ASK, 2014), tregojnë një shpërputhje të theksuar. Shpërputhja dallohet në dy dimensione: ofertë lartë në krahasim me kërkesën apo ofertë e ulët në krahasim në kërkesën.


Shkalla e orientimit të studentëve në fushat e studimit “Shkenca shoqërore, biznes dhe juridik” është rreth dy herë më e lartë se sa trendi i krijimit të vendeve të punës me shkathësi të njehta. Shkalla e orientimit të studentëve Kosovar në këto fusha studimi (52%) është poashtu e lartë krahasuar me orientimin e studentëve sipas mesatarës së BE-sëme vetëm 33%. Po ashtu, ekziston një shpërputhje e moderuar edhe në orientim të studentëve kah studimi i shkencave humane dhe arteve. Numri i studentëve të orientuar kah studimi i gjuhës amtare, gjuhëve të huaja, historisë, arkeologjisë, filozofisë dhe arteve është shumë i lartë në krahasim me shanset e tyre të punësimit. Një shpërputhje më modeste në formën e ofertës më të lartë vërehet edhe në fushat e studimit mjekësi dhe mirëqenie. Mirëpo kjo mund të amortizohet nga trendi në rritje i mobilitetit të fuqisë punëtore me shkathësi të ngjashme në vendet e Evropës Perëndimore.

Sipas dimensionit të dytëku oferta është më e ulët se sa kërkesa, orientimi i studentëve duket të jetë në shpërputhje të theksuar në fushat e studimit shërbime dhe inxhinieri, prodhim dhe ndërtim (kërkesa për shkathësi në fushat e inxhinierisë, prodhimit dhe ndërtimtarisë 28%, ndërsa studentë 12.8%). Nga kjo mund të nënkuptohet që numri i studentëve në Inxhinieri (Mekanikë, Energji, Elektricitet, Metale, Automatikë), Prodhim/Përpunim (përpunim ushqimor, përpunim të metaleve, përpunim të plastikës, letrës, drurit, përpunim të lëkurës dhe tekstil) dhe Ndërtimtari (arkitekturë dhe planifikim hapësinor, ndërtimtari dhe inxhinieri civile) është më i ulët se kërkesa e tregut për këto profesione. Tregu poashtu mund të jetë në kërkim të më shumë studentëve nga fushat e shërbimeve personale (hoteleri, turizëm, udhëtime, estetikë, frizer dhe sport) dhe shërbime të sigurisë (fizike, private). Së fundmi, orientimi i studentëve në bujqësi dhe veterinari (2%) rreth dy herë më i vogël se sa kërkesa e tregut të punës (4%). Të dhënat bazohen vetëm në të dhëna zyrtare dhe anahkalojnë rëndësinë e ekonomive shtëpiake. Nga kjo mund të konkludohet se numri i studentëve në bujqësi, lavartari, pentari, të korrura, peshkim, hortikulturë, pylltari dhe veterinari është i vogël në raport me kërkesën për këto shkathësi.

Natyrisht indikator i kërkesës së shkathësive në bazë të vendeve të punës të krijuara në dekadën e fundit nuk nënkupton domosdoshmërisht se në ato vende pune kërkojnë kualifikime të arsimit të lartë. Sidoqoftë në bazë të një studimi të realizuar në kuadër të Projektit të BE (ALLED, 2015) sektorët ekonomik me kërkesë të lartë për profesionistë janë prodhimi dhe përpunimi, elektronika, informatika, programimi, shërbimet audiovizuale, përpunimi i barnave, shërbimet shëndetësore, shërbimet e kontabilitetit, shërbimet financiare dhe patundshmëri. Në anën tjetër në bazë të numrit të të punësuarve në tërësi vërehet që shumica e fuqisë punëtore është e orientuar në aktivitetet ekonomike si tregtia, prodhimi/përpunimi, ndërtimtaria, arsimit, shëndeti dhe mirëqenia, akomodimi, sektori publik dhe shërbimet administrative. Në kuadër të aktivitetit ekonomik prodhim dhe përpunim dhe ku sipas të dhënave më lartë duket se ka një trend në rritje të krijimit të vendeve të punës vërehet nevoja në rritje për profesionistë të përpunimit ushqimor, përpunimit të metaleve, makinerisë, tekstili dhe pijeve.

Nga të gjithë indikatorët e prezantuar dhe krahasur për numrin e studentëve duket të jetë evidente nevoja e orientimit të studentëve dhe mbështetjes kah studimi i fushave të administrimit të biznesit, inxhinierisë, prodhimit, përpunimit, bujqësisë, shërbimeve personale, shërbimeve të transportit, ndërtimtarisë, shëndetësisë dhe shërbimeve të sigurisë. Në raport me secilin indikator ekonomik (trendi i krijimit të vendeve të punës, sektorët e aktivitetit ekonomik, sektorët në kërkim të profesionistëve) shkalla e orientimit të studentëve në studim të shkencave shoqërore të përgjithëshme dhe juridik është shumë i lartë. Edhe orientimi i studentëve kah studimi i shkencave humane (gjuhë, histori, filozofi) është shumë i lartë në krahasim me dinamikën

tregtare. Dështimi për të korrigjuar këtë shteg të operimit dhe shpërputhje mund të rezultojnë në dy fenomene të padobishme në shoqëri: rritje e numrit të studentëve me kualifikim terciar të papunë dhe mohim i indikacioneve të tregut të punës në një kontekst kur rritja e produktivitetit të fuqisë punëtore është esenciale për rritje ekonomike.



Gjatë analizës së orientimit të studentëve në fushat e studimit sipas gjinisë vërehet se ekzistojnë dallime të mëdha gjinore rreth preferencave të studimit. Femrat janë më shumë të orientuara kah studimi në fushat e edukimit, shëndetësisë dhe mirëqenies dhe shkencave humane dhe arteve. Një orientim më i balancuar vërehet në orientimin e studentëve sipas gjinisë në fushat e studimit shkencë shoqërore, biznes dhe juridik. Studentët meshkuj duken më tepër të predispozuar për të studiuar në fushat e shërbimeve, bujqësisë, inxhinierisë, prodhimit, ndërtimtarisë dhe shkencave natyrore dhe informatikës. Me përjashtim të shkencave shoqërore, biznesit dhe juridikut ku orientimi gjinor është i balancuar, orientimi i studentëve femrave është i orientuar drejt shkencave jo-ekzakte ku kërkesa në treg është më e vogël, ndërsa meshkuj janë të orientuar drejt shkencave ekzakte, për të cilat kërkesa në treg është më e lartë.

Në periudhën 2011-2015 ka shënuar rritje domethënëse numri i programeve studimore në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Kështu derisa numri i programeve bachelor në raport me vitin akademik 2010/11 është rritur për një të tretën, numri i programeve master është rritur për 59.2% për shkak të shtimit të interesimit për studime të këtij niveli.


Tabela 19. Programet e akredituara të arsimit të lartë ka shënuar rritje numri i programeve

Viti akademik	Bachelor	Master	Doktoratë	Gjithsej
2010/11	196	113	1	310
2011/12	212	129	12	353
2012/13	240	154	25	419
2013/14	270	181	26	477
2014/15	262	180	26	468

Burimi: Agjencia e Akreditimit e Kosovës

Sidoqoftë oferta programore është kryesisht e dominuar nga dy fusha të studimit: shkenca shoqërore, biznes, juridik dhe shkenca humane dhe arte (rreth 65%) të programeve. Oferta programore në institucione publike është e dominuar nga shkenca shoqërore, biznes, juridik (23%), inxhinieri, prodhim, ndërtim (25%), shkenca humane dhe arte (17%), shëndetësi, mirëqenie (8%), shkenca natyrore, matematike dhe shkenca kompjuterike (8%) dhe edukim (8%). Oferta e institucioneve private është e dominuar në masë të madhe nga shkenca shoqërore, biznes dhe juridik (63%), shëndeti dhe mirëqenia (11%) dhe shkenca humane dhe arte (9%). Orientimi programor përafërsisht ndjek edhe orientimin e studentëve. Sidoqoftë, krahas orientimit të studentëve edhe oferta programore duket të jetë në shpërputhje me të dhënat fillestare të tregut të punës.

Figura 33: % e programeve të studimit sipas fushave dhe krahasimi i ofertes publike dhe private. Burimi: KAA 2015




Nuk ka evidence që institucionet ndjekin logjikën e programeve të bazuara në treg dhe ndonjë mekanizëm që monitoron këtë proces në mënyrë sistematike. Në kuadër të planit të ri duhet rishikuar mundësia e balancimit të numrit të studentëve dhe programeve duke aplikuar kuotimin apo reduktimin e financimit për studentë në institucionet publike dhe duke ndjekur me rigorozitet kriterin për përputhshmëri të programeve me tregun e punës (procesi i akreditimit).

Orientimi i studentëve dhe programeve zbulon edhe indikacione të diferencimit dhe specializimit ndërmjet sektorit publik dhe sektorit privat. Sipas të dhënave studentët përzgjedhin sektorin publik për studim të edukimit, bujqësisë, inxhinierisë, prodhimit, ndërtimit dhe shkencat humane dhe artet. Orientimi studentor në fushën e shkencave shoqërore, biznes dhe juridik, shëndetësi dhe mirëqenie dhe shërbime duket të jetë më tepër i peshuar në sektorin privat. Sektori publik specializon më tepër në shkathtësi të forta ndërsa sektori privat në shkathtësi të buta.

Të gjitha hulumtimet tregojnë se punëdhënësit në Kosovë nuk janë të kënaqur me relevancën e programeve studimore në raport me nevojat e tregut të punës. Po ashtu, ka një përqendrim mjaft të madh të studentëve në edukim, shkenca humane dhe arte, si dhe në shkenca shoqërore, ndërkohë që për disa fusha ku mundësitë e punësimit janë më të mira, si shkencat e natyrës, kompjuterika dhe shkencat inxhinierike, interesimi është më i vogël, kjo edhe në krahasim me vendet e BE. Deri tani, në Kosovë nuk janë bërë analiza të mirëfillta të nevojave të tregut të punës, siç parasheh caku 4. Megjithatë, një proces i tillë tanimë ka filluar përmes projektit ALLED që mbështetet nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Austrisë dhe pritet të nxjerrë analiza të

rregullta që mund të shfrytëzohen nga institucionet e arsimit të lartë për t'i përshtatur programet e tyre me kërkesat e tregut të punës përtej nivelit të perceptimeve.

Figura 34: Koncentrimi i studenteve publik/privat sipas fushave të studimit



Qeveria duhet të kujdeset që programet studimore që ofrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë të jenë në linjë me kërkesat e tregut të punës, sepse kështu siguron shpenzim të përgjegjshëm të parasë publike dhe hap mundësi për të rinjtë. Në veçanti duhet shmangur paralelizmat në ofrimin e programeve që nuk sigurojnë punësim, duke i përqendruar ato në një ose në dy institucione. Mbështetje e veçantë duhet të ofrohet për ato programe studimore që kanë potencial të sjellin punësim. Për të siguruar informacion relevant për këtë, duhet realizuar analiza të rregullta të tregut të punës edhe pas përfundimit të projektit ALLED, duke i bërë publike rezultatet.

8.5. Buxheti dhe menaxhimi financiar

Me gjithë faktin që ka qenë e paraparë me PSAK dhe me Ligjin për Arsimin e Lartë, Kosova akoma nuk ka zhvilluar një metodologji për financimin e institucioneve të arsimit të lartë që nxitë efektivitetin dhe llogaridhënien. Sidoqoftë, nga viti 2011, financimi për arsimin e lartë është në rritje, siç tregon tabela 7. Financimi është në rritje edhe si shumë nominale, por edhe si përqindje e bruto-produktit vendor dhe të buxhetit qeveritar. Në fakt, në vitin 2014, ky financim ka arritur në 0.91% të bruto produktit vendor me çka i është afruar mesatares së BE prej 1.13%.

Tabela 20: Shpenzimet në arsimin e lartë

Lloji i shpenzimit	2011	2012	2013	2014
Financimi në arsimin e lartë (mil. €)	34.63	37.62	41.02	50.76
Shpenzimet për arsim si % BPV	4.60%	4.70%	4.30%	4.70%
Shpenzimet për AL si % BPV	0.73%	0.77%	0.77%	0.91%
Shpenzimet për arsim si % BKK	15.50%	16.00%	15.70%	16.50%
Shpenzimet për AL si % BKK	2.45%	2.61%	2.79%	3.19%

Burimi: Rishikimi i përbashkët vjetor 2014

Ndërkaq analiza e shpenzimeve publike për kokë studenti e dhënë në tabelën 8 është bërë duke i marrë parasysh vetëm studentët që studiojnë në njërin nga gjashtë universitetet publike të Kosovës, e që, në fakt, janë përfituesit e këtij financimi. Nga tabela 8 vërehet se shuma nominale e shpenzimeve publike për kokë studenti, fillimisht ka shënuar një rënie të lehtë, për të shënuar pastaj një rritje të lehtë gjatë vitit 2014. Megjithatë, brenda katër vjetësh kjo shumë është rritur vetëm për 2% dhe kjo si pasojë e përgjysmimit të pagesave për studentë dhe rritjes së pagave të mësimdhënësve universitarë. Ndërkaq, nëse shihet shpenzimi për kokë studenti si përqindje e BPV për kokë banori, vërehet një rënie e vazhdueshme gjatë katër vjetëve. Me këtë shkallë të shpenzimit publik Kosova qëndron më mirë se vendet si Bullgaria (16%) dhe Rumania (19.7%), por më keq se Austria (35%), Danimarka (51%), Serbia (40.1%) dhe Moldova (41.8%).

Tabela 21: Shpenzimet për kokë studenti

Lloji i shpenzimit	2011	2012	2013	2014
Shpenzimet për student (EUR)	689	661	646	703
Shpenzimet për student si % e BPV për kokë banori	28.50%	24.89%	21.69%	21.48%

Burimi: Rishikimi i përbashkët vjetor 2014 (financimi i arsimit të lartë)

Si total, shpenzimet publike për arsimin e lartë janë në kufi të standardeve evropiane, ndërkohë që shpenzimet për kokë studenti janë në rënie, për shkak të shtimit të numrit të studentëve dhe rritjes së vazhdueshme të BPV. Nga ana tjetër, një analizë e të dhënave nga UP tregon se 73.7% e buxhetit institucional shpenzohet për pagat e të punësuarve, ndërkohë që institucioni ka mungesë të theksuar të personelit akademik. Si duket, institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë shumë pak i shfrytëzojnë mundësitë për krijimin e mjeteve vetanake gjë që është analizuar në cakun 6 dhe kjo shkakton presion tek buxheti i shtetit.

Ligji për Arsimin e Lartë parasheh ndërtimin e mekanizmave efektivë për financim transparent që nxitë llogaridhënie. Ky financim bëhet mbi bazën e planeve 3-vjeçare që negocohen në mes të institucioneve të arsimit të lartë dhe MASHT-it, ndërsa raportimi duhet të bëhet në bazë të treguesve të dakorduar. Gjatë periudhës vijuese, fokusi duhet të jetë pikërisht në këtë aspekt, duke i nxitur institucionet e arsimit të lartë që, me sa më pak shpenzime, të nxjerrin rezultate sa më të mira.

8.6. Kapaciteti për vetë-financim

Ideja e masave të ndërlidhura me këtë cak ka qenë që shteti të krijojë kushte më të përshtatshme për gjenerimin e të hyrave vetanake nga ana e institucioneve publike të arsimit të lartë, duke përjashtuar, me këtë rast, të hyrat nga studentët. Si masë e parë është paraparë hartimi i rregulloreve përkatëse nga vet institucionet e arsimit të lartë. Për momentin, rregullore të tillë ka vetëm Universiteti i Prishtinës dhe ajo përcakton mënyrën themelimit dhe parimet e funksionimit të instituteve brenda Universitetit. Rregullorja përcakton edhe mënyrën e ndarjes së fitimit në mes të Universitetit dhe njësisë akademike përkatëse, si dhe mënyrën e kompensimit të atyre që kryejnë shërbime. Deri tani, janë krijuar disa institute në kuadër të njësive akademike të UP, por nuk ka informacion për ndonjë shkallë më të lartë të krijimit të të hyrave.

Masa tjetër ka të bëjë me zhvillimin e mekanizmave për gjenerimin e të hyrave brenda institucioneve të arsimit të lartë, si zyrat për projekte, e të ngjashme. Në këtë aspekt, institucionet publike janë mbështetur në zyrat për marrëdhënie me jashtë dhe nuk kanë krijuar shërbime të tilla, mbase në mungesë të fondeve.

Ndërkaq, masa e tretë ka të bëjë me organizimin e trajnimeve për hartimin e projekteve. Trajnime

të tilla ka pasur, si nga donatorët, ashtu edhe nga institucionet e Kosovës dhe ato kanë dhënë rezultat në programe ku ekzistojnë kuota të rezervuara për Kosovën, siç është Tempus. Ndërkaq, më pak sukses ka pasur në programet garuese.

Sigurimi i të hyrave vetanake është një aspekt me rëndësi i funksionimit të një universiteti, por këtij aspekti nuk i është kushtuar kujdes i duhur, pasi të ardhurat nga buxheti publik vazhdojnë të jenë mjaft atraktive për kushtet e Kosovës

Me rastinehartimit të planeve strategjike 3-vjeçare mbi bazën e të cilave zhvillojnë negociata për financim publik, institucionet publike të arsimit të lartë duhet t'i planifikojnë edhe burimet e të ardhurave plotësuese, duke marrë obligime në këtë drejtim.

8.7. Menaxhimi i cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor

Objekti synonte që deri në vitin 2014 është bërë ngritje e vazhdueshme e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkime shkeencore. Në kuadër të objektivit ishin paraparë disa aktivitete kryesore: merret vendimi për emërimin e organeve të Qendrave për Përsosje të Mësimdhënies dhe plani i punës, hartohen dhe ofrohen programe për përsosmëri të metodologjisë së mësimdhënies, rishikohen kriteret për zgjedhje dhe për avancim të stafit akademik dhe fuqizohen njësitë për sigurimin e cilësisë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Aktivitetet e planifikuara nuk janë adekuate për arritjen e qëllimit të ngritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Menaxhimi i cilësisë ka dimensione të jashtme dhe dimensione të mbrendshme.

Në kuadër të praktikës ndërkombëtare sigurimi i cilësisë së jashtme reaalizohet kryesisht përmes (a) vlerësimit të jashtëm të programeve dhe institucioneve, (b) vlerësimit të arritshmërisë së studentëve dhe (c) vlerësimit të stafit akademik në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Në kuadër të këtyre proceseve të vlerësimit inkuadrohen parametrat e performancës së programeve dhe institucioneve përmes proceseve të rankimit duke shqyrtuar mes tjerash aspektet cilësore/sasiore të stafit akademik, aspektet cilësore dhe sasiore të kërkimit shkencor, parametrave të cilësisë si raporti i mësimdhënësve ndaj numrit të studentëve, financimi për kokë student dhe performancën e studentëve në anketime/teste të jashtme (psh. OECD PIACC). Në dimensionet e sigurimit të cilësisë së mbrendshme vlerësohet (a) ekzistenca e praktikës së vetë-vlerësimit, (b) stafi për sigurim të cilësisë dhe (c) mekanizmat e rregullt institucional për sigurim të cilësisë në menaxhim, mësimdhënie, kërkim shkencor, infrastrukturë dhe mjedis të mësimdhënies, programeve akademike, student, financim dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Në dimensionin e sigurimit të jashtëm të cilësisë, Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AKA) ka zbatuar procesin e akreditimit të institucioneve dhe programeve përmes procesit të vlerësimit të jashtëm. AKA ka funksionuar me kapacitete adekuate institucionale dhe materiale dhe ka përmbushur funksionin institucional. Sipas OECD (2015) Kosova dhe Malizi i Zi janë të vetmet vende që kanë avancuar në procesin e vlerësimit të jashtëm në arsimin e lartë. Në procesin e vlerësimit të jashtëm AKA ka angazhuar mesatarisht rreth 35 runde të vlerësimit të jashtëm ndërmjet 2011-2015 dhe në të janë përfshirë ekipe të shumta të ekspertëve të jashtëm nga vendet anëtare të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).

Tabela 22: Numri i institucioneve të arsimit të lartë të akredituara në Kosovë

	2011	2012	2013	2014	2015
<i>Nr. Institucioneve të akredituara</i>	24	26	30	34	37

Kosova nuk ka praktikë të vlerësimit dhe akreditimit të stafit akademik në krahasim me praktika më të avancuara në vende të ndryshme të institucioneve simotra në EHEA. Kosova nuk zbaton ndonjë mekanizëm të vlerësimit të jashtëm të arritshmërisë së studentëve apo matjes së shkathtësive dhe kompetencave të tyre sic mund të jetë testi PIACC i OECD. Në mungesë të një mekanizmi të tillë është e vështirë të nxjerren konkluzione në lidhje me progresin e studentëve. Sidoqoftë, ekziston trend në rritje i të diplomuarve të papunë duke arritur në 13% në vitin 2014 (ASK, 2014). Kjo mund të jetë rezultat i gabimeve strukturore në orientim të studentëve sipas fushave të studimit por edhe si rezultat i nivelit të ulët të shkathtësive të të diplomuarve (BEEPS, 2013). Në anën tjetër, shkalla e të diplomuarve në kohë e studentëve nuk është e kënaqshme. Në bazë të të dhënave të vitit 2011/2012 të cilat ishin krahasuar me numrin e të regjistruarvetre vite më herët kuptohet se shkalla e të diplomuarve në kohë është relativisht e ulët (rreth 35%).

Tabela 23: Numri i përafërt i të diplomuarve në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë


	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014	2014/2015
Inst.publike	5143	5129	4810	5434	6058
Inst.private	3206	2391	3292	5721	7357
Total					

Burimi:

Te dhenat ne lidhje me te diplomuarit ne institucionet publike jane bazuar ne raportet e Universitetit te Prishtines dhe Universitetit te Prizrenit.


Te dhenat ne lidhje me te diplomuarit ne institucionet private jane bazuar ne raportet e institucioneve private te arsimit te larte. Konkluzionet jane bazuar ne nje moster prej 80% te institucioneve jo-publike.

Në Kosovë nuk është e zhvilluar praktika e rankimit të institucioneve apo programeve akademike. Rangimi i vetëm ndërkombëtar që përfshin institucionet e arsimit të lartë në Kosovë është Webometrics që realizohet nga një institut kërkimor në Spanjë. Webometrics mat madhësinë dhe prezencën në web të institucioneve të arsimit të lartë dhe ka një korrelacion mjaft të mirë me rangimet tjera ndërkombëtare në rastin e institucioneve më prestigjioze të arsimit të lartë në botë. Edicioni i Webometrics i korrikut të vitit 2015 e klasifikon Universitetin e Prishtinës në vendin e 4,060-të, ndërkaq të gjitha institucionet tjera të arsimit të lartë rangohen më poshtë. Një krahasim i rangimit të Universitetit të Prishtinës me universitetet e kryeqyteteve tjera të Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Universitetit të Tiranës, tregon se pozicioni i tanishëm i arsimit të lartë në Kosovë lë shumë për të dëshiruar.



Sa i përket dimensionit të sigurimit të mbrendshëm të cilësisë të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit të lartë kanë zyra apo zyrtar për sigurim të cilësisë (AKA, 2015). Në bazë të Grafikut (X) numri i stafit në institucionet publike të arsimit të lartë është rritur numerikisht që nga viti 2011 mirëpo rritja ka qenë tejet e ulët në krahasim me numrin në rritje të studentëve. Raporti mësimdhënës-student është përkeqësuar ndjeshëm që nga viti 2010/2011. Grafiku poashtu tregon që financimi për kokë student është përkeqësuar ndjeshëm 2010/2011 – 2013/2014 për të regjistruar një përmirësim të lehtë vetëm gjatë vitit 2014/2015. Përkeqësimi i këtyre parametrave mund të ketë ndikuar edhe në ulje në numër të të diplomuarve ndërmjet 2010/2011-2013/2014.

Figura 36: Lluhatjet e parametrave sasior të cilësisë 2011-2015 të shprehur në përmirësim (+) apo përkeqësime (-) në raport me bazën (0) të vitit 2010/2011.



Sipas të dhënave nga institucionet e arsimit të lartë dhe AKA, në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë janë në marrëdhënie të rregullt pune 1,157 anëtarë të personelit akademik, ndërsa 1,302 angazhohen si bashkëpunëtorë të jashtëm. Ndërkaq, në institucionet private janë të angazhuar gjithsej 1,027 anëtarë të personelit akademik, ndërsa nuk ka informacion të saktë për numrin e stafit të rregullt dhe të angazhuar. Nga tabela 4 vërehet se në pesë vjetët e fundit ka pasur një rritje të lehtë të personelit akademik me kontratë të rregullt pune në institucionet publike të arsimit të lartë Kosovë që sillet rreth 10%, ndërkohë që numri i studentëve gjatë periudhës së njëjtë është shtuar për 44%. Megjithatë pjesëmarrja e femrave në radhët e personelit akademik vazhdon të jetë më e vogël sesa e meshkujve, ajo është rritur nga 28% në vitin akademik 2010/11 në 33% në vitin akademik 2014/15.

Tabela 24.: Personeli akademik me kontratë të rregullt pune në institucionet publike të arsimit të lartë

Institucioni	2010/11		2011/12		2012/13		2013/14		2014/15	
	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F
Uni i Prishtinës	1,021	286	1,076	316	1,058	316	1,057	344	1,007	329
Uni. i Prizrenit									35	8
Universiteti i Pejës	0	0	28	6	61	29	60	29	59	29
Univ i Mitrovicës	0	0	0	0	0	0	25	2	27	2
Univ i Gjakovës	0	0	0	0	0	0	0	0	17	7
Unii Gjilanit	0	0	0	0	0	0	13	6	12	6
Total	1,021	286	1,104	322	1,119	345	1,155	381	1,157	381

Burimi: Të dhënat nga institucionet e arsimit të lartë


Ndërkaq, tabela 5 jep një pasqyrë të personelit akademik me honorar në institucionet publike të arsimit të lartë. Vërehet se te personeli me honorar ka pasur një rritje prej 30% gjatë pesë viteve të fundit. Me këtë rast, duhet pasur parasysh se një person mund të angazhohet si personel akademik me honorar në më shumë se një institucion të arsimit të lartë, prandaj tabela ka të bëjë me numrin e angazhimeve e jo të personave.

Tabela 25. Personeli akademik me honorar në institucionet publike të arsimit të lartë

Institucioni	2010/11		2011/12		2012/13		2013/14		2014/15	
	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F
Univ i Prishtinës	866	251	743	227	771	259	774	298	650	255
Univ i Prizrenit									133	39
Univ i Pejës	0	0	35	12	53	16	98	18	152	46
Univ i Mitrovicës	0	0	0	0	0	0	63	15	46	17
Univ i Gjakovës	0	0	0	0	0	0	0	0	75	37
Univ i Gjilanit	0	0	0	0	0	0	57	17	69	16
	866	251	778	239	824	275	992	348	1,125	410

Burimi: Të dhënat nga institucionet e arsimit të lartë

Përpjesëtimimësimdhënës/student është një tregues kuantitativ i cilësisë. Në institucionet publike të arsimit të lartë, mesatarisht janë 62 studentë për një mësime dhënës me kontratë të rregullt pune. Situata ndryshon nga një institucion në tjetrin, ku gjendja më e mirë paraqitet në Universitetin e Prishtinës, ndërsa gjendja më e keqe në Universitetin e Prizrenit. Ky përpjesëtim përmirësohet deri në një masë kur llogariten edhe mësime dhënësit me honorar. Edhe duke anashkaluar faktin se një pjesë e mirë e tyre mund të jenë personat e njëjtë, që punojnë në disa institucione njëkohësisht, Kosovapërsëri mbetet larg standardeve ndërkombëtare në këtë aspekt. Në favor të këtij konstatimi flet grafiku që paraqet raportin mësime dhënës-student në disa vende të Ballkanit.



Një tjetër kapitull është puna që bëhet me mësime dhënës. Edhe pse mësime dhënësia është aktivitet primar në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, megjithatë rezultatet në punën kërkimore-shkencore janë ato që përcaktojnë avancimin akademik. Për këtë qëllim, mësime dhënësit universitarë nuk i kushtojnë, medoemos, kujdes të duhur metodave të mësime dhënësies dhe janë të nevojshme aktivitete shtesë në këtë drejtim. Në vitin 2013, Universiteti i Prishtinës ka rithemeluar Qendrën për Përsosmëri në Mësime dhënës, por akoma janë duke u bërë hapat fillestarë

për vënien në funksion të saj. Sa i përket avancimeve akademike në institucione të arsimit të lartë, kjo temë u aktualizua në fillim të vitit 2014 kur u kuptua se për këtë qëllim janë shfrytëzuar punime me vlerë të dyshimtë të publikuara në revista jo të besueshme. Kjo ngjalli një debat të gjerë publik në Kosovë, i cili rezultoi me një interesim të shtuar të opinionit dhe të komunitetit akademik që avancimet të jenë në përputhje me legjislacionin dhe të bazuara në kontribut të mirëfilltë në fushën e kërkimeve dhe të punës pedagogjike.

Dëshmia më e mirë për ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë do të ishte përgatitja më e mirë e gjeneratave të reja për t'u përballur me sukses me kërkesat e tregut të punës në vend dhe jashtë tij, si dhe për të vazhduar me sukses shkollimin e mëtejshëm. Megjithatë dëshmi të tilla mbledhen shumë vështirë, prandaj publikut i mbetet që t'i besojë rezultateve të akreditimit, rangimeve ndërkombëtare dhe parametrave të matshëm, siç është raporti mësimdhënës-student. Jo gjithnjë, këto kategori komunikojnë mirë me njëra-tjetrën. Cilësia, patjetër, ndërlihet edhe me faktorë të tjerë që prezantohen në këtë raport si financimi i arsimit të lartë, ndërlihet me tregun e punës e të ngjashme.

Gjatë periudhës vijuese duhet të vazhdohet me përpjekjet për ngritjen e cilësisë. Nga këndvështrimi i shtetit, sigurimi i jashtëm i cilësisë, për të cilin është përgjegjëse AAK, duhet të bëhet akoma më i besueshëm, në mënyrë që të arrihet një krahasueshmëri me sistemet tjera të arsimit të lartë në kuptim të cilësisë së ofertës. Sado me rëndësi që është vlerësimi i jashtëm, ndërtimi i mekanizmave të brendshëm për sigurimin e cilësisë mbetet detyrë me rëndësi e institucioneve të arsimit të lartë. Përmirësimi i raportit mësimdhënës-student në institucionet publike kërkon investime në krijimin e kuadrit, por edhe mjete financiare shtesë. Ndërkaq, përmirësimi i mësimdhënies është një detyrë me rëndësi për të gjitha institucionet e arsimit të lartë që duhet të krijojnë mekanizma për shkëmbim të përvojës në mes të personelit akademik me qëllim të avancimit në këtë fushë.


8.8. Kërkimi shkencor, inovacioni dhe transferi i teknologjisë

Dokumenti më i rëndësishëm shtetëror që rregullon planifikimin e punës kërkimore-shkencore në Kosovë është Programi Kombëtar i Shkencës 2010-2015 i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Ndërkaq, PSAK merret me veprimtarinë kërkimore-shkencore për aq sa kjo veprimtari lidhet me institucionet e arsimit të lartë. Megjithatë, në Kosovë nuk ka të dhëna të diferencuara për veprimtarinë kërkimore-shkencore sipas tipit të institucioneve që ushtrojnë këtë veprimtari. Në fakt, edhe ato pak të dhëna që ekzistojnë janë të mangëta.

Një nga burimet e rralla që analizon performancën e Kosovës në fushën e kërkimit shkencor dhe bën krahasimin me vende të tjera është një raport i projektit Danube-INCO.NET, i cili sjell të dhëna për publikimet shkencore të indeksuara në dy bazat kryesore të të dhënave në botë: Web of Science (WoS) dhe Scopus në periudhën 2003-2013 (grafiku 11). Nga të dhënat shihet se, gjatë periudhës 10-vjeçare janë publikuar vetëm 826 punime të indeksuara në këto dy baza të të dhënave që është shumë më pak sesa në vendet tjera. Vlerësohet se 100-200 punime të tjera kanë mundur të mos jenë evidentuar në emër të Kosovës për shkak të statusit jo të rregulluar ndërkombëtar në periudhën 2003-2007, por kjo nuk ndryshon pozitën në rangim. Me këtë rast duhet theksuar se shpenzimet për shkencë në Kosovë kapin 0.1% të BPV, ndërkohë që shkalla e investimit në disa vende të Evropës Qendrore dhe Juglindore, për të cilat ekzistojnë të dhëna, është shumëfish më e madhe.


Universiteti i Prishtinës është institucioni i vetëm i arsimit të lartë që ka zhvilluar një strategji për veprimtarinë kërkimore-shkencore. Kjo strategji ka të bëjë me periudhën 2013-2016 dhe, përkrah formati, ndjek modelin e Programit Kombëtar të Shkencës. Me gjithë faktin se strategjia parasheh masa konkrete për avancimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në Universitet dhe një buxhet

relativisht modest për mbështetjen e saj, nuk ka pasur shumë veprime konkrete drejt implementimit.



Në Universitetin e Prishtinës operojnë 26 programe të akredituara të doktoratës. Megjithatë, nuk ka dëshmi se këto programe janë të ndërlidhura me projekte kërkimore konkrete dhe, në përgjithësi, mbetet detyrë e studentëve të kujdesen për organizimin e hulumtimit.

Një mbështetje për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në Kosovë ka ardhur nga projekti HigherKOS i financuar nga Qeveria e Austrisë, i cili ka ndihmuar në hartimin eligjit të ri për veprimtarinë kërkimore-shkencore, ka financuar 11 projekte shkencore të cilat janë realizuar në bashkëpunim me institucione austriake dhe nga vende të tjera të rajonit, si dhe ka dhënë 13 bursa për studimedoktoratës në Austri. Po ashtu, Bashkimi Evropian ka ofruar financim të projekteve kërkimore të menaxhuara nga institucionet e Kosovës.



Edhe pse njihet si aspekt i rëndësishëm i funksionimit të një institucioni të arsimit të lartë, puna kërkimore nuk është plotësisht e integruar në aktivitetet e zakonshme të universiteteve në Kosovë. Me disa përjashtime, në universitete nuk zhvillohet veprimtari e organizuar kërkimore-shkencore, por kjo veprimtari zhvillohet më shumë në bazë të nismave individuale. Financimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në Kosovë mbetet larg nivelit të dëshiruar dhe nuk vërehen trende përmirësimi në këtë aspekt. Nga institucionet e arsimit të lartë që kanë statusin ligjor të universitetit duhet kërkuar që veprimtarinë kërkimore-shkencore ta kenë pjesë përbërëse të

aktiviteteve të tyre ditore. Për këtë qëllim, ato duhet të ndajnë edhe fonde vetanake, ndërsa shteti, po ashtu, duhet të vë në dispozicion fonde, në baza garuese, për veprimtari kërkimore-shkencore. Përmes sistemit, tanimë ekzistues, të NCP-ve duhet të informohen institucionet e arsimit të lartë për mundësitë që sjell programi Horizon 2020, si dhe të ndihmohen rreth pjesëmarrjes në projekte.

8.9. Ndërkombëtarizimii arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor

Kosova merr pjesë në skema mobiliteti akademik siç janë CEEPUS dhe Erasmus Mundus dhe, po ashtu, përfiton nga forma të ndryshme të përkrahjes bilaterale dhe multi-laterale. Përkundër kësaj, mundësitë e mobilitetit për stafin dhe studentet janë të kufizuara. Pengesa kryesore për mobilitet jashtë Kosovës është numri i kufizuar i bursave, si dhe mosnjohja e mjaftueshme e gjuhës angleze nga stafi dhe studentët. Ndërkaq, pengesë për mobilitetin e të tjerëve drejt Kosovës është mosnjohja e gjuhës shqipe. Kështu, studentët kosovarë kanë përfituar nga 331 mobilitete të Erasmus Mundus prej gjithsej 4,163 që i kanë takuar Ballkanit Perëndimor. Ndërkaq, Kosova ka qenë nikoqire e 5 studentëve të BE nga 398 mobilitetet që ata kanë zhvilluar në Ballkanin Perëndimor. Një balancë më e mirë është arritur tek programi CEEPUS, ku 58 studente dhe mësimdhënës kosovarë kanë përfituar nga mobilitetet drejt vendeve pjesëmarrëse, përderisa Kosova ka qenë nikoqire në 46 mobilitete. Vitet e fundit, kujdes i veçantë i është kushtuar studimeve të doktoratës jashtë vendit. Kështu 30 studentë të doktoratës kanë përfituar bursa nga MASHT, ndërsa 13 nga projekti HigherKOS.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Akreditimit në Kosovë operojnë 18 programe të akredituara që ofrojnë mësim në gjuhën angleze. Në tabelën 10 është dhënë një pasqyrë e diplomave të njohura prej vitit 2011 deri në muajin korrik të vitit 2015. Me përjashtim të vitit 2013, vërehet se ka interesim mjaft të madh për studime jashtë Kosovës. Qeveria ka mbështetur këtë lloj mobiliteti përmes sigurimit të bursave për studime në disa institucione në rajon dhe më gjerë.

Tabela 26: Diplomat e njohura nga Zyra ENIC/NARIC e Kosovës

Niveli	2011	2012	2013	2014	2015 (1-7)	Gjithsej
Bachelor	314	296	53	299	194	1156
Master	123	177	130	281	236	947
Doktoratë	41	72	46	106	63	328
<i>Gjithsej</i>	478	545	229	686	493	2431

Burimi: Zyra ENIC/NARIC

Bashkëpunimi ndërkombëtar ka zënë vend të rëndësishëm në agjendën e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Pjesa dërmuese e tyre bëjnë përpjekje që këtë bashkëpunim ta realizojnë përmes projekteve të financuara nga programet evropiane, ndërsa, në raste të caktuara, për bashkëpunim ndër-institucional janë treguar të dobishme edhe programet e financuara nga Qeveria e SHBA.

Mobiliteti akademik mbetet instrument me rëndësi për lehtësimin e integritetit të Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, por vazhdojnë të mbeten pengesat për zhvillimin e një mobiliteti të mirëfilltë. Nga ana tjetër, ka interesim për studime jashtë vendit, por edhe raste kur programet ndërkombëtare ofrohen nga institucione të arsimit të lartë në Kosovë. Bashkëpunimi akademik ndër-institucional është i dobishëm për institucionet pjesëmarrëse, por ka raste të shumta që ky bashkëpunim nuk është treguar i qëndrueshëm përtej kohëzgjatjes së projektit. Qeveria duhet të ketë program që mbështet mobilitetin akademik të personelit dhe të studentëve. Po ashtu, institucionet e arsimit të lartë duhet t'i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që, përmes

.....

programeve ekzistuese, të shtojnë mobilitetin e stafit dhe të studentëve. Tek këta të fundit, duhet lehtësuar maksimalisht procedurat e njohjes së krediteve. Po ashtu, duhet menduar për lehtësimin e procedurave të njohjes së diplomave të fituara jashtë vendit, në veçanti për ato raste që janë identike ose të ngjashme me të mëhershmet.


9. Arsimi dhe aftësimi i të rriturve

Gjatë elaborimit fillestar të planit ishin identifikuar një varg sfidash në kuadër të programit arsimi dhe aftësimi për të rriturit dhe arsimin joformal. Fillimisht qasja e të rriturve në arsim pas shkollës ishte e ulët dhe kërkohej të inkurajohet inkudrimi i tyre përmes programeve të aftësimi të të rriturve. Kjo sfidë ishte e ndërlidhur edhe me nivelin e ulët të vetedijës në lidhje me rëndësinë e arsimit gjatë gjithë jetës. Buxheti i alokuar për të financuar këtë prioritet ishte vogël sidomos për arrijtjen e synimit për inkudrit të grupeve të pafavorizuara. Ky program arsimor në shumë raste nuk ishte i ndërlidhur me ekonominë dhe punësimin dhe kapaciteti i institucioneve për të mbledhur të dhëna dhe informata ishte shumë i kufizuar. Inkudrimi i sektorit privat dhe promovimi i modaliteteve të bashkëpunimit ishte i kufizuar. Në anën tjetër, procedurat e certifikimit dhe akreditimit ishin të paqarta apo mungonin në tërësi. Për të adresuar këto sfida, PSAK kishte identifikuar 6 objektiva:

OBJEKTIVAT ARSIMIT TE RRITURVE DHE ARSIMIT JOFORMAL 2011-2016

- 1 Deri në vitin 2016 të gjitha ligjet dhe rregulloret mbi arsimin e të rriturve janë rishikuar, miratuar dhe zbatuar
- 2 Deri në vitin 2016 është zhvilluar një sistem funksional i ARR-së dhe AJF
- 3 Deri në vitin 2014 janë ndërtuar kapacitete të mjaftueshme administrative, profesionale dhe hulumtuese për ARR dhe AJF
- 4 Deri në vitin 2016 ekziston siguri i plotë i shërbimeve cilësore dhe efektive në ARR dhe AJF
- 5 Deri në vitin 2014 janë realizuar veprime të koordinuara në mes të MASHT-it dhe MPMS-së, MTI-së dhe MKRS-së, partnerëve socialë dhe komunave (me prani substanciale të komuniteteve minoritare dhe të grupeve të rrezikuara) në fushën e AARR –së
- 6 Deri në vitin 2014 sigurohet përkrahje substanciale financiare për ARR dhe AJF

Ndër sfidat primare në sistemin arsimor mbetet pjesëmarrja e ulët në arsimin gjatë gjithë jetës, ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për promovim të arsimit të të rriturve dhe siguri i financimit për këtë prioritet - deri më tani nuk ka skemë të financimit dhe formulë të financimit për arsimin e të rriturve. Funksionalizimi dhe ngritja e kapaciteteve të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit të të Rriturve si dhe Këshillit të Agjencisë është sfidë dhe kusht paraprak për krijimin e një qasje më koherente në arsimin e të rriturve, me qëllim bashkimin e të gjithë aktorëve relevant, si ofertuesit, ashtu edhe kërkesit e arsimit dhe aftësimi të të rriturve. Gjithashtu konsiderohet se nuk ka pasur kapacitete të kuadrove për të trajtuar nevojat e arsimit të të rriturve. Zbatimi i prioritetit të këtij nën-sektori është bërë kryesisht në suaza të arsimit profesional dhe zbatuar nga organizata jo-qeveritare dhe biznesore. Koordinimi i palëve të interesit, sektorit publik dhe atij privat është në nivelin e duhur. Kapacitetet për të monitoruar zhvillimet dhe ato të politikëbërjes janë të kufizuara si rezultat i mungesës së burimeve financiare. Shkalla e realizimit të planit në bazë të indeksit të zbatimit është paraqitur më poshtë:



9.1. Legjislacioni

Aktivitetet e MASHT gjatë vitit 2014 kanë qenë të orientuara në draftimin dhe miratimin e Udhëzimeve administrative që dalin nga Ligji për Arsim dhe Aftësim të rriturve (04/L-143). Si rezultat është draftuar dhe miratuar Udhëzimi administrativ (UA 11/2014) që rregullon përmbajtjen e kontratës për organizimin e AAR për kandidatë dhe punëdhënës. Me qëllim të inkurajimit të mësimit gjatë gjithë jetës, MASHT ka draftuar dhe miratuar Udhëzimin administrativ (UA 12/2014) për përjashtimet në moshë më rastin e regjistrimit për të rritur. Po ashtu, është draftuar dhe miratuar Udhëzimi administrativ (UA 13/2014) për planin vjetor të punës dhe planin zhvillimor të ofruesve të arsimit formal për të rritur. Në anën tjetër, një arritje e veçantë që ka relevancë edhe për këtë nënprogram është miratimi i Udhëzimeve administrative për njohjen e mësimit paraprak dhe ngritja e kapaciteteve të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve. Sfidë primare në aspektin legjislativ janë dispozitat kalimtare të Ligjit për arsim dhe aftësim për të Rritur dhe që ndërlidhen me financimin. Andaj, rekomandohet që AAR të futet si politikë e re në formulën e financimit për vitin pasues.

9.2. Kapaciteti administrativ

Pikësypnimet kryesore afatmesme në kuadër të këtij objektivi ka qenë ngritja e kapaciteteve institucionale, promovimi i arsimit profesional dhe ndërlidhja me ofertuesit jo-qeveritar në avancimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur. Në vitin 2014 MASHT ka miratuar Udhëzimin administrativ (UA 05/2014) që rregullon qëllimet, strukturën dhe përgjegjësitë e **Agjencionit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit të të Rriturve** (AAAPARR). Agjencia ka filluar së funksionuari dhe është në proces të konsolidimit. Këshilli i Agjencisë në anën tjetër formalizon pjesëmarrjen e akterëve institucional, tregut të punës dhe partnerëve social në politikëbërjen e arsimit profesional dhe përcaktimin e prioriteteve strategjike në kuadër të MASHT. Funksionalizimi i këtyre mekanizmave parashihet të ndikoj pozitivisht në krijimin e një qasje më koherente në arsimin profesional, të bashkoj të gjithë akterët relevant si ofertuesit ashtu edhe kërkuuesit e arsimit dhe aftësimit të të rriturve.

9.3. Shërbimet e arsimit për të rritur

Gjatë viteve 2011-2015 kanë vazhduar **zbatimi i projekteve për arsim dhe aftësim të të rriturve**. Në bashkëpunim me organizatën Vo-RAE është zbatuar projekti 'Shkrim Lexim për Gra dhe Vajza' i nivelit të parë (klasa 1-5) në gjashtë komuna të Kosovës: Fushë Kosovë,

Graçanicë, Gjiilan, Podujevë, Ferizaj, Prizren. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar zbatimi i projektit për shkrim-lexim për të verbërit (Braille) në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës. Si rezultat janë trajnuar 7 trajnerë të cilët do të punojnë në vazhdim dhe inicuar programi për orientim, lëvizje dhe shkathtësi të të verbërve me 40 pjesëmarrës nga Mitrovica, Peja, Ferizaj dhe Gjiilani.

Orientim tjetër i aktiviteteve të MASHT ka qenë **zhvillimi i programeve mësimore** për arsim kompenziv (klasa 6-9) për të rriturit. Arsimi kompenziv është zhvilluar në Prishtinë dhe Fushë Kosovë, ndërsa arsimi profesional është zhvilluar në të gjitha shkollat profesionale (teknike, ekonomike, bujqësore) në Kosovë. Në gjashtëmujorin e parë ka përfunduar faza e parë e projektit (viti shkollor) për arsimin kompenziv, që zhvillohet në kuadër të arsimit profesional në të gjitha shkollat profesionale (teknike, ekonomike, bujqësore) në Kosovë, ndërsa faza tjetër ka vazhduar nga muaji shtator. Po ashtu, është shpallë konkursi për regjistrimin e nxënësve në arsimin joformal, janë pranuar kandidatët dhe ka filluar mësimi në të gjitha shkollat profesionale të Kosovës. Janë trajnuar trajnerët për mësim kompenziv në komunën e Obiliqit të cilët punojnë me nxënësit që e ndjekin mësimin kompenziv.

Trajnimi i mësimdhënësve dhe stafit administrativ që punojnë me institucionet ofruese të arsimit për të rritur është aspekt i rëndësishëm në trajtimin e këtij prioriteti. Konform këtij synimi është themeluar grupi për hartimin e Programit për Trajnimin e mësimdhënësve që punojnë me të rritur në shkollat profesionale. Në bashkëpunim me DVV International janë zhvilluar programe adekuate për trajnimin e këtyre mësimdhënësve. Po ashtu, në bashkëpunim me DVV International, Ministrinë e Punës dhe Universitetin e Prishtinës janë organizuar trajnime për trajner për Qendra Rajonale të Trajnimit për 57 pjesëmarrës. Si element i rëndësishëm në këtë aspekt është kurrikulumin për mësimin dhe arsimin global për të rritur (CurriculumglobALE) i cili është përkthyer në gjuhën shqipe dhe i'u është ofruar të gjithë ofruesve të arsimit për të rritur. Si pjesë e këtyre aktiviteteve është edhe përkthimi, shtypja dhe shpërndarja e doracakut andragogjik për edukatorët e realizuar në bashkëpunim me DVV International dhe me mbështetje të GIZ dhe SDC.

Gjatë të njejtës periudhë ka vazhduar **promovimi i arsimit gjatë gjithë jetës**. Janë organizuar konferenca rajonale për arsimin gjatë gjithë jetës, është organizuar festivali i arsimit dhe aftësisë të të rriturve dhe është publikuar një broshurë kushtuar arsimit të rriturve dhe mësimin gjatë gjithë jetës. Në kuadër të javës së Arsimit për të rritur dhe mësimin gjatë gjithë jetës, është organizuar konferenca me 77 pjesëmarrës nga MASHT, Ministria e Punës, DKA dhe partnerët zhvillikor. Qëllimi i kësaj konference ishte përmirësimi i kordinimit ndër-institucional për arsimin dhe aftësimin e të rriturve. Gjatë panairit 'EduKos' janë promovuar dhe prezentuar aktivitetet e të rriturve në shkollat profesionale, qendrat rajonale të trajnimit dhe ofruesve të arsimit formal dhe joformal për të rritur. Panairi është ndjekur nga 1200 vizitorë.

9.4. Sigurimi i cilësisë

Një iniciativë kyçe ka qenë zhvillimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK). KKK lejon njohjen e mësimin paraprak, dhe potencialisht ofron një sistem kombëtar të njohjes së mësimin paraprak (RPL, e njohur edhe si validimi i të mësuarit jo-formal), të përfitimit të veçantë për nxënësit e rritur që mund të kërkojnë ti kenë aftësitë e tyre të njohura, të legalizuara dhe certifikuar pa pasur nevojë për të përsëritur të mësuarit. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, i cili menaxhon KKK, ka zhvilluar udhëzime kombëtare për njohjen e mësimin paraprak që mund të përdoret nga ofruesit e programeve të AAP, partnerët socialë, punëdhënësit, organizatat e punëdhënësve, punonjësit në sindikata, dhe organizatat që mbështesin punëkërkuarit. AKK ka zhvilluar Udhëzimin administrativ për Njohjen e Mësimin Paraprak dhe ka zhvilluar punëtori për zhvillimin e kornizës dhe infrastrukturës ligjore me specifike për akreditimin e ofruesve të AAP,

.....

me standardet kombëtare dhe me sistemet e monitorimit dhe rishikimit për zbatimin e NJMP - Njohjes së mësimin paraprak, në ndërlidhjet me udhëzimet evropiane. Gjatë vitit 2014, AKK ka organizuar 5 raunde të procesit të validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të institucioneve ofruese dhe vlerësuese për kualifikime të zhvilluara sipas standardeve të verifikuara kombëtare dhe ndërkombëtare.

9.5. Kordinimi ndër-institucional

Nuk ka ndonjë praktikë të zhvilluar të kordinimit ndërmjet palëve të interesit, duhet përqendruar në përmirësimin e mekanizmave për kordinim të aktiviteteve në kuadër të këtij prioriteti. Kordinimi ndërmjet akterëve duhet të përqëndrohet në kornizën e Këshilit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe të Rriturve në kuadër të nëngrupeve të punës. Mekanizmat e kordinimit duhet po ashtu të përfshijnë edhe përpjekjet për draftimin dhe zbatimin e një kornize të unisuar të performancës dhe planifikimit buxhetor. Me qëllim të **avancimit të kordinimit ndërmjet palëve të interesit**, MASHT në konsultim me Ministrinë e linjës, AKK, organizatat donatore dhe partnerët social janë pajtuar për të themeluar katër nëngrupe pune të cilat do të ndjekin proceset e zhvillimit të kapaciteteve të arsimit dhe aftësimin profesional dhe për të rritur. Këto nëngrupe punuese do të trajtojnë ceshtjet e tregut të punës dhe këshillimit në karrierë, kualifikimet dhe kurrikulat, sigurimin e cilësisë dhe arsimin e të rriturve. MASHT mbështet programet e DVV International për avancim të mësimin për të rritur dhe ndërmarrësinë në kuadër të projektit rajonal SEECEL.

9.6. Financimi

Financimi i arsimit të të rriturve është bërë kryesisht në bashkëpunim me partnerët zhvillimor. Ende nuk ka një përfshirje të arsimit dhe aftësimin profesional në formulën e financimit për arsim. Sidoqoftë, në vitet në vazhdim duhet të prioritetizohet gjetja e skemave kreative për bashkëfinancim të arsimit dhe aftësimin të të rriturve në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Ministrinë e Tregëtisë, Oden Ekonomike dhe partnerëve social. Pikësynimi në vazhdim duhet po ashtu të orientohet në stimulimin e kontributeve të industrisë në aftësim dhe arsim të të rriturve.

10. Teknologjia e informimit dhe komunikimit


Objektiva e përgjithëshme e nënsektorit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit është që të: *përkrahë dhe avancojë procesin e të nxënësve për të gjithë, duke bërë integrimin efektiv të TIK dhe duke forcuar e përshtatur përdorimin e TIK në sektorin e arsimit.*

OBJEKTIVAT E TIK2011-2016

- 1 Deri në vitin 2011 është hartuar dhe operacionale një Strategji për TIK
- 2 Deri në vitin 2016 është siguruar infrastruktura e duhur për TIK
- 3 Deri në vitin 2016 zhvillohen burimet njerëzore të afta për aplikimin e TIK
- 4 Deri në vitin 2016 hartimi i kurrikulave që integrojnë përdorimin e TIK dhe mësimin elektronik në harmoni me standardet ndërkombëtare

Sistemi arsimor ka qasje të ulët në teknologji të informimit dhe komunikimit dhe teknologjia bashkëkohore ende nuk është integruar në mënyrë të përshtatshme në kurrikulë, mësimdhënie dhe menaxhim të sistemit arsimor - zbatimi i strategjisë për inkorporim të TIK në mësimdhënie nuk ka shkuar me hapat e projektuar. Ngritja e cilësisë në të gjitha nivelet është e kushtëzuar nga aftësia e mësimdhënësve dhe nxënësve për të përvetësuar mjetet bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknologjisë. Pajisja e shkollave me kompjuter dhe lidhje me internet ka përparuar, mirëpo ende mbetet mbrapa shkallës së shtrirjes së tyre në nivel vendi. Përpjestimi kompjuter-nxënës në shkollat e Kosovës është 1:46, që paraqet një ngecje në raport me vendet e Bashkimit Evropian ku një kompjuter u shërben 3 deri në 7 nxënësve (EC, 2013). Pajisja e shkollave me pajisje adekuate për teknologji informative dhe kompjuter është ende larg cakut. Shkalla e realizimit të objektivave në bazë të indeksit është si më poshtë:

Figura 41: Shkalla e zbatimit të TIK 2011-2016: planifikuar (5) dhe realizuar



10.1. Strategjia për informim dhe komunikim

Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (TIK) është një fushë ndërsektoriale, e cila si synim kryesor ka integrimin e kësaj teknologjie në arsimin e Kosovës. Kështu synohet që përmes aplikimit të kësaj teknologjie të arrihet ngritja e përgjithshme e cilësisë së arsimit. MASHT-i, në kuadër të strukturës së vet organizative, ka pasur në plan themelimin e një departamenti të TIK-ut, që do të merrej me integrimin e kësaj teknologjie në sistemin e arsimit të Kosovës. Gjatë vitit 2013 nuk është arritur që të merret miratimi nga Ministria e Administratës Publike. MASHT-i ka kapacitete të kufizuara në udhëheqjen e proceseve në fushën e objektivit primar të këtij

nënprogrami është që TIK-ut që deri në fund të vitit 2014 kanë qenë të mbuluara nga përkrahja e ofruar nga donatorët. Qasje e barabartë në TIK cilësor të udhëhequr nga kërkesa e që plotëson nevojat individuale, shoqërore e ekonomike dhe i avancojnë qëllimet e gjithëpërfshirjes dhe të krijimit të barazisë.

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë së MASHT për e-Mësimin, ka vazhduar zbatimi i platformës edu.net dhe është funksionalizuar platforma Moodle për mësimdhënie. Me mbështetje nga Komisioni Evropian është hapur tenderi për pajisjen e shkollave për mjete mësimore dhe është punuar në instalimin dhe funksionalizimin e kabineteve të TIK. Microsoft ka mbështetur MASHT në sigurimin e licencave për softuer adekuat për përdorim në pajisjet e TIK në shkolla. Në aspektin e mirëmbajtjes, gjatë këtij viti janë themeluar Klubet Teknike të nxënësve në 25 shkolla.

10.2. Infrastruktura e TIK

Shkalla e përhapjes dhe shpërndarjes së TIK me qëllim të lehtësimit të gjithëpërfshirjes ka shënuar progres gjatë vitit 2014 në krahasim me vitin paraprak. Numri i shkollave me pajisje adekuate për TIK është rritur nga 467 sa ishte në vitin 2013 në 523 në vitin 2014. Kjo ngritje përmirëson përqindjen e shkollave me pajisje adekuate për teknologji të informimit dhe komunikimit në 44.4%. Në anën tjetër, përmirësimi i pajisjeve dhe shpërndarja e TIK ka rezultuar me përmirësim të proporcionit të kompjuterëve për nxënësit nga 1:51.4 sa ishte në vitin 2013 në 1:46.1 kompjuter për nxënësit. Numri i kompjuterëve në shkolla është ngritur nga 7657 në 8693. Po ashtu, listës prej 12913 staf të aftësuar për ECDL sa ishte në vitin 2013 i janë shtuar edhe 850 të tjerë në vitin 2014. Nga këto shifra rezulton që rreth 57% e stafit mësimdhënës është i trajnuar për përdorim të TIK.

Tabela 27: Shkalla e përdorimit të TIK në shkolla

	2012	2013	2014
Numri i shkollave me pajisje adekuate për TIK	467	523	523
Numri i kompjuterëve në shkolla	7657	7657	8693
Numri i shkollave me qasje në internet			415

10.3. Zhvillimi i burimeve njerëzore

Në bazë të të dhënave të MASHT, gjatë 2011-2015 janë ofruar dy trajnime relevante në lidhje me TIK: ECDL dhe E-Mësimi. Në kuadër të trajnimit European Computer Driving Licence janë trajnuar rreth 55 % përqind e mësimdhënësve. Nuk ka të dhëna në lidhje me atë se sa kanë kaluar këtë trajnim. Gjithashtu, është ofruar trajnimi E-Mësimi përmes të cilit janë trajnuar afërsisht 8 % përqind e mësimdhënësve për të integruar TIK në mësimdhënie.

Tabela 28: Trajnimet e mësimdhënësve në TIK

1	E-Mësimi	2011	2012	2013	2014	2015	Total
	Numri mësimdhënësve	1800	-	-	-	-	1800
	Orët (20 orë për trajnim)	36000	-	-	-	-	36000
	% e total mësimdhënësve	7.6%	-	-	-	-	7.6%
2	ECDL						
	Numri mësimdhënësve	5667	5667	727	750		12811
	Orët (88 orë për trajnim)	498696	498696	65976	6600		1067968
	% e total mësimdhënësve	24%	24%	3.1%	3.3%		55%

10.4. Integrimi i TIK në mësimdhënie

Është funksionalizuar platforma elektronike MODDLE dhe ka filluar publikimi i përmbajtjeve pedagogjike elektronike (projekt i financuar nga EU). Është krijuar platforma elektronike "Rrjeti i Arsimit të Kosovës" (ku është inkuadruar edhe MOODLE). Vazhdon projekti : "Modernizimi i sistemit arsimor në Kosovë përmes mesimit elektronik dhe digjitalizimit të provimit të maturës", ku është duke u punuar në digjitalizimin e Maturës Shtetërore dhe krijimine nje portali, ne kuader të të cilit përfshihen edhe softueret e mesimit elektronik për lëndën e TIK-ut dhe Ndërmarrësisë. Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit - Tëinning Project (i cili momentalisht mbështetet nga Finlanda dhe Austria) është bërë analiza e gjendjes në shkollat pilote për zbatimin e Kurrikulit të Ri lidhur me infrastrukturën e teknologjisë informative dhe mjetet mësimore, dhe në bazë të rezultateve të dala nga kjo analizë do të investohet në këto shkolla. Gjithashtu, projekti JAICA- përkrah MASHT-in në krijimin e një qendre të kompetencave duke ngritur kapacitetet njerëzore përmes trajnimeve të mësimdhënësve ne Japoni.

11. Financimi

11.1. Pasqyrë e përgjithshme

Sistemet dhe plani kontabël i buxhetit të Republikës së Kosovës ka filluar përpjekjet për futjen në përdorim të klasifikimit funksional të shpenzimeve publike në planifikim dhe në realizim. Aktualisht llogaritja e shpenzimeve sipas klasifikimit funksional bëhet në mënyrë manuale vetëm për pjesën e shpenzimeve të realizuara. Kjo llogaritje bëhet vetëm në mënyrë agregate, ndërsa për qëllime të monitorimit të shpenzimeve në sektorin e arsimit nevojitet që shpenzimet të paraqiten sipas nënkategorive funksionale që do të rezultonte me një paraqitje të shpenzimeve sipas secilit nivel të arsimit. Arsimi në COFOG njihet si kategori funksionale e qeverisë, ndërsa në kuadër të saj, janë nënkategoritë si në vijim:

1. Arsimi parafillor dhe fillor;
2. Arsimi i mesëm;
3. Arsimi i lartë jouniversitar;
4. Arsimi i Lartë
5. Arsimi tjetër
6. Shpërbimet dytësore (përkrahëse) për arsimin
7. Aktivitetet e Hulumtimit dhe Zhvillimi të Arsimit
8. Arsimi jo i klasifikuar tjetër në ndonjë kategori tjetër.

Klasifikimi funksional i sektorit të arsimit bazohet në Standardin Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit (ISCED) 1997. Përkundër përparësive të këtij klasifikimi, mangësia e tij është se ISCED 1997 nuk bën ndonjë ndarje të qartë ndërmjet arsimit të përgjithshëm dhe arsimit profesional, e që përpjekja për t'u arritur një gjë e tillë mund të shihet në ISCED 2011, mirëpo nuk janë të reflektuara në COFOG.

Kjo analizë e shkurtër financiare ka për qëllim ofrimin e një pasqyre të shpenzimeve totale në sektorin e arsimit sipas nënsektorëve të përcaktuar në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016. Për shkaqe të ndryshme që kanë të bëjnë kryesisht me mënyrën e buxhetimit në Kosovë, dhe kërkesave ekstensive për shpërndarjen e mjeteve nëpër kanale të ndryshme të përcaktuara me një numër ligjesh, ka bërë që sektori të defragmentohet në mënyrë horizontale dhe vertikale. Një defragmentim i tillë reflektohet edhe në sistemin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit për sektorin e arsimit, që nuk mundëson arritjen e rezultateve të sakta në lidhje me shpenzimet publike që bëhen në sektorin e arsimit e sidomos për nënsektorët e përcaktuar në PSAK 2011-2016.

Duke pasur parasysh këtë, për secilin nënsektor jepet një shpjegim i shifrave të dhënave si dhe efektit të mungesës të të dhënave financiare të cilat mund të merren parasysh në planifikimin strategjik të sektorit për periudhën e ardhshme.

11.2. Edukimi parashkollor (EPSH)

Struktura e nënprogrameve buxhetore në MASHT nuk ka ndonjë linjë të veçantë në formë të nënprogramit për planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit për arsimin parashkollor. Ndërsa në nivelin komunal, në kuadër të programit të Arsimit dhe Shkencës, ekziston nënprogrami "Arsimi Parashkollor" për buxhetimin e arsimit parafillor në Komunë ku bëjnë pjesë çerdhet, mirëpo nuk është e qartë se a përfshinë ky nënprogram edhe shpenzimet që bëhen për arsimin parashkollor që organizohet nëpër shkollat fillore dhe të mesme të ulëta.


Gjatë periudhës 2011 – 2014 në bazë të raporteve financiare të Komunave, struktura e buxhetit

për arsimin parafillor në Komuna nuk ka ndryshuar shumë përveç strukturës së pagave, gjë që tregon se komunat nuk kanë punuar në drejtim të shtimit të numrit të çerdheve nëpër territorin administrativ të mbuluar nga ato.

Tabela 29: Totali i shpenzimeve për EPSH 2011-2014

	2011	2012	2013	2014
Total	7,552,977	6,746,916	7,237,284	7,705,408
MASHT	1,196,228	343,910	307,733	311,349
Donatorët	236,410	212,009	233,113	282,555
Komunat	6,120,339	6,190,996	6,696,438	7,111,505
Numri i nxënësve(nivelikomunal)	25,479	25,579	25,522	25,791
Shpenzimetpërkokë(nivelikomunal)	240	242.04	262.38	275.74

Figura 42: Tendanca e shpenzimeve komunale per edukim parashkollor 2011-2014





11.3.Arsimi Parauniversitar

Shpenzimet Publike për Arsimin Parauniversitar përfshijnë totalin e shpenzimeve të gjithë nënsektorët e PSAK-ut që kanë të bëjnë me arsimin parauniversitar. Bazuar të në dhënat e shpenzimeve të realizuara për periudhën 2011 – 2014 shihet se ekziston një shpërndarje jouniforme e resurseve për nivele të ndryshme të arsimit në Kosovë. P.sh. përderisa në arsimin parashkollor, shpenzimet për kokë nxënësi në vitin 2014 janë 275.74 euro, shpenzimet për kokë nxënësi për arsimin fillor janë 345.66 euro ndërsa për arsimin e mesëm 459.29 euro. Ndërsa shpenzimet në nivel total parauniversitar për kokë nxënësi në vitin 2014 ishte 526.66 euro.

Tabela 30:Shpenzimet ne Arsim Parauniversitar

	2011	2012	2013	2014
<i>Nr. i nxënësve</i>	430,707	422,925	413,249	398,244
Gjithsej Shpenzimet e APU	182,545,769	190,619,27	186,720,600	209,738,693
Shpenzimet në APU si % e Shpenzimeve Qeveritare	9.30%	8.96%	9.03%	10.48%
Rrogat e Mësimdhënësve si % e Shpenzimeve në APU	69.33%	69.61%	71.12%	73.62%
Shpenzimet rrjedhëse si % e shpenzimeve në APU	80.28%	80.64%	83.14%	83.79%
Shpenzimet për kokë nxënësi	423.83	450.72	451.84	526.66
Shpenzimet për kokë nxënësi fillor	345.66	345.66	345.66	345.66
Shpenzimet për kokë nxënësi Arsimi i Mesëm	322.82	343.73	366.40	459.26

Totali i shpenzimeve të APU-së përbëhet nga totali i shpenzimeve të nënprogramit Arsimi Parauniversitar në MASHT dhe totali i shpenzimeve të komunave të buxhetuara në nënprogramin Arsimi dhe Shkenca. Në vijim është dhënë trendi i shpenzimeve të APU-së nga MASHT dhe Tendencia e Shpenzimeve në APU nga niveli komunal.



Në grafikun më lartë shihet se në vitin financimi i shpenzimeve kapitale në APUnë niveli qendror nga 74% sa ka qenë në 2012 ka rënë në 68% në vitin 2014. Shpenzimet kapitale në këtë rast nuk përfshijnë shpenzimet për libra të cilat buxhetohen në një program tjetër në kuadër të KASH-it.

Shënim: Duke pasur parasysh që të dhënat e dorëzuara nga MASHT për APU-në nuk janë të ndara sipas burimit të financimit, shpenzimet e nivelit qendror për APU mund të përfshijnë edhe shpenzimet e financuara nga donatorët e të kanalizuar për sistemit të Thesarit. Sidoqoftë, sipas raporteve të ndryshme, donatorët si GIZ, SDC, SHBA, EC kanë paraparë të shpenzojnë 27,200,641 euro në periudhën 2009 – 2017.

11.4 Arsimi profesional

Nevojitet analizë ekstensive dhe krahasim manual i të dhënave buxhetore për të nxjerrë një shifër të saktë të shpenzimeve të përgjithshme në arsimin profesional. Shkollat e mesme profesionale janë të buxhetuara në kuadër të nënprogramit “Arsimi i Mesëm” në nivelin komunal, ndërsa kohëve të fundit edhe në nivelin qendror, apo në MASHT është krijuar nënprogrami për Arsimin Profesional që përfaqëson Agjencinë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional që në vitin 2015 përfshinë edhe një numër shkollash të llojit të Qendrës së Kompetencës.

Sa i përket numrit të nxënësve në VET, sipas statistikave të arsimit është përgatitur tabela më poshtë:


Tabela 32: Numri i studenteve ne Arsim Profesional

<i>Nr. I Nxënësve</i>	106,877	105,549	103,241	94,216
<i>Nr. I Nxënësve në VET</i>	59,963	59,525	57,430	48,697
Përqindja e nxënësve të VET në totalin e numrin të Nxënësve në shkolla të mesme.	56.10%	56.40%	55.63%	51.69%

Për llogaritjen e shpenzimeve në arsimin dhe aftësimin profesional në nivelin komunal, përqindja e numrit të nxënësve është zbatuar në totalin e shpenzimeve komunale për arsimin e mesëm. Si rezultat të zbatimit të këtij shtytësi të koston në nivelin komunal është nxjerrë tabela në vijim:

Tabela 31: Shpenzimet ne Arsim Profesional

	2011	2012	2013	2014
Total	21,865,307	23,206,375	25,117,660	25,227,889
MASHT	53,089	276,011	283,147	288,243
Donatorët	2,454,916	2,470,094	3,792,052	2,575,179
Komunat	19,357,302	20,460,270	21,042,461	22,364,467
<i>Numri i nxënësve (niveli komunal)</i>	59,963	59,525	57,430	48,697
Shpenzimet për kokë	323	343.73	366.40	459.26
Shpenzimet në VET si % e Shpenzimeve Qeveritare	1.58%	1.54%	1.67%	1.68%
Shpenzimet në VET si % e BPV	0.46%	0.47%	0.47%	0.45%

Figura 45: Tendenca e Shpenzimeve në AAP 2011-2014

11.5. Arsimi dhe Aftësimi i Të Rriturve

Sipas të dhënave të dorëzuara nga njësitë përkatëse, MASHT-i për Arsimin dhe Aftësimin e të Arriturve gjatë periudhës 2011 – 2014 ka realizuar këto shpenzime:

Tabela 33: Totali i shpenzimeve në AAR

Të planifikuara	136,900	588,900	894,530	911,010
Të realizuara	870	8,007	5,410	48,580
% e Realizimit	0.64%	1.36%	0.60%	5.33%

Krahasimi i kërkuar i shpenzimeve në AARR me shpenzimet e përgjithshme në arsim rezulton me shifra shumë të vogla. Sidoqoftë, nga tabela më lartë shumë të shihet fenomeni shqetësues i realizimit të shpenzimeve për këtë nënsektor të PSAK-ut.

11.6. Arsimi i Lartë dhe Shkenca

Me gjithë faktin që ka qenë e paraparë me PSAK dhe me Ligjin për Arsimin e Lartë, Kosova akoma nuk ka zhvilluar një metodologji për financimin e institucioneve të arsimit të lartë që nxitë efektivitetin dhe llogaridhënien. Sidoqoftë, nga viti 2011, financimi për arsimin e lartë është në rritje, siç tregon tabela. Financimi është në rritje edhe si shumë nominale, por edhe si përqindje e bruto-produktit vendor dhe të buxhetit qeveritar. Në fakt, në vitin 2014, ky financim ka arritur në 0.91% të bruto produktit vendor me çka i është afruar mesatares së BE prej 1.13%.

Ndërkaq analiza e shpenzimeve publike për kokë studenti e dhënë në tabelën 8 është bërë duke i marrë parasysh vetëm studentët që studiojnë në njërin nga gjashtë universitetet publike të Kosovës, e që, në fakt, janë përfituesit e këtij financimi. Nga tabela 8 vërehet se shumica nominale e shpenzimeve publike për kokë studenti, fillimisht ka shënuar një rënie të lehtë, për të shënuar pastaj një rritje të lehtë gjatë vitit 2014. Megjithatë, brenda katër vjetësh kjo shumë është rritur vetëm për 2% dhe kjo si pasojë e përgjysmimit të pagesave për studentë dhe rritjes së pagave të mësimdhënësve universitarë. Ndërkaq, nëse shihet shpenzimi për kokë studenti si përqindje e BPV për kokë banori, vërehet një rënie e vazhdueshme gjatë katër vjetëve. Me këtë shkallë të

shpenzimit publik Kosova qëndron më mirë se vendet si Bullgaria (16%) dhe Rumania (19.7%), por më keq se Austria (35%), Danimarka (51%), Serbia(40.1%) dhe Moldova (41.8%).

Tabela 34: Shpenzimet në arsimin e lartë

Lloji i shpenzimit	2011	2012	2013	2014
Financimi në arsimin e lartë (mil. €)	34.63	37.62	41.02	50.76
Shpenzimet për arsim si % BPV	4.60%	4.70%	4.30%	4.70%
Shpenzimet për AL si % BPV	0.73%	0.77%	0.77%	0.91%
Shpenzimet për arsim si % BKK	15.50%	16.00%	15.70%	16.50%
Shpenzimet për AL si % BKK	2.45%	2.61%	2.79%	3.19%

Burimi: Rishikimi i përbashkët vjetor 2014

Tabela 35: Shpenzimet për kokë studenti

Lloji i shpenzimit	2011	2012	2013	2014
Shpenzimet për student (EUR)	689	661	646	703
Shpenzimet për student si % e BPV për kokë banorit	28.50%	24.89%	21.69%	21.48%

Burimi: Rishikimi i përbashkët vjetor 2014 (financimi i arsimit të lartë)

Si total, shpenzimet publike për arsimin e lartë janë në kufi të standardeve evropiane, ndërkohë që shpenzimet për kokë studenti janë në rënie, për shkak të shtimit të numrit të studentëve dhe rritjes së vazhdueshme të BPV. Nga ana tjetër, një analizë e të dhënave nga UP tregon se 73.7% e buxhetit institucional shpenzohet për pagat e të punësuarve, ndërkohë që institucioni ka mungesë të theksuar të personelit akademik. Si duket, institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë shumë pak i shfrytëzojnë mundësitë për krijimin e mjeteve vetanake gjë që është analizuar në cakun 6 dhe kjo shkakton presion tek buxheti i shtetit.

12. Rekomandime

12.1. Menaxhimi dhe llogaridhënia

Si rezultat i zhvillimeve demografike numri i nxënësve pritet të bie në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe plani i ardhëshëm duhet të përfshij obektiva rreth akomodimit të këtij zhvillimi përmes optimizimit të rrejtit të shkollave dhe optimizimit të numrit të mësimdhënësve -të dhënat e projeksioneve të popullësisë nënvizojnë një trend në rënie të numrit të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Ky zhvillim është vjen paralel me lëvizjet e mbrendshme të popullësisë nga fashti në qytet dhe nga njëra komunë në tjetrën. Rënia e numrit të nxënësve krijon parakushte për rritje të efijencës në sistem dhe kursime financiare. Objektivi i ardhëshëm duhet të konsitoj në optimizim të numrit të mësimdhënësve dhe optimizimit të numrit të shkollave. Kursimet nga arsimit parauniversitar do të mund të shërbenin për rritje të kapacitetit për rritje të përfshirjes në edukimin parashkollor.

Përmirësimi i sistemit të të dhënave statistikore dhe ndërlidhja e tyre është esenciale për të ngritur kapacitetin për planifikim të bazuar në evidencë dhe për monitorim të përformancës së sistemit arsimor -Sistemi për Menaxhim të Informatave në Arsim (EMIS) duhet të rishikohet në mënyrë që të sigurohet kapaciteti i shtuar teknologjik dhe strukturor për mbledhjen e të dhënave më të detajuara në lidhje me përformancën e nxënësit, mësimdhënësit dhe shkollës. Poashtu, sistemi i të dhënave në arsimin e lartë është pothuajse inekzistent. Zhvillimi i sistemit për të dhëna në arsimin e lartë duhet të jetë prioritet i planit të ardhëshëm. Ky sistem duhet të zhvillohet qoftë si mekanizëm i pavarur apo i integruar në kuadër të EMIS. Në anën tjetër, duhet përqëndruar vëmendja edhe tek zhvillimi i një sistemi për të dhënat në lidhje me kërkimin shkencordhe zhvillimit, mësimin tërëjetësor dhe ndërlidhjen e të dhënave me ASK dhe Ministrinë e Punës.

Duhet përmirësuar kapaciteti për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave aspektet sociale dhe gjinore që ndikojnë në regjistrimin dhe arritshmërinë e nxënësve dhe studentëve – Kapaciteti për të vlerësuar ndikimin e aspekteve të barazisë në regjistrim dhe arritshmëri të nxënësve është ende i kufizuar. Strategjia në vazhdim duhet të trajtoj me rëndësi të vecantë mbledhjen dhe analizimin e të dhënave rreth mundësive të barabarta në shkollim dhe aspekteve gjinore në politikë dhe arsimore.

Modërnizimi i sistemeve të vlerësimit të jashtëm të nxënësve dhe zbatimi i vazhdueshëm i modeleve ndërkombëtare të ekzaminimit ofron një input të vazhdueshëm për të informuar politikë-bërjen dhe mundëson bashkërendimin e qasjeve me sistemet bashkëkohore arsimore -rritja e kredibilitetit dhe integritetit të sistemit të ekzaminimit të jashtëm të studentëve duhet të jetë objektiv i vecantë në planin e ri. Palët e interesit duhet mendojnë aktivitetet dhe masat e domosdoshme për të siguruar që matja e rezultateve të të mësuarit jo vetëm të jetë në përputhje me standardet më të larta etike por të sigurohen që ato të kontribuojnë në zhvillimin e politikave për ngritje të cilësisë në shkollë. Krahas analizës së përgjithëshme, palët e interesit duhet të kujdesen që të ketë një mekanizëm periodik për analizim të rezultateve të arritshmërisë, faktorëve demografik, social, ekonomik dhe arsimor. Palët poashtu duhet të kujdesur që arsimit parauniversitar të inkorporoj rezultatet dhe konkludimet e analizës së rezultateve të PISA 2015.

Të avancohet kultura e sigurimit të cilësisë përmes vlerësimit të jashtëm të shkollave – Kosova ende nuk ka një proces sistematik për vlerësim të jashtëm të shkollave. Inspektorati i Arsimit duhet të mandatohet që të zgjeroj fushëveprimin e tij përtej aktiviteteve

tradicionale të monitorimit të ligjshmërisë. Plani i ri duhet të parasheh ndërtimin e strukturës institucionale dhe praktikës së vlerësimit periodik dhe ad-hoc të shkollave në nivelin parauniversitar. Ky proces duhet të përfshij vlerësim sistematik të aspekteve të menaxhimit të shkollës, menaxhimit financiar, zbatimit të kurrikulës, metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, kuadrit dhe kualifikimeve të mësimdhënësve, mjedisit mësimor dhe infrastrukturës, resurseve mësimore (teksteve dhe laboratorëve) dhe bashkëpunimit të shkollës me palët e interesit. Gjatë realizimit të këtij procesi duhet kujdesur që të tejkalohen ndeshjet e kompetencave me trupat përgjegjës për vlerësim të jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve të arsimit profesional. Krahas vlerësimit të jashtëm, vëmëndje duhet përqëndruar edhe tek promovimi i praktikës së menaxhimit të mbrendshëm të cilësisë dhe mbështetjes së shkollave në zbatimin e praktikës së vetë-vlerësimit.

Zbatimi i sistemit të vlerësimit të përformancës së mësimdhënësve, liencimit dhe skemës së promovimit është tejet i rëndësishëm si masë për rritje të cilësisë dhe llogaridhënies në sistemin e arsimit parauniversitar -procesi i licencimit të mësimdhënësve është inicuar qysh nga viti 2011 mirëpo i njëjti nuk është zbatuar në tërësi. Viteve të fundit janë përpiluar dhe miratuar udhëzimet administrative në lidhje me vlerësimin e përformancës dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve mirëpo ato ende mbesin të përpiluar në praktikë. Mos realizimi i skemës së promovimit të premtuar më herët mund të ketë dëmtuar kredibilitetin e procesit, sidoqoftë, plani i ri duhet të parasheh zbatimin e këtij procesi të domosdoshëm në hallken e sigurimit të cilësisë. Zbatimi i sistemit të vlerësimit të përformancës kërkon definimin e qartë të strukturës institucionale, rishikimin e udhëzimeve administrative për të siguruar një proces konsistent, eliminimin e praktikës së rritjes lineare të pagesave të mësimdhënësve dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm për mbështetjen dhe matjen e zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

Përmirësimi i cilësisë në arsimin parauniversitar kërkon masa të kordinuara për zbatim të Kornizës së Re të Kurrikulës -anipse kurrikula e re dhe kurrikula bërthamë janë inicuar që nga viti 2011, progresi në zbatimin e saj vazhdon të jetë i ngadalshëm. Vëmëndja e palëve të interesuara në planin e ardhshëm duhet përqëndruar tek zbatimi i kurrikulës në të gjitha shkollat. Procesi i zbatimit duhet të përcjellët me vlerësime të vazhdueshme në mënyrë që të kuptohen sfidat dhe mënyrat e lehtësimit të procesit për mësimdhënësit, nxënësit dhe shkollat në përgjithësi.

MASHT duhet të zhvilloj dhe zbatoj një formulë financimi që promovon përformancën në arsimin profesional, arsim të të rriturve, arsimin e lartë dhe shkencës – ende nuk ka një strukturë të unifikuar dhe model të financimit për arsimin e lartë dhe arsimin profesional. Formula e financimit duhet të kategorizohet në atë mënyrë që akomodon nevojat e ndryshme të profileve të arsimit profesional dhe promovon përformancën në arsim të lartë. Poashtu, MASHT duhet të shqyrtoj formën adekuate të ndërlidhjes së financimit të kërimit shkencor në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë për të inkurajuar si kërkimin shkencor ashtu edhe ndërlidhjen e edukimit, kërimit shkencor dhe inovacionit. Ende nuk ka provizione të qarta në lidhje me modalitetet e financimit publik të arsimit tërëjetësor. Plani i ardhshëm duhet të konsideroj ketë prioritet dhe të promovoj mekanizmin e ko-financimit të arsimit tërëjetësor.

Duhet kushtuar vëmëndje më të madhe ndërtimit të kapacitetit për dialog ndër-etnik dhe toletancë në kuadër të sistemit arsimor -strategjia e re duhet të listoj masa drejt jetësimit të provizioneve të Strategjisë për Vëtë-qeverisje Loake (2016-20126) e cila përkushtohet në ndërtimin e kapacitetit komunal për të promovuar dialogun dhe tolerancën ndër-etnike përmes sistemit arsimor, diversitetit gjuhësor, promovim të multikulturalizimit dhe të drejtave të

njeriut dhe platforma që stimulojnë bashkëpunimin e fëmijëve të komuniteteve të ndryshme në Kosovë.

12.2. Përfshirja në sistemin arsimor

Investimi në edukimin parashkollor është parakusht themelor për të rritur cilësinë në nivelet pasuese arsimore dhe në përmirësim të arritshmërisë së nxënësve - kthimi në investim arsimor në fëmijëri të hershme është më i lartë në faza të hershme të zhvillimit të fëmijëve. Sic demonstron nga analiza tematike rreth edukimit parashkollor, shkalla e përfshirjes së në këtë nivel edukimi është shumë e ulët krahasuar me nivelet tjera dhe shumë e ulët krahasuar me trendet rajonale, BE dhe vendet e OECD. Prioritet kyç në objektivat e ardhshme të PSAK 2017-2021 duhet të jetë rritja e përfshirjes së fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç dhe 0-3. Shkalla e përfshirjes së grup-moshave 3-5 duhet të rritet nga 29% aktualisht në 50% deri në vitin 2020. Rritja e përfshirjes nuk trajton domosdoshmërisht elementin e cilësisë. Andaj, objektivi për rritje të përfshirjes duhet të bashkërendohet me aktivitetet paralele për rritje të cilësisë dhe kualifikimeve të mësimit, zbatimit të metodave bashkëkohore të mësimit dhe zhvillimit të një sistemi të qëndrueshëm për sigurim të cilësisë. Kërkohet më tepër përqendrim në rritjen e përfshirjes së komuniteteve jo-shumicë në edukim të hershëm dhe edukim parashkollor.

Rritja e përfshirjes së komunitetit RAE në të gjitha nivelet e arsimit mbetet sfida në arritjen e përfshirjes universale dhe duhet të vazhdojë të jetë prioritet në vazhdim – nxënësit e komunitetit RAE kanë përfshirje të ulët në edukim parashkollor dhe arsim të lartë dhe ende mbeten sfida në arsimin fillor, mesëm të ulët dhe mesëm të lartë. Plani i ardhshëm duhet të parashihë zhvillimin e një mekanizmi të qëndrueshëm në kuadër të MASHT për të promovuar gjithëpërfshirjen dhe nivelizimin e shkallës së regjistrimit tek të gjitha komunitetet në Kosovë. Në këtë proces, duhet siguruar parakushte për mbështetje të vazhdueshme, rritje të vetëdijësimit, ofrimit të masave lehtësuese financiare dhe trajtimin e fenomenit të braktisjes së shkollimit. Poashtu, duhet siguruar masa shtesë për të inkurajuar përfshirjen e këtij komuniteti në nivele më të larta arsimore – mesëm të lartë dhe arsim të lartë.

Duhet mbështetur jetësimin dhe funksionalizimin e plotë të ekipeve komunale për parandalim të braktisjes së shkollave për të ofruar asistencë fëmijëve nga grupet e ndjeshme shoqërore sipër të parandaluar braktisjen ashtu edhe për të adresuar regjistrimin e ulët në shkollim.

12.3. Relevanca dhe ndërlidhja e arsimit me tregun e punës

Kurrikula e arsimit profesional duhet të jetë e ndërlidhur ngushtë me kërkesat dinamike të tregut të punës - kurrikula e arsimit profesional duhet të diferencohet qartë dhe të inkorporojë qasjen modulare dhe të bazuar në profile që shtojnë shanset për punësim dhe ndërveprim me tregun e punës. Profilet e ofruara në kuadër të shkollave profesionale duhet të jenë subjekt i shqyrtimit përmes mekanizmit të vlerësimit të jashtëm. Inkorporimi i kërkesave të tregut të punës përmes reformimit të kurrikulave dhe profileve është parakusht esencial për zhvillim të arsimit profesional. Ky proces duhet të realizohet edhe duke fuqizuar dhe ngritur institucione dhe këshilla për bashkërendim ndërmjet ministrive të linjës dhe akterëve institucional me ndërmarrjet dhe partnerët social. Natyrisht, zhvillimi i profileve të reja duhet të mbështetet në një proces të kompletuar të standardeve të profesionit dhe në mekanizma të qarta për monitorim të kërkesës në tregun e punës.

Kurrikulat dhe programet e arsimit të lartë duhet të mbështeten në kërkesat për shkathtësi në tregun e punës - nuk ekzistojnë standarde të operimit për shqyrtim të

kurrikulave dhe programeve të arsimit të lartë dhe ndërlidhjes së tyre me tregun e punës. Numri më i madh i studentëve dhe programeve arsimor janë në kategorinë e shkencave shoqërore dhe studimit të së drejtës. Në bazë të indikacioneve fillestare oferta programore është më tepër e dhënë kah ofrimi i atyre programeve që nuk garantojnë rritje të produktivitetit të fuqisë punëtore në sektorët esencial ekonomik. Institucionet duhet të inkurajohen të riorientojnë përqëndrimin e tyre strategjik në fushat deficitare. Në anën tjetër, MASHT duhet të përfshijë provizionë në formulë të financimit që mundësojnë ribalancimin e strukturës programore dhe numrit të studentëve sipas zhvillimeve në treg.

12.4. Rekomandimet nënsektoriale

Edukimi parashkollor		
Prioriteti	Aktivitetet	Rezultatet
1.1 Të rritet përfshirja në edukimin parafillor (5)	Të bëhet analiza e fizibilitetit për të studiuar ngecjet në pjesëmarrje në edukim parashkollor konform dispozitës së LAP që edukimi parashkollor të jetë i obligueshëm.	Është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në edukimin parashkollor (5 vjec) nga 75% në 90%
1.2 Të rritet përfshirja në edukimin parashkollor (3-4)	- Që të fitohet një pasqyrë më e mirë e gjendjes në edukimin parashkollor është e nevojshme të mblidhen me rregull të dhënat nga institucione parashkollore private dhe ato me bazë në komunitet - Partneritetet publike-private duhet të shihen si zgjidhje e mundshme për zgjerimin e kapaciteteve të edukimit parashkollor, në veçanti për grup-moshën 0-6. - Të kërkohen modalitete për mbështetje të qendrave me bazë në komunitet, me theks të veçantë në ato që i shërbejnë grupet e marginalizuara - Të promovohet dhe investohet për përfshirje të komuniteteve jo-shumicë në edukim parashkollor	Është rritur pjesëmarrja e fëmijëve (3-4 vjec) në edukim parashkollor nga 18% në 35% Është rritur pjesëmarrja e përgjithëshme në edukimin parashkollor dhe parafillor (3-5) nga 26% në 43%

Arsimi Parauniversitar		
Prioriteti	Aktivitetet	Rezultati
2.1 Të përmirësohet arritshmëria dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë	- Të analizohen me kujdes rezultatet kombëtare në testin e maturës dhe semi-maturës dhe konkluzionet të përdoren në përmirësim të sistemit. - Të analizohen rezultatet e PISA për të dokumentuar faktorët kyq në arritshmëri të nxënësve. - Të përmirësohen administrimi i testeve përmes digjitalizimit dhe përmirësimit të përmbajtjes konfirm kurrikulës së re arsimore. - Të ngriten kapacitetet e Inspektoratit të Arsimit si mekanizëm kyq në sigurim të jashtëm të cilësisë dhe të lansohen praktikatat e vlerësimit sistematik të shkollave për të analizuar arritshmërinë dhe	Është përmirësuar arritshmëria e nxënësve dhe llogaridhënia në arsim

2.2 Të përshpejtohet ritmi i zbatimit të kurrikulës së re	proceset. - Të finalizohet Strategjia e Sigurimit të Cilësisë - Të formohen grupet profesionale të arsimit në nivel komunal për të shkëmbyet praktikat e mira dhe avancuar zbatimin e kurrikulës së re. - Të ngriten kapacitetet e DKA-ve për të planifikuar dhe zbatuar kurrikulën e re. - Të nxitet bashkëpunimi ndërmjet shkollave pilot dhe atyre në pritje të zbatimit të kurrikulës së re. - Të përmirësohet monitorimi dhe mentorimi në shkollat pilot. Rezultatet e monitorimit janë shumë me rëndësi për të bërë të mundur që kurrikula e re të shtrihet edhe në shkollat e tjera të Kosovës, duke marrë parasysh se kjo kërkon shpenzime domethënëse buxhetore	Është rriur numri i shkollave që zbatojnë Kurrikulën e Re
2.3 Të finalizohet procesi i bartjes së përgjegjësiave financiare tek shkollat	- Të rishikohet softueri për formulën e financimit - Të rishikohet Udhëzimi Administrativ për formulën e arsimit - Të ngriten kapacitetet e DKA-ve dhe shkollave për menaxhim dhe raportim financiar - Të lansohet një studim për procesin e optimizimit të mësimdhënësve dhe infrastrukturës si përgjigje ndaj rënies së numrit të nxënësve.	Është rritur përgjegjësia e shkollave në menaxhim financiar
2.4 Të përmirësohet gjithëpërfshirja në arsim dhe trajtohen rastet e braktisjes së shkollimit	- Te komuniteteti rom, ashkali dhe egjiptian përqendrimi duhet të jetë në nxitjen e pjesëmarrjes në shkollimin e mesëm të lartë. Kjo mund të bëhet duke mbështetur nismat e shumta të partnerëve zhvillimorë për dhënien e bursave dhe ofrimin e mentorimit për nxënës, si dhe duke vazhduar mbështetjen e MASHT për qendrat mësimore të komuniteteve, e me qëllim të avancimit të njohurive dhe shkathtësive të përfituesve. - Te komunitetet tjera të integruara në sistemin arsimor të Kosovës duhet punuar në sigurimin e kushteve për zhvillim të mësimin në gjuhën amtare, si dhe në zbatimin e kurrikulës së re në shkollat me mësim në këto gjuhë	Të gjithë nxënësit janë përfshirë në sistemin e arsimit para-universitar dhe përmirësuar përfshirja e komuniteteve në arsim
2.6 Të përmirësohen mekanizmat e sigursë në shkolla dhe të promovohet shëndeti në shkolla	Të investohet në përmirësimin e infrastrukturës së sigursë në shkolla dhe të sigurohet një qasje më e avancuar e koordinimit ndërsektorial dhe ndërinstitucional në parandalimin e dhunës në shkolla dhe të vazhdoj promovimi i praktikave të mira shëndetësore. Këto masa duhet të zbatohet paralelisht me investimet infrastrukturale në ndërtimin dhe renovimin e objekteve shkollore	Janë krijuar mjedise miqësore dhe të sigurta për mësimdhënie dhe shkollat bëhen promovuese të shëndetit

Arsimi Profesional

Prioriteti	Aktivitetet	Rezultatet
3.1 Zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve për arsim profesional dhe ngritja e sistemit tëmbikqyrjes, koordinimit, dhe	Të ngritet përkushtimi për të funksionalizuar Këshillin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe mekanizmave tjerë që sigurojnë kordinim dhe bashkëpunim ndërmjet shkollave profesionale dhe bizneseve duke themeluar këshilla dhe nën-këshilla industriale si në nivel kombëtar ashtu	Është harmonizur korniza institucionale dhe bashkërendimipalëve të interesit në arsim profesional

<i>bashkëpunimit mes tyre si dhe me grupet e interesit/bizneset</i>	edhe në nivel lokal. ▪ Mbështetje në zhvillimin e kapaciteteve për Agjencinë për Arsim Profesional dhe Aftësim të Rriturve ▪ Fuqizimi dhe funksionalizimi i strukturave për aftësim profesional (vendosja e qartë e bazës ligjore, detyrave dhe përgjegjësive, llogaridhenjes, nevojës për hartimin e planës së punës dhe raportimit të rregullt për rezultatet e tyre etj. ▪ Të themelohen dy Qendrave të reja të Kompetencës të dy shkollave aktuale profesionale në Prizren dhe Prishtinë. ▪ Çështja e kornizës së vlerësimit të performancës së arsimit profesional dhe aftësimit të të rriturve duhet të trajtohet në kuadër të zbatimit të Procesit të Torinoës. ▪ Gjithashtu, konform rekomandimeve të studimit Vizioni për Skathtësi në Kosovë 2020, duhet të shqyrtohet mundësia që arsimi profesional, trajtimi profesional dhe aftësimi profesional të realizohet në kuadër të një kornize kombëtare të harmonizuar për avancimin e shkathtësive	
<i>3.2 Zhvillimi i sistemit për analizë të kërkesave në treg</i>	▪ Kërkohet zbatimi i mekanizmave për parashikim të kërkesave në treg duke u bazuar në anketimin e punëmarrësve dhe punëdhënësve.	Është përmirësuar ndërlidhja e arsimit profesional me tregun e punës
<i>3.3 Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë</i>	▪ shtrirje dhe zgjerim të fushëveprimit të zbatimit të sistemit edhe në institucione të arsimit profesional. ▪ Aktivitete vetedijësimi të institucioneve, studentëve dhe mësimdhënësve në lidhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve. ▪ Avancimi i zhvillimit të udhëzimeve për zbatim të kornizës dhe harmonizim të saj me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. ▪ Duhet të shtohen përpjekjet për të mbështetur shkollat që të funksionalizojnë zyrat dhe proceset e mbrendshme të sigurimit të cilësisë. ▪ Hartimi standardeve të reja profesionit dhe rishikimi i atyre ekzistuese gjithashtu për të mundësuar krijimin e kushteve për të filluar procesin e akreditimit të shkollave. ▪ Rishikimi i dokumentit për klasifikimin e profesioneve. ▪ Duhet të rishikohet skema e financimit të shkollave të arsimit profesional me qëllim që të ndryshohet formula e financimit - duke njohur dallimet në kërkesa për të financuar shkollimin e profileve të ndryshme	Është rritur cilësia dhe arritshmëria e nxënësve në arsimin profesional Arsimi profesional është bërë orientim tërheqës për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë
<i>3.4 Aftësimi dhe trajnimi i</i>	▪ në avancim të kualifikimeve përmes zhvillimit të	Është përmirësuar cilësia e

<i>mësimdhënësve</i>	një programi të vecantë master në arsim profesional në Fakultetin e Edukimit/Universiteti i Prishtinës. duhet draftuar një kalendar të ri të trajnimeve dhe alokuar resurse shtesë për aftësimin dhe ritrajnimin e mësimdhënësve të rinj dhe ata aktual në mjeshtri pedagogjike dhe mjete të mësimdhënies	mësimdhënies dhe arritshmëria e nxënësve
<i>3.5 Promovimi dhe zhvillimi i praktikës profesionale</i>	- Funksionalizimi i Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional do të ishte hap vendimtar për të avancuar këtë prioritet. - Pjesëmarrja e hisedarëve nga tregu i punës dhe formimi i këshillave dhe nënkëshillave lokal jo vetëm që do të ishte hap pozitiv për të dhënë sinjalet e duhura për zhvillim të kurrikulës por në të njëjtën kohë do të stimulonte përkushtimin e industrisë për të lidhur partneritete me shkolla për zbatim të praktikës profesionale. - Duhet të inkurajohet edhe modeli i kordinimit lokal ndërmjet shkollave dhe industrisë - të rritet numri i organizatave dhe bizneseve që ofrojnë mundësi për punë praktike, duhet rritet mbështetja për zhvillim të kapaciteteve të brendshme për punë praktike, të ofrohet mirëmbajtje për laboratore dhe të sigurohet që kemi zbatim të praktikës profesionale në kuadër të kurrikulës. - Ngritja dhe trajnimi i instruktoreve të mjaftueshëm për tu angazhuar në ndërmarrje por edhe në shkolla profesionale. - Krijimi i incentivave për ndërmarrjet të cilat sigurojnë bashkëpunim me shkollat profesionale	Është përmirësuar orietimi i nxënësve në tregun e punës dhe siguruar ndërlidhje ndërmjet kërkesës dhe ofertës në tregun e punës.
<i>3.6 Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të orientimit dhe këshilldhënies në karrierë</i>	- Zhvillimin e një modeli të integruar për orientim në karrierë dhe të përgatiten programe dhe standarde të qarta dhe ngritja e kapaciteteve për shkollat të cilat e kanë këtë model. - Aftësimi dhe trajnimi i stafit arsimor i angazhuar në orientim në karrierë - nga 6 % sa është aktualisht në 8%.	Është lehtësuar tranzicioni i nxënësve në tregun e punës

Zhvillimi Profesional i mesimdhenesve

Prioritetet	Aktivitetet	Rezultati
<i>4.1 Të zbatohet projekti i ri-kualifikimit të mësimdhënësve</i>	Të zbatohet projekti i rikualifikimit të 2000 mësimdhënësve me shkollë të lartë profesional dhe shkollim të mesëm në nivelin baqelor në Fakultetin e Edukimit konform udhëzimit administrativ mbi normativin e mësimdhënësve	Përmirësim i cilësisë së mësimdhënies dhe arritshmërisë së nxënësve

4.2 Të përmirësohen mekanizmat e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve	- Të avancohet zhvillimi i planeve shkollorë/komunale për zhvillim profesional të mësimitdhënësve konform udhëzimit administrativ për financim të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve. - Paralelisht të përshpejtohet procesi i trajnimit të mësimitdhënësve për zbatim të kurrikulës së re, metodave të vlerësimit, qasjes në mësimitdhënie dhe inkorporim të teknologjisë informativ në mësimitdhënie	Përmirësim i metodave të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies.
4.3 Të zbatohet sistemi i vlerësimit të përformancës dhe licencimit të mësimitdhënësve	- Të zbatohet sistemi i vlerësimit të mësimitdhënësve dhe të ndërlidhet me sistemin e licencimit dhe gradimit. - Duhet shmangur praktika e rritjes linerare të pagesave meqë kjo dëmton procesin e rritjes së cilësisë dhe llogaridhënies	Është rritur motivimi i mësimitdhënësve në procesin arsimor
4.4 Të bëhet optimizimi i numrit të mësimitdhënësve	- Si rezultat i efektit të rënies së shtimit natyror numri i nxënësve është në rënie të ndieshme. Të lansohet një studim më gjithëpërfshirës për mundësinë e optimizimit të numrit të mësimitdhënësve dhe rialokimit të burimeve njerëzore nga niveli fillor/mesëm në nivelin parafillor dhe parashkollor. - Një proces i tillë mund të zbatohet përmes mos zëvendësimit të mësimitdhënësve që dalin në pension (rreth 450 në vit). Duhet rritur norma e mësimitdhënies në krahasim me praktikatat evropiane	Është krijuar një politike koherente e rregullimit të proporcionit nxënës-mësimitdhënës dhe normës së mësimitdhënies.
4.5 Të nxjerret politika e pensionimit të parakohshëm të mësimitdhënësve me pengesa fizike dhe sociale	- Të shqyrtohet mundësia e lansimit të një projekti për tërheqje të mësimitdhënësve me pengesa fizike, në të pamur dhe në dëgjim nga kuadri mësimitor përmes pensionimit të parakohshëm. - Kjo duhet diskutuar me Ministrinë e Punës dhe SBASHK. Të pilotohet në vetëm për rastet më kritike mbi 55 vjeç përmes ofrimit të 75% të pagesës deri në arrijtje të moshës së pensionimit.	Është reduktuar humbja në procesin e mësimitnxënies dhe përmirësuar arritshmëria e nxënësve.

Arsimi i lartë

Prioriteti	Aktivitetet	Rezultati
5.1 Të modernizohet qeverisja e arsimit të lartë	- Të miratohet/zbatohet Ligji i rishikuar për Arsim të Lartë - Të miratohet/zbatohet Ligji për Profesionet e Rregulluara - Të rishikohet/zbatohet Ligji/udhëzimi administrativ për kërkim shkencor - që stimulon investimet e kërkimit shkencor; - Të hartohet/miratohet korniza ligjore për inovacion dhe të finalizohet Strategjia për Inovacion - Të rishikohet/rishikohet Strategjia për Arsim të Lartë (në kuadër të PSAK apo si dokument në vete); - Të zhvillohet/rishikohet Programi kombëtar i	Është përmirësuar likapaciteti për politikë-bërje në arsim të lartë dhe kërkim shkencor

	Shkencës për një cikël të ri kohor 2016-2020	
<i>5.2 Të avancohet cilësia në arsim të lartë dhe kërkim shkencor</i>	▪ Zbatimi i plotë i Udhëzimeve Standarde të Cilësisë (ESG) dhe kriteret e anëtarësimit në ENQA; ▪ Të definohen dhe fuqizohen rolet e ndryshme të mekanizmave involvues (MASHT, AKA, Inspektoriati i Arsimit) në Sigurim të Cilësisë; ▪ Të promovohet dhe mbështetet sigurimi i cilësisë së brendshme përmes inkurajimit të kulturës së cilësisë në kurrikula, staf akademik, infrastrukturë, studentë, etj; ▪ Të zhvillohet dhe implementohet sistemi i të dhënave në arsimin e lartë (SMIAL); ▪ Të ndërtohet një sistem informacioni për kërkim shkencor dhe zhvillim; ▪ Të draftohet sistemi i indikatorëve global (lokal, BE dhe OECD) për arsimin e lartë; ▪ Të sigurohen të dhëna për statutin e studentëve dhe outputit të arsimit të lartë përmesurvejimeve (OECD PIAAC); ▪ Të përqendrohet tek rritja e numrit të të diplomuarve dhe të bëhet një studim më i thellë që dokumenton pengesat në diplomim ▪ Të përmirësohet raporti optimal ndërmjet stafit akademik dhe stafit administrativ për kokë student	Janë përmirësuar mekanizmat që mundësojnë arritshmëri të studentëve dhe është rritur numri i të diplomuarve Është rritur llogaridhënia dhe transparencja e institucioneve të arsimit të lartë
<i>5.3 Të ndërlihet oferta e arsimit të lartë me kërkesat e tregut</i>	▪ Të realizohet studim i thellë në artikullim të kornizës për profilizim të universiteteve publike dhe institucioneve tjera në arsimin e lartë duke konsideruar mundësitë potenciale për zhvillim të rajoneve të caktuara të Kosovës; ▪ Të realizohet studimi parashikues për shkathtësi për të inkuorporuar perspektivën qeveritare, sektorit privat dhe vendore e rajonale në zhvillim të programeve arsimore ▪ Këshilli i Arsimit të Lartë - të institucionalizohet grupi këshilldhënës në kuadër të projektit të TLP/USAID si trup institucional për kordinim ndërmjet palëve të interesit në arsimin e lartë përfshirë MASHT, institucionet e arsimit të lartë, partnerët social, industrinë dhe bizneset. ▪ MASHT duhet të rrisë mbështetjen dhe të promovojë edhe themelimin e qendrave për transfer të njohurisë dhe qendrave të karrierës në institucione të arsimit të lartë. ▪ Rekomandohet që të mbështeten iniciativat 'triple-helix' për bashkëpunim ndërmjet hulumtimit, industrisë dhe institucioneve të arsimit të lartë në kuadër të klasterëve industrial (SEE 2020) ▪ Të mbështeten institucionet e arsimit të lartë dhe ato të arsimit profesional në krijimin e qendrave të transferit të njohurive, themelimit të inkubatorëve për trajnim në ndërmarrësi dhe start-ups dhe të	Është përmirësuar ndërlihdja e kërkesës së tregut të punës me ofertën arsimore Shkathtësitë e përfituara në arsimin e lartë janë në harmoni me kërkesën dhe kontribuojnë në rritje ekonomike

	inkurajohen programet akademike dhe profesional përmes partneritetit të përbashkët institucione arsimore dhe industri.	
5.4 Të përmirësohet menaxhimi dhe shkalla e financimit në arsimin e lartë dhe kërkim shkencor	- Zhvillimi dhe miratimi i konceptit dhe formules për financim të arsimit të lartë - të miratohet një formë financimi që promovon rezultatet dhe performancën, zhvillimin dhe konkurrueshmërinë, dhe të bëhet formalizimi i saj me akt (nën)ligjor. Në këtë kuadër të shqyrtohet incentiva strukturore përmes formulës së financimit - financim të përgjithëshëm për profile deficitare dhe financim të pjesëshëm për profile suficitare. - Zbatimi i zotimit ligjor për alokim të 0.7 % e buxhetit qeveritar në kërkim shkencor dhe zhvillim; - Krijimi i fondit për inovacion (i cili parashihet në draft startegjinë për Inovacion) dhe formalizimi i tij përmes kornizës ligjore (ligjit për inovacion, apo ndonjë akti tjetër nënligjor);	Është përmirësuar efikasiteti dhe llogaridhënia në arsimin e lartë
5.5 Të avancohet ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor	- Të finalizohet anëtarësimi i plotë në Zonën Europiane të Arsimit të Lartë/Bolonjë; - Ratifikimi dhe Zbatimi i plotë i Konventës së Lisbonës për Njohje të Kualifikimeve si brenda rrjetit ENIC-NARIC ashtu edhe përmes marrëveshjeve bilaterale dhe fuqizim të kapaciteteve për njohje të kualifikimeve jo-formale; - Themelimi i Konferencës së Rektorëve - institucion joqeveritar dhe dy dhoma përfaqësimi (institucionet publike dhe institucionet private); - Anëtarësimi i institucioneve të arsimit të lartë të Kosovës në Asociacionin e Universiteteve të Europës (EUA); - Themelimi dhe funksionalizimi i Unionit të Studentëve të Kosovës dhe anëtarësimi i tij në Unionin e Studentëve të Europës; - Promovimi i programeve ndër-kufitare përmes Erasmus Plus, përfshirë edhe programet që promovojnë diploma të përbashkëta; - Promovimi i mobilitetit të brendshëm dhe të jashtëm të studentëve, stafit akademik dhe kërkuesve përmes skemavë të ndryshme mbështetëse; - Ofrimi i programeve dhe moduleve studimore në gjuhë të huaja (posaqërisht angleze) sidomos për ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve për të mundësuar mobilitetin e studentëve, stafit akademik dhe hulumtuesve nga vendet e tjera në Kosovë; - Përgatitjet për aplikim për status të Asociuar në Horizon 2020; - Mbështetje institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë dhe kërkimore për t'u anëtarësuar në EIRMA (Asociacioni Evropian për Hulumtime	Sistemi i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor i integruar në institucionet dhe rrjedhat globale

	Industriale dhe Menaxhment), EARMA (Asociacioni Europian për Menaxhuesit dhe Administruesit e Kërkimit), Asociacionin Evropian të Organizatave të Hulumentit dhe Teknologjisë (EARTO), Iniciativën BusinessEurope, Asociacionin e Universiteteve Evropiane (EUA) dhe Tryzën Evropiane, etj; ▪ Mbështetje e institucioneve (përmes informimit, trajnimeve, granteve, etj) për të aplikuar në programe ndër-kufitare të kërkimit shkencor përmes Horizon 2020; ▪ Ofrimi i granteve për projekte të përbashkëta kërkimore me vendet e rajonit dhe ndërkombëtare;
<i>Implikimet buxhetore</i>	9 € million

Arsimi i te rriturve

Prioriteti	Aktivitetet	Rezultatet
<i>6.1 Të rritet financimi për arsimin e të rriturve</i>	▪ Të zhvillohet një formulë e financimit dhe përfshirje e këtij prioriteti në buxhetin e MASHT 2015/2016 si dhe gjetja e formave për krijimin e skemave për bashkëfinancim të arsimit me institucionet tjera dhe partnerët social	Është rritur përfshirja e të rriturve në arsim
<i>6.2 Të fuqizohen kapacitetet institucionale për kordinim të palëve të interesit</i>	▪ Duhet përqendruar në përmirësimin e mekanizmave për kordinim të aktiviteteve në kuadër të këtij prioriteti. Kordinimi ndërmjet akterëve duhet të përqëndrohet në kornizën e Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe të Rriturve në kuadër të nëngrupeve të punës. ▪ Mekanizmat e kordinimit duhet po ashtu të përfshijnë edhe përpjekjet për draftimin dhe zbatimin e një kornize të unisuar të performancës dhe planifikimit buxhetor. ▪ Të sigurohet bashkëpunimi mes ekonomisë, shkollave dhe nivelit lokal përmes fushatave, panairove, konferencave etj	Është rritur kapaciteti për politikë-bërje dhe zbatim të politikave.
<i>6.3 Të avancohet sistemi i sigurimit të cilësisë</i>	▪ mbështetjen e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve për të zhvilluar kapacitetet për shtrirje dhe zgjerim të fushëveprimit të akreditimit të ofruesve të arsimit për të rritur. ▪ Rishikimi i programeve për AARR dhe ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve të cilën merren me aftësimin e të rriturve. ▪ Pilotimi i njohjes së mësimi paraprak (sipas udhezimit administrativ) në një shkollë publike/private i cili do të pasojë me akreditimin i saj.	Është përmirësuar cilësia e ofertës arsimore në arsimin e të rriturve.
<i>6.4 Të përmirsohen kapacitetet për njohje dhe validim të mësimi paraprak</i>	▪ Të punohet në avancimin e zbatimit të sistemit për njohje formale dhe validim të mësimi paraprak. ▪ Të shtohen përpjekjet për ngritje të vetëdijes tek të rriturit dhe institucionet ofruese të arsimit për të rritur përmes trajnimeve, organizimi i fushatave informuese etj	Është përmirësuar njohja e mësimi paraprak dhe rritur shanset për punësim.

Teknologjia e informimit dhe komunikimit

Prioriteti	Aktivitetet	Rezultatet
7.1 Të përmirësohet përdorimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit në mësimdhënie dhe mësimnxënie	□ Të sigurohet qasje në internet për 600 institucione arsimore □ Të dyfishohet numri i kompjutereve në shkolla përmes sigurimit të 8000 njësive të reja □ Të promovohet përdorimi i teknologjisë informative në mësimnxënie përmes pilotimit të skemës Laptop për studentë duke pajisuar 20,000 student në vit për shkollat profesionale teknike dhe qendrat e kompetencës □ Të promovohet përdorimi i teknologjisë informative në mësimdhënie përmes pilotimit të skemës Laptop për Mësues duke pajisuar 7,500 mësues të shkollave të mesme të larta dhe mesme të ulta. □ Të pajisen të gjitha institucionet arsimore të nivelit parauniversitar me video-projektor (1500 njësi) □ Të pajisen të gjitha institucionet arsimore të nivelit parauniversitar me tabela interaktive □ Të ofrohet trajnim dhe certifikim për 7500 mësimdhënës në TIK ▪ Të përmirësohet mirëmbajtja dhe formimi i ekipeve të TIK në shkolla	Është rritur përdorimi i TIK në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe përmirësuar arritshmëria e nxënësve. Janë përmirësuar burimet për zbatim të kurrikulës së re
Implikimet buxhetore	15 € milion (3 milion€ në vit)	

Ndertimi i kapacitetit

Prioriteti	Aktivitetet	Rezultatet
8.1 Të përmirësohet kapaciteti për mbledhje, përpunim dhe raportim të të dhënave statistikore në arsim	▪ Të bëhet integrimi i të dhënave të softuerve ekzistues të MASHT në EMIS. Të dhënat e infrastrukturës, mësimdhënësve, arritshmërisë në testet e jashtme duhet integrohen në një sistem inter-operabil. ▪ Integrimi i të dhënave të nxënësve, mësimdhënësve dhe shkollave të komunitetit serb në EMIS ▪ Të përditësohen treguesit e arsimit për të reflektuar treguesit e BE-së dhe konkluzionet e OECD/Eurostat/UNESCO. ▪ Të investohet në trajnim dhe ngritje të kapaciteteve për përpunim dhe raportim të të dhënave në nivel qendror dhe lokal ▪ Të bashkërendohen të dhënat ndërmjet MASHT dhe ASK ▪ Të dhënat arsimore përdoren për të ndhmur procesin e politikëbërjes përmes analizave të impaktit të politikave dhe prodhimit të skenarëve ▪ Të përmirësohet kapaciteti për mbledhje të të dhënave mbi outputin e nxënësve/studentëve në tregun e punës ▪	Është përmirësuar kapaciteti për politikëbërje të bazuar në evidencë.

8.2 Të përmirësohen kapacitetet për planifikim strategjik dhe monitorim të performancës	▪ Të ngriten kapacitetet e komunave për planifikim strategjik, hartim të dokumenteve strategjike dhe monitorim të performancës në arsim ▪ Të asistohen komunat për (ri) organizim të strukturës organizative dhe zhvillim të burimeve njerëzore	Është rritur kapaciteti për politikë-bërje dhe zbatim të politikave.
8.3 Të përmirësohet qeverisja e sistemit të arsimit	▪ Të rriten kapacitetet për monitorim të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore ▪ Ngritja e kapacitetit teknik për politikë-bërje dhe hartim të akteve nën-ligjore ▪ Të realizohet studimi për vlerësim të kapaciteteve institucionale, organizative dhe individuale (Capnam) në sistemin e arsimit ▪ Të realizohet një studim gjithëpërfshirës rreth optimizimit të shkollave dhe kuadrit arsimor ▪ Të bëhet vlerësimi i nevojave për trajnim në mënyrë të vazhdueshme dhe të hartohet plani i trajnimeve ▪ Të zbatohet sistemi i vlerësimit të performancës në MASHT dhe DKA.	Është rritur efektshmëria dhe llogaridhënia në sektorin e arsimit
8.4 Të përfshihet dimenzioni i politikave gjinore në arsim	▪ Të nxitet konkurrenca reale gjinore në sistemin e arsimit ▪ Zbatimi i përpiktë i Ligjit për barazi gjinore në aspektet e rekrutimit dhe futjes së gjuhës së ndjeshme gjinore në dokumente zyrtare ▪ Të rishikohen tekstet mësimore për të larguar paragjykimet gjinore ▪ Të përmirësohet përfshirja e femrave në pozita menaxheriale ▪ Të organizohen trajnime mbi barazinë gjinore në nivel qendror dhe lokal	Janë siguruar shanse të barabarta për të gjithë në sektorin e arsimit
8.5 Të rritet përfshirja e diasporës në arsim	▪ Të përshtatet kurrikula aktuale në diasporë me Kornizen e Kurrikulës së Kosovës ▪ Të zbatohet platforma didaktike për mësim të gjuhës së origjinës përmes internetit	Është përmirësuar ndërlidhja e diasporës me sistemin e arsimit
8.6 Të rritet vetëdija rreth mjedisit në shkolla	• Të promovohet dhe rritet vetëdija rreth mjedisit si komponentë në politikat arsimore dhe shkollore. ▪ Të draftohet politika mjedisore për sistemin arsimor.	Është ngritur vetëdija rreth mjedisit në shkolla

Referencat

AAK (2013), Raporti i Vete-vleresimit, ENQA

AAK (2015 a), Programet e Akredituara në Arsimin e lartë, 30 gusht 2015, <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/en/download/2014-11-19-14-30-14/public-institutions-accreditation>

AAK (2015 b), Statistikat e studentëve në arsimin e lartë privat, Prishtinë

AAK (2015), Institucionet e Akredituara në Arsimin e lartë, 30 gusht 2015, <http://www.akreditimi-ks.org/neë/index.php/en/download/higher-education-institutions>

AKK (2014), Raport mbi Rezultatet e Hulumtimit rreth Shkollave Profesionale dhe Qëndrimit të Tyre ndaj Sigurimit të Cilësisë dhe Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, Prishtinë, http://akk-ks.net/uploads/hulumtimi_autoriteti_kombetar_i_kualifikimeve_qendrimet_e_shkollave_te_aap_rreth_sc_kkkandakk.pdf

ASK (2014), Results of the Kosovo 2013 labour force survey. (Anketa për Fuqinë Punëtore 2013). https://ask.rks.gov.net/ENG/publikimet/doc_download/1174-results-of-the-kosovo-2013-labour-force-survey

ASK (2015), Statistikat e Arsimin në Kosovë 2014/2015, <https://ask.rks.gov.net/arsimi/publikimet>

ASK (2015). Results of the Kosovo 2014 labour force survey. (Anketa për Fuqinë Punëtore 2014). Marrë nga: https://ask.rks.gov.net/ENG/publikimet/doc_download/1314-results-of-the-kosovo-2014-labour-force-survey

BB (2013), Monitoring and Evaluation Capacity Development for Western Balkans and Turkey, 2013

BB (2013), Anketa e Ndërmarrjeve në Kosovë / Kosovo Enterprise Survey, Ref. KSV_2013_ES_v01_M, Washington DC

BB (2013a), Country Snapshot Kosovo, World Bank, Washington DC

ESI (2014), Tekstet dhe Mësimdhënësit: Debat i Madh rreth Arsimin në Kosovë 2015, <http://www.esiweb.org/pdf/ESI%20-%20Kosovo%20-%20books%20and%20teachers%20-%2022%20Dec%202014.pdf>

ESMU (2010), Funding Higher Education: A view across Europe, http://www.utwente.nl/bms/cheps/publications/Publications%202010/MODERN_Funding_Report.pdf

ETF (2014), Country Strategy Paper: Kosovo 2014-2020, Torino

ETF, Guide for the Review of Institutional Arrangements, Draft October 2013.

ETF, Kosovo – Torino Process, 2012.

European Commission (2013), DG ELARG, Sector Approach in Pre-accession Assistance, Ref. 2013/65573, Bruksel

EUROSTAT (2014), Statistikat Arsimore në Bashkimin Evropian, [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Gross_domestic_expenditure_on_R%26D,_2003%E2%80%9313_\(%25_of_GDP\)_YB15.png](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Gross_domestic_expenditure_on_R%26D,_2003%E2%80%9313_(%25_of_GDP)_YB15.png)

EUROSTAT (2014), Të dhënat mbi Arsimin Terciar në BE 28, http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Tertiary_education_statistics

IPK (2014), Edukimi Parashkollor dhe Parafillor në Komunë, <http://www.ipk-rks.net/publikimet.php>

IPK (2014a), Përdorimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit në mësimdhënie, <http://www.ipk-rks.net/publikimet.php>

IPK (2015), Raport mbi Arsimin e të Rriturve, Prishtinë

Lampert D. et al (2015), Co-publication and co-patenting analysis among countries in the Danube Region

MASHT (2007), Strategjia për Integrim të Komunitetit RAE 2007-2017, Prishtinë

MASHT (2009), Plan i Kombëtar Kunër Braktisjes së Shkollës 2009-2014, Prishtinë

MASHT (2011), Plan i Strategjik i Arsimit, Prishtinë

MASHT (2011a), Korniza e Kurrikulës Kombëtare, Prishtinë

MASHT (2011b), Statistikat e Arsimit 2010/2011, Prishtinë

MASHT (2012), Statistikat e Arsimit 2011/2012, Prishtinë

MASHT (2013), Raporti i Rishikimit të Përbashkët Vjetor 2012, Prishtinë

MASHT (2013a), Statistikat e Arsimit 2012/2013, Prishtinë

MASHT (2014), Pro-memorja e Arsimit 2013, Prishtinë

MASHT (2014a), Raport mbi Procesin e Bolonjes në Kosovë, Prishtinë

MASHT (2014b), Raporti i Rishikimit të Përbashkët Vjetor 2013, Prishtinë

MASHT (2014c), Statistikat e Arsimit 2013/2014, Prishtinë

MASHT (2014d), Strategjia e Praktikës Profesionale 2013-2023, Prishtinë

MASHT (2014e), Katalogu i Udhëzimeve Administrative, 2011-2015, <http://masht.rks-gov.net/legislacioni>

MASHT (2015f), Katalogu i Trajnimeve të Akredituara 2015, Raport nga Divizioni për Zhvillim Profesional i Mësimdhënësve, Prishtinë

MASHT (2015g), Lista e ndërmarrjeve dhe nënësve në praktikë profesionale, Raport nga Divizioni për Arsimit dhe Aftësim Profesional, Prishtinë

MASHT (2015h), Orientimi i Nxënësve në AAP sipas profileve, Raport nga Divizioni për Arsimit dhe Aftësim Profesional, Prishtinë

MASHT (2015i), Raporti i Rishikimit të Përbashkët Vjetor 2014, Prishtinë

MASHT (2015j), Statistikat e Njohjes dhe Baravlerësimit të Diplomave 2011-2015, Prishtinë

MASHT (2015k), Trajnimet e Mësimdhënësve 2011-2015, Raport nga Divizioni për Zhvillim Profesional i Mësimdhënësve, Prishtinë

MASHT (2015l), Pro-memorja e Arsimit 2014, Prishtinë

MASHT (2015m), Statistikat e Arsimit 2014/2015, Prishtinë

Ministria e Financave (2013), Korniza Afat-mesme e Shpenzimeve 2014-2016, Prishtinë

Ministria e Financave (2015), Buxheti i shpenzuar në arsim 2011-2014, Prishtinë

OECD (2014), Education at a Glance (Vështrim mbi Arsimin). Marrë nga: <http://www.oecd.org/edu/Education-at-a-Glance-2014.pdf>

OECD (2015), Vlerësimi i ETL 2020, Dimenzioni i Rritjes së Mësim, Paris 2015

OSCE (2015), Raporti i të Drejtave të Komuniteteve, Edicioni IV, Prishtinë, <http://www.osce.org/sq/kosovo/209966?download=true>

Qeveria e Kosovës (2011), Programi i Qeverisë së Kosovës 2011-2014, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_eng_.pdf

Statman, J., Huibregste, A., Pupovci D., Mullahatihiri V (2015), Kosovo Workforce Readiness Assessment, USAID, 2015. http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00KH27.pdf

UNDP (2015), Mapping Corruption Risks in Kosovo Education Sector, <http://eei.iep.unesco.org/en/mapping-corruption-risks-kosovo-education-sector-3361>

UNESCO (2015), Statistika Globale mbi Arsimin,
<http://data.uis.unesco.org/index.aspx?queryid=189#>

Universiteti i Gjakovës (2015), Numri i studentëve, statistika të dërguar përmes
korrespondences, Gjakovë

Universiteti i Gjilanit (2015), Numri i studentëve, statistika të dërguar përmes korrespondences.
Gjilan

Universiteti i Mitrovicës (2015), Numri i studentëve 2013-2015, statistika të dërguar përmes
korrespondences, Mitrovicë

UP (2015), Numri i studentëve dhe të diplomuarve 2011-2015, statistika të dërguar përmes
korrespondences, Prishtinë

UPZ (2015), Numri i studentëve dhe të diplomuarve, statistika të dërguar përmes
korrespondences, 2011-2015, Prishtinë

USAID (2013), Kosovo BEEPS, Country Profile, <http://ebrd-beeps.com/wp-content/uploads/2015/04/kosovo.pdf>

Webometrics (2015), Rankimi i institucioneve të arsimit të lartë 2015, www.webometrics.info

Winkler, H (2014), Kosovo – A Note on Recent Labour Market Developments, World Bank,
Washington

MINISTRIA E ARSIMIT,
SHKENCËS DHE
TEKNOLOGJISË